

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

---

**Çështje të sigurisë - 9**



# ÇËSHTJE TË SIGURISË *Security Issues*

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Nr. 9, vjeshtë 2008

**Bordi botues:*****Kryetar***

Sotiraq Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim

***Anëtarë***

Prof. dr. Dhori Karaj – Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale

Franko Egro – Publicist, Kryeredaktor i TV Koha

Ambasador Pëllumb Qazimi Gj. Lt. (rez.)

Begator Mane - President i RO-GAT

***Konsulentë***

Geron Kamberi – M.A. në Studime Evropiane

Artan Karini – M.A. në Administrim Publik

***Ky numër u përgatit nga***

Erjon Alikaj

Mariola Qesaraku - M.A. në Studime Evropiane Bashkëkohore

---

*Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare  
të Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s në Bruksel  
dhe Kompania Private e Sigurisë RO-GAT, Tiranë*

## PËRMBAJTJA

<b>Bernard Kouchner</b>	
Fjala e hapjes në Seminarin BE - NATO .....	7
<b>Sally McNamara</b>	
Formësimi i Marrëdhënies NATO-BE: Çfarë duhet të bëjë SHBA-ja? .....	16
<b>Olli Rehn</b>	
NATO - BE: Një partneritet strategjik .....	38
<b>Marco Vincenzino</b>	
Publiku në Perëndim duhet të blejë në Afganistan - dhe shpejt.....	44
<b>Enri Hide (MA)</b>	
Terrorizmi ndërkombëtar - konceptualizimi dhe terminologjia .....	49
<b>Erjon Alikaj</b>	
Konflikti në Kaukaz 2008: origjina, zhvillimi dhe pasojat....	65
<b>Gjergji Vurmo &amp; Steven Blockmans</b>	
Anëtarësimi në BE - koha e duhur për aplikimin e Shqipërisë: <i>Një zgjedhje midis presidencës franceze, çeke dhe suedeze</i> .....	84
<b>Mariola Qesaraku</b>	
Shkolla Verore Rajonale për Studime të Sigurisë .....	107

Mathieu Rousselin

Rruga drejt Komunitetit Euroatlantik: *Efektet e Marrëdhënieve BE-NATO mbi Sigurinë e Shqipërisë* ..... 111

Brief Summary in English ..... 134

Bernard Kouchner

## SEMINAR BE - NATO

FJALIMI I HAPJES NGA Z. BERNARD KOUCHNER,  
MINISTËR I PUNËVE TË JASHTME DHE EUROPIANE  
(EKSTRAKTE)

*Paris, 7 korrik 2008*

Takimi ynë i sotëm shërben së pari si kujtesë, që rigjallërimi i Mbrojtjes së Europës është një nga projektet madhore që vendi im dëshiron të trajtojë me prioritet gjatë presidencës së saj. (...)

Do të doja që synimi dhe shtrirja e kësaj ambicieje të kuptohet si duhet (...).

Rigjallërimi i Mbrojtjes së Europës, që ne po propozojmë sot, është më shumë se vazhdim i thjeshtë i politikës tradicionale: ai është rezultat i një analize të thellë i mjedisit aktual strategjik dhe një vizion i rinovuar politik. Ai bazohet në një vlerësim të aftësisë sonë kombëtare të mbrojtjes, asaj të Bashkimit Europian, partnershipit transatlantik dhe Aleancës së Atlantikut. (...)

Cili është ky vizion?

### **MJEDISI STRATEGJIK**

Mjedisi ynë karakterizohet ende nga vazhdimësia e kërcënimeve, si përhapja e armëve të shkatërrimit në masë dhe terrorizmit, dhe ne duhet të marrim parasysh dhe shfaqjen e rreziqeve të reja, në një botë ku ritmi i ndryshimit po përparon me shpejtësi. Ndryshimi i klimës, problemet mjedisore, krizat energjitike, pamjaftueshmëria e burimeve ushqimore, migracioni, pirateria, krimi i organizuar dhe sulmet informatike janë të gjithë shkaqe të çekuilibrit që mund të

prekë sigurinë tonë. Le të shtojmë, gjithashtu, se në shumë rajone të botës, shpenzimet ushtarake po rriten.

Detyra jonë është të jemi realistë: Europa, në këto momente një ishull stabiliteti e mirëqenieje, nuk mund të jetë i vetmi entitet që të neglizhojë sigurinë e tij. Përpjekja për mbrojtjen e saj duhet të reflektojë potencialin e saj ekonomik e teknologjik.

Por sot nuk jemi ende në këtë situatë: edhe pse PESM-i, Politika Europiane për Sigurinë dhe Mbrojtjen, ka arritur besueshmërinë operacionale me rreth 20 operacione të përmbushura e në vazhdim, përpjekja europiane për mbrojtjen është ende e pamjaftueshme, e pakoordinuar dhe e ndarë jo në mënyrë të barabartë mes shteteve tona, një kohë kur nevojat po rriten dhe kur fondet po vështirësohen.

Në këto kushte, Europa rrezikon të mos mundet më të jetë një partner strategjik për aleatët e saj: mundësitë e kufizuara që po hasim për operacionet e PESM-it janë të njëjtat me ato që ndeshim kur kryejmë operacione me aleatët tanë amerikanë, në kuadër të NATO-s; problemi i pamjaftueshmërisë së mundësive europiane është problemi ynë, por është, gjithashtu, një çështje tepër e rëndësishme për besueshmërinë dhe kohezionin e Aleancës.

## **KARTA E BARDHË FRANCEZE**

Franca i ka nxjerrë këto konkluzione, në nivel kombëtar, për sa i përket mundësive të saj mbrojtëse, në Kartën e Bardhë për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, e cila sapo është bërë publike, si mund ta konstatoi nga konkluzionet. Si rezultat i vendimeve të forta zyrtare për ristrukturimin e aftësive tona mbrojtëse, me një numër të vogël forcash të armatosura dhe një buxhet kostant ne do të jemi në gjendje t'i japim prioritet rinovimit të pajisjeve operacionale të forcave tona. Në mënyrë të ngjashme, do të bëhet një përpjekje në fushën e inteligjencës për të përmirësuar parashikimin tonë ndaj zhvillimeve në atë që është kthyer në një mjedis të paparashikueshëm.



## STRATEGJIA E MBROJTJES SË EUROPËS / PËRDITËSIMIT TË SIGURISË EUROPIANE

Rigjallërimi i Mbrojtjes së Europës është një nga prioritetet e presidencës franceze të Bashkimit Europian. (...) Çfarë po propozojmë?

Ne duam që qasja jonë të jetë pragmatike dhe koherente, në mënyrë që të arrijmë disa rezultate konkrete, p.sh. adresimi i pritshmërive të qytetarëve europianë: objektivi kyç i presidencës sonë do të jetë fillimi i punës për rritjen konkrete të mundësive të disponueshme ushtarake e civile në Europë; synimi sigurisht nuk është për të krijuar një ushtri europiane kur ka një ushtri të NATO-s, por, po e përsëris, për t'u dhënë besim bashkëqytetarëve tanë.

Hapi ynë i parë do të jetë një analizë e re e riskut dhe kërcënimeve ndaj mjedisit tonë të sigurisë, përmes përditësimit të Strategjisë Europiane të Sigurisë, të cilën do të zbatojë Javier Solana në muajt e ardhshëm.

Mbi këtë bazë, ne propozojmë të mendojmë së bashku për t'i hedhur shikimet e Europës më larg. Qëllimi sigurisht që nuk është për të vënë në pikëpyetje çështjen e objektivit kyç të forcës prej 60 mijë trupash, të gatshme për veprim brenda 60 ditësh e për një periudhë prej 1 viti, që reflekton skenarin e një operacioni madhor ushtarak - më pak i mundshëm sot. Nga ana tjetër, duket e nevojshme të shqiptoj kombinimin me to të operacioneve të një shkalle të vogël, përfshirë ato civile, të cilat duhet të jemi në gjendje t'i bëjmë krahas tyre.

Në nivelin praktik, për dekadën e ardhshme, mendojmë se Bashkimi Europian duhet të jetë në gjendje të kryejë në të njëjtën kohë:

- së pari, dy operacione të rëndësishme stabilizimi ushtarak e rikonstruksioni, me deri 10.000 trupa, për një periudhë të paktën dy vjet, me një komponent të përshtatshëm civil për fazën e rikonstruksionit;
- së dyti, dy operacione të reagimit të shpejtë të kufizuara në kohë, me përdorimin e grupeve të betejës - rreth 1.500 trupa;
- së treti, një evakuim emergjent të shtetasve europianë;

- së katërti, një mision mbikëqyrjeje ose ndalimi detar apo ajror në një zonë ku rrezikohen interesat tona;
- së pesti, një operacion ndihme humanitare civilo-ushtarake me kohëzgjatje deri në 20 ditë;
- së fundi, 10 ose një numër i përafërt misionesh civile (policore/drejtësie) me përmasa të ndryshme, duke përfshirë një të tillë më të madh e më të zgjatur: në të vërtetë, aftësia unike e Bashkimit Europian për të kryer misione të menaxhimit të krizave civile përbën një vlerë reale të shtuar.

### **AGJENCIA E PROKURIMIT / MBROJTJES EUROPIANE / EDTIB**

Për të bërë këtë, duhet të bashkojmë përpjekjet tona në disa projekte të aftësive kryesore në fusha kyç ku përfshihen:

- preventivi: kemi nevojë për më shumë helikopterë - si e pamë sërish së fundmi në Çad - për më shumë transport strategjik dhe avionë furnizues në ajër, meqë mundësitë tona europiane ajrore-detare janë shumë të kufizuara;
- hapësira: për të vepruar, Europa duhet të zhvillojë aftësitë e saj të vëzhgimit dhe monitorimit të hapësirës;
- së treti, dimensionimi detar: hapësirat detare janë bërë themelore për sigurinë e vendeve tona. Ne duhet të forcojmë aftësitë tona të mbikëqyrjes dhe interceptimit në det, si në rrugët detare të Europës ashtu edhe në ato të deteve më të largët;
- dhe së fundi, menaxhimi i krizave, për të pasur një aftësi të koordinuar për evakuimin e shtetasve europianë, çminimin dhe reformën e sektorit të sigurisë në vendet që dalin nga krizat.

Për të ngritur një mundësi të përbashkët, ne mund ta bazojmë përpjekjen mbi një “plan zhvillimi” të përgatitur nga Agjencia e Mbrojtjes së Europës, e cila duhet të jetë e aftë ta luajë të plotë rolin e saj.

Për të përmirësuar efektivitetin afatgjatë të shpenzimeve ushtarake, ne propozojmë:

- përcaktimin e zgjidhjeve fleksibël dhe inovative në një mjedis të limituar buxhetor, si bashkimi i mundësive, funksioneve dhe trajnimeve;

- njohja e përbashkët e nevojës për të ristrukturuar dhe racionalizuar industrinë europiane dhe rritja e përpjekjeve tona: kjo është një domosdoshmëri strategjike dhe ekonomike për të inkurajuar rolin në rritje që luajnë kompanitë europiane në shkallë botërore. Nuk do të ketë Mbrojtje Europiane pa një bazë të fortë e konkurruese industriale e teknologjike të mbrojtjes dhe unë e di që kjo nuk do të jetë e lehtë.

## **QASJA INSTRUMENT-PËRFSHIRËSE E PESM-it**

Për të mbështetur këtë përpjekje mbi aftësitë, ne do të propozojmë gjithashtu të vazhdojmë përmirësimin e instrumentave ekzistuese të PESM-it:

- në nivelin politik, me krijimin e një Këshilli të Çështjeve të Përgjithshme, përbërja e të cilit konsiston vetëm në rang ministrash mbrojtjeje;
- në nivelin e planizimit dhe drejtimit të operacioneve europiane, i cili duhet forcuar - jo për arsye parimore apo simbolike, por me qëllim për të qenë në gjendje t'i ofrojë Europës, kur të vijë koha, një potencial që ne nuk mund ta paraprijmë.

Ky projekt i rigjallërimit të Mbrojtjes së Europës, sepse është praktikë dhe bën prioritar forcimin e aftësive, mund të zhvillohet, nëse është e nevojshme, në një kuadër të pandryshuar institucional. Kërcënimet, rreziqet dhe krizat ekzistojnë, ashtu sikurse dhe nevoja strategjike për të forcuar aftësitë e mundësitë europiane. Pra, nuk kemi ndërmend të tërhiqemi nga ky prioritet esencial ndërkohë që jemi të vetëdijshëm për vështirësitë aktuale të Europës, përkundrazi.

Por, sigurisht, ne do të jemi të kujdesshëm ndaj të gjitha ndjeshmërive në Europë për sa i përket politikës së mbrojtjes, në kuadrin e një qasjeje të hapur dhe si e quajmë sot gjithëpërfshirëse.

## **FRANCA / NATO-ja / BE-ja**

Do të doja t'ju thoja disa fjalë rreth transformimit të marrëdhënieve të Francës me NATO-n. Rigjallërimi i

Mbrojtjes së Europës, që ne duam të jetë në një linjë me një vizion politik të ngritur mbi aspektet komplementare të mbrojtjes europiane dhe NATO-s, bazohet në perspektivën e një rikonsiderimi të marrëdhënieve mes tyre, të cilin pritet ta plotësojmë për në Samitin e përvjetorit të 60-të të Aleancës në Strasburg - Kehl në prill 2009. Sigurisht, si tha Presidenti Sarkozy më 17 qershor dhe sërish para disa ditësh përpara drejtuesve të forcave të armatosura, nuk mund të ketë progres në integrimin e Francës në NATO [komandën ushtarake] po të mos ketë progres paraprak në Mbrojtjen e Europës.

Aleanca Atlantike, e cila ka mbrojtur lirinë tonë gjatë Luftës së Ftohtë, është një personifikim i këtij partneriteti transatlantik, për të cilin, po përsëris, Franca është angazhuar. Vendi im, një anëtar themelues i NATO-s, është sot një nga kontributorët kryesorë me trupa i Aleancës. Për 15 vjet ajo i ka angazhuar forcat e saj në operacionet e NATO-s nën mandatin e OKB-së.

Brenda familjes së Shteteve Perëndimore, anëtarët e BE-së dhe NATO-s kanë një histori, kulturë dhe interesa të përbashkëta. Vendet tona përballen me të njëjtat kërcënime dhe pengesa. 21 vende të NATO-s janë, gjithashtu, anëtare të BE-së. Dy organizatat tona janë të lidhura nga një partneritet strategjik për menaxhimin e krizave, i cili i ka dhënë provat në praktikë. E kam parë vetë këtë në operacionet e paqes në Ballkan dhe mbi të gjitha si kreu i misionit të OKB-së në Kosovë.

Marrëdhënia mes BE-së dhe NATO-s duhet të funksionojë si duhet.

Përkundër një sfondi të rritjes së numrit të krizave, përballë sfidave të përbashkëta, është më e domosdoshme se kurrë për BE-në dhe NATO-n që të mund të veprojnë së bashku për sigurinë tonë të përbashkët, me efektivitet më të madh global.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se pozicioni ynë specifik në NATO ka çuar në spekulime rreth ambicieve tona për PESM-in. Sot, ne duam t'i themi gjërat qartë: nuk është ose NATO-ja ose Mbrojtja e Europës; është NATO-ja dhe Mbrojtja e Europës.

Është në interesin tonë të përbashkët për marrëdhënien mes Bashkimit European dhe NATO-s që të punojmë me

eficencën maksimale, në një kuadër të përshtatur ndaj nevojave të sotme. Kjo do të thotë që duhet të ketë një plan politik në Bruksel, si dhe në vendet e menaxhimit të krizës ku jemi të angazhuar.

Këtu po mendoj natyrisht, edhe njëherë, për Kosovën dhe Afganistanin, ku dy organizatat tona janë dislokuar krah për krah, në një terren shumë të veshtirë, meqë dje pamë sërish atë sulm terrorist vetëvrasës në Kabul. Ne po i shërbejmë objektivave të përbashkëta të stabilizimit dhe rindërtimit.

Kjo është arsyeja pse diskutimet tuaja sot mbi marrëdhëniet mes Bashkimit European dhe Aleancës Atlantike janë veçanërisht të rëndësishme. Ne jemi në një situatë të pavendosur. Ne, Bashkimi European dhe NATO-ja jemi të angazhuar në operacione të mëdha e të veshtira. Kështu, ne duhet të mendojmë rreth progresit që duhet të bëjmë që ato të jenë të suksesshme. Kjo është qartësisht diçka për të cilën publiku ynë është ndërgjegjësuar. Ne të gjithë e dimë, në vendet tona, që duhet t'i shpjegojmë këto gjëra, që ne nuk mund ta kënaqim veten me rritjen e vazhdueshme të numrit të trupave të dislokuara pa një strategji që përforcon shpresat tona; dhe kjo strategji duhet të jetë e përbashkët për ne, Bashkimin European dhe NATO-n.

## **STRATEGJIA E SIGURISË EUROPIANE**

Do ta mbyll me disa propozime në lidhje me këtë.

Kjo është arsyeja pse Franca ka ftuar partnerët e saj të Aleancës dhe Bashkimit European për të ardhur e diskutuar këtë temë me ju këtu në Paris. Ne ju kemi ftuar që në fillim të presidencës franceze në të parin kurs të seminarëve të parashikuar për të dhënë kontribut për përditësimin e Strategjisë së Sigurisë Europiane. Në të vërtetë nuk ka dyshim që marrëdhënia Bashkim European-NATO dhe më gjerë partneriteti transatlantik, janë një aspekt i rëndësishëm i këtij ushtrimi. Ky është, gjithashtu, objektivi i propozimeve praktike që ne i kemi bërë BE-së dhe NATO-s që prej tetorit 2007 për të provuar dhe përmirësuar në mënyrë pragmatike marrëdhënien tonë.

Brenda BE-së, ne kemi bërë rreth 10 propozime konkrete për rritjen e angazhimit në PESM të anëtarëve të NATO-s që nuk janë anëtarë të BE-së. Ky ishte një hap i parë konkret, ndoshta modest, por kërkoj që ideja e përfshirjes së tyre të konsiderohet seriozisht.

NATO-s, Franca i ka propozuar 4 masa për të rritur transparencën dhe bashkëpunimin mes Aleancës dhe Bashkimit Europian. Ne bëjmë thirrje, gjithashtu, që këto propozime të zbatohen plotësisht. Kjo është arsyeja pse më 16 korrik Jean-Pierre Jouyet do të shkojë në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut për të paraqitur programin e presidencës franceze mbi politikën e sigurisë dhe mbrojtjes europiane. Ne do të përfitojmë të gjithë nga inkurajimi i transparencës dhe sinergjisë mes dy organizatave tona.

Sigurisht, ne nuk nënvlerësojmë vështirësitë politike të përfshira në çështjen e marrëdhënieve mes Bashkimit Europian dhe NATO-s. Ne duhet të provojmë dhe zgjidhim këto vështirësi në një kuadër politik dhe t'i konsiderojmë ato nga një perspektivë më e gjerë. Por ne duhet të shmangim lidhjen e të gjitha çështjeve në një shtrirje të tillë sa që çdo lëvizje të pengohet dhe një frenim të veshë progresin e nevojshëm të kësaj marrëdhënieje. Në lojë janë besueshmëria jonë si dhe siguria e personelit tonë në terren.

Në vend të kësaj, në bazë të propozimeve franceze, të propozimeve dhe përpjekjeve të tjera të bëra nga gjithë vendet, le të përpiqemi dhe të identifikojmë së bashku rrugët që na lejojnë progresin mbi masat praktike që do të krijojnë besim dhe që do të adresojnë shqetësimet legjitime të çdokujt, veçanërisht atyre të Turqisë dhe të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian që nuk janë në NATO. Këtu, mund të bëhen shpejt disa përmirësime të thjeshta pa prishur kuadrin e marrëdhënieve aktuale mes dy organizatave tona. Unë ju nxis të mendoni rreth kësaj, veçanërisht në tryezën e rumbullakët që diskuton për operacionet.

Forcimi i marrëdhënies NATO-Bashkimi Europian, po përsëris, do të jetë një prioritet i presidencës franceze e është një nga katër prioritetet:

- me synimin e zbatimit të plotë dhe plotësimin të propozimeve franceze të tetorit 2007 për përmirësimin e bashkëpunimit mes BE-së dhe NATO-s dhe përfshirjen në PESM të anëtarëve të NATO-s që nuk janë anëtarë të BE-së; ne do të japim mbështetjen tonë të plotë ndaj çdo iniciative të propozuar për këtë qëllim për të ndihmuar në zhbllokimin e marrëdhënieve mes dy organizatave;
- së fundi, me propozimin për një skemë të re bashkëpunimi për situatat ku NATO-ja dhe BE-ja angazhohen së bashku në të njëjtin teatër në dy operacione paralele.

Në të vërtetë, kudo ku BE-ja dhe NATO-ja kanë objektiva të përbashkëta, ne duhet të lehtësojmë sinergjitë dhe të shmangim mospërputhjet, çka publiku ynë do ta quante të pajustificueshëm, si e thashë më lart.

## **GRUPI I NIVELIT TË LARTË**

Do të doja sot të parashtroja një ide dhe të merrja mendimet tuaja. Ky dialog mund të zhvillohet në një “grup të nivelit të lartë” që do krijohet me pjesëmarrjen e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Përfaqësuesin e Lartë për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, si dhe drejtuesit e nivelit strategjik të NATO-s dhe Bashkimit European, me mbështetjen e duhur nga Komisioni.

Sigurisht, një marrëdhënie BE---NATO që funksionon mirë është një aset për secilin nga vendet tona. Franca do të vazhdojë të punojë vendosmërisht për këtë, e përsëris, me sinqeritet dhe pragmatizëm. (...)

Sally McNamara

## FORMËSIMI I MARRËDHËNIES NATO-BE: ÇFARË DUHET TË BËJË SHBA-JA?

Që prej sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001, Perëndimi ka investuar kohën, energjinë dhe burimet e tij në luftën kundër radikalëve islamistë dhe në bërjen e një luftë asimetrike. Megjithatë, sulmi imoral dhe i paligjshëm i Ruisë ndaj Gjeorgjisë më 7 gusht 2008, tregoi që kërcënimi i konfrontimit tradicional ushtarak nuk është zhdukur. Prandaj, Europa duhet të ringrejë ushtritë e saj për të ndërmarrë operacione në të gjithë kontekstet e sigurisë duke përcaktuar cilat kërcënime janë të mundshëm për t'u shfaqur dhe si t'i trajtojë sa më mirë ato.

Tradicionalisht, NATO-ja ka qenë arkitektura primare aleate ku mund të diskutohej siguria e Europës. Por, kur Franca mori presidencën 6-mujore të BE-së me 1 korrik 2008, avancimi i një identiteti ushtarak të ankoruar brenda strukturave të forcës së BE-së, të pavarura nga NATO-ja, u bë një prioritet kryesor. Partia Konservatore britanike i përshkroi këto plane si një “manifest për një marrje nga BE-ja të forcave tona të armatosura”<sup>1</sup>. Megjithatë, me uljen së fundi të tensionit franko-amerikan, administrata e Bushit u bind mjaftueshëm që kjo iniciativë e BE-se nuk e kërcënon NATO-n dhe i dha asaj një pritje të ngrohtë.

Me Politikën Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PESM) që ekziston që prej gati një dekade, shpenzimet mesatare të mbrojtjes europiane janë ulur dhe NATO-ja ka konstatuar pak ose aspak komplementaritet të vlefshëm, ndërkohë që pikëpyetje serioze mbesin rreth motivimit të BE-së në

---

<sup>1</sup> Euractive.com, “France Seeks to Revitalise European Defence”, June 6, 2008, at <http://www.euractiv.com/en/opinion/france-seeks-revitalise-european-defence/article-173103>



vazhdimësinë e identitetit ushtarak. Përgjigjja e kujdesshme dhe e dykuptimtë e BE-së ndaj luftës gjeorgjano - ruse nënvizon thjesht se sa larg është Brukseli nga përmbushja e një politike të jashtme të fortë e të unifikuar. Prandaj, marrëdhënia strukturore dhe organizative mes BE-së dhe NATO-s duhet të rivlerësohet ashtu si dhe qëllimi dhe vlera e vijimit të integrimit të mëtejshëm.

### **Dhjetë vjet pas St. Malo-s: PESM-i, pak ose aspak ndihmë për NATO-n**

Pas rënies së Bashkimit Sovjetik në fillim të viteve '90, vendet e sapoçliruara të Europës Qendrore e Lindore nxituan për anëtarësim fillimisht në NATO dhe mandej në Bashkimin Europian. Pasi kishin provuar për më shumë se gjysmë shekulli dominancën sovjetike, nevoja për një marrëdhënie strategjike të sigurisë me Amerikën ishte e lartë, e ndjekur nga përfitimet ekonomike të anëtarësimit në BE. Tranzicioni relativisht paqësor dhe i suksesshëm i këtyre vendeve për në demokraci, i arritur pjesërisht nëpërmjet anëtarësimit në NATO, shtruan më pas rrugën për pjesën më të madhe të Europës Qendrore dhe Lindore për të hyrë në BE në 2004. Sot, NATO-ja dhe BE-ja ndajnë 21 anëtarë.<sup>2</sup> Integrimi i BE-së në fushën e mbrojtjes po kryhej kur Europa Qendrore e Lindore u pranuan dhe anëtarët më të rinj e panë me vend t'u përshtateshin anëtarëve të vjetër.

Marrëdhëniet NATO-BE përforcohen nga Marrëveshja Berlin Plus e nënshkruar në dhjetor 2002 dhe e zbatuar në mars 2003. Është e lehtë të dallosh pse Uashingtoni mendonte se po bënte një marrëveshje të mirë me Berlin Plus-in: Ndërsa marrëveshja siguroi aksesin e BE-së në aftësitë planizuese dhe asetet e NATO-s për operacionet e menaxhimit të krizave të

---

<sup>2</sup> Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia ishin mes vendeve që hyrën në BE më 1 maj 2004. Bullgaria dhe Rumania hynë më 1 janar 2007. NATO-ja dhe BE-ja ndajnë këta anëtarë: Belgjikën, Bullgarinë, Republikën Çeke, Danimarkën, Estoninë, Francën, Gjermaninë, Greqinë, Hungarinë, Italinë, Letoninë, Lituaniën, Luksemburgun, Holandën, Poloninë, Portugalinë, Rumaninë, Sllovakinë, Slloveninë, Spanjën dhe Britaninë e Madhe.

udhëhequra nga BE-ja (CMO), SHBA-ja parashikoi një angazhim më të madh nga BE-ja për të rritur aftësitë e saj ushtarake. Premisa e Berlin Plus-it ishte në thelb që PESM-i do ta forconte NATO-n, e jo ta minonte atë, dhe që doktrina e politikës amerikane e “Tre D”-ve do të mbështetej: jo ndarje nga NATO-ja, jo dublikim i burimeve të NATO-s dhe jo diskriminim kundër anëtarëve të NATO-s që nuk janë pjesë e BE-së. Kongresi dhe Administrata e SHBA-së gjithashtu duhet të jenë inkurajuar duke parë mikun e tyre më të afërt, Britaninë e Madhe në miratim të këtij projekti. (Atëherë kryeministri Toni Bler inicioi një ndryshim domethënës të politikës britanike për të mbështetur një identitet të mbrojtjes së BE-së në St. Malo në 1998.)

Por nuk ka pasur asnjë rritje të angazhimit nga europianët për sa i përket shpenzimeve apo personelit dhe Toni Bler është larguar tashmë nga skena europiane për t’u zëvendësuar nga një qeveri e dobët dhe inefektive në Londër. Ka, gjithashtu, prova domethënëse që doktrina e Tre D-ve është braktisur prej shumë kohësh nga BE-ja. Është bërë e qartë se Bashkimi Europian e nënshkroi Berlin Plus-in me synimin e rritjes së statusit të tij dhe të fitimit të aksesit në asetet e NATO-s (kryesisht amerikane), pa angazhim të vërtetë për të rritur shpenzimet e mbrojtjes. Synimi fillestar i Blerit - që NATO-ja do të merrte vlerë të shtuar dhe komplementaritet domethënës nga PESM-i - nuk u realizua dhe ai u tregua me gisht nga Parisi. Sipas një raporti të Shërbimit Kërkimor të Kongresit në janar 2005: “Zyrtarët francezë prej kohësh kanë argumentuar së BE-ja duhet të kërkojë të kundërbalancojë Shtetet e Bashkuara në skenën ndërkombëtare dhe e shikojnë PESM-in si një mjet për të rritur besueshmërinë politike të BE-së”.<sup>3</sup> Prandaj, është një rast domethënës për SHBA-në që të rishikojë klauzolat e Marrëveshjes Berlin Plus.

---

<sup>3</sup> Kristin Archick and Paul Gallis, “NATO and the European Union”, Congressional Research Service *Report for Congress*, January 4, 2005, at <http://www.fas.org/man/crs/RL32342.pdf> (September 30, 2008).

## Kosova

*Kosova është thellësisht një çështje europiane<sup>4</sup>*

**Olli Rehn**

**Komisioneri i BE-së për Zgjerimin**

BE-ja është bërë thellësisht e ndërgjegjshme për mangësitë e saj ushtarake gjatë Luftës së Kosovës në 1999, ku asaj i munguan pajisje të rëndësishme ushtarake për sa i përket, ndërmjet të tjerash, aeroplanmbajtëseve strategjike, raketave të telekomanduara dhe strukturave të komandës e kontrollit.<sup>5</sup> Ishin këto mangësi që u theksuan kur u justifikua avancimi i një identiteti të mbrojtjes së BE-së.

Prandaj BE-ja ka qënë e vendosur të marrë një rol drejtues në Kosovë pas shpalljes së saj të pavarësisë, megjithëse me një kapacitet civil më shumë se ushtarak. Më 15 shkurt 2008, BE-ja njoftoi fillimin e Misionit të Bashkimit European për Zbatimin e Ligjit në Kosovë (EULEX Kosovo) me qëllimin e zhvillimit të një force policore e një sistemi të drejtësisë penale të pavarur e të qëndrueshëm në një demokraci të re e të brishtë.

Në një demonstrim të mbështetjes për vendin nën zjarr, Bashkimi European u përpoq të tregojë forcë dhe vendosmëri për çështjen e pavarësisë kosovare dhe njoftoi një mision 16 mujor - 205 milionësh nën drejtimin e gjeneral lejtantit francez Yves de Kermabon. BE-ja njoftoi, gjithashtu, emërimin e një “përfaqësuesi special” Pieter Feith, mandati i të cilit ishte të përforconte përfshirjen politike të BE-së në orientimin dhe mbështetjen e Kosovës në këtë kohë delikate.<sup>6</sup>

BE-ja deklaroi që një nga forcat e saj madhore është aftësia e saj për të kryer misione civile dhe zotërimi i Fuqive të Mëdha diplomatike për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse për mbrojtjen.

<sup>4</sup> BBC News, “Donors Pledge Funds for Kosovo”, July 11, 2008, at <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/7501328.stm> (September 30, 2008).

<sup>5</sup> Archick and Gallis, “NATO and the European Union”.

<sup>6</sup> Press Release, “Kosovo: Council Establishes an EU Rule of Law Mission, Appoints an EU Special Representative”, Council of the European Union, February 16, 2008, at <http://www.eupt-kosovo.eu/new/home/eng/st06613.en08.pdf> (September 26, 2008).

Ky mision është misioni më i madh civil i BE-së deri tani, me dislokimin e planifikuar të 1.900 personave si oficerë policie, gjykatës, një njësi doganore dhe staf të madh komandues e mbështetës.<sup>7</sup> E etur për të rritur angazhimin e saj në Ballkanin Perëndimor, BE-ja planifikoi të marrë aty drejtimin nga agjenci të shumta ndërkombëtare, të kryesuara nga Misioni i OKB-së në Kosovë UNMIK. Ajo njoftoi në shkurt 2008 se pas një përgatitjeje të kujdesshme e të planifikuar 120-ditëshe, misioni 2-vjeçar i BE-së do të ishte gati për zbatim të plotë në mes të qershorit 2008.<sup>8</sup> Në fakt, BE-ja kishte gati dy vjet që përgatiste këtë mision të PESH-it. Në prill 2006, BE-ja angazhoi një ekip të konsiderueshëm planifikimi saktësisht me qëllimin e përgatitjes për një mision të ardhshëm civil.<sup>9</sup>

Megjithatë, as edhe një zyrtar policie, drejtësie apo dogane i BE-së nuk u dërgua në terren sipas planit dhe periudha 120-ditore rifilloi nga e para. Edhe në rrethana optimiste, prania e BE-së nuk do të kompletohet deri në nëntor-dhjetor.<sup>10</sup> Një faqe e posaçme në sitin Web të EULEX-it pyet: “Pra, çfarë ka arritur EULEX-i?” Mjerisht, pavarësisht entuziazmit fillestar të BE-së dhe planifikimit të madh burokratik, faqja Web nuk ka ndonjë arritje për t’u shënuar.<sup>11</sup>

Me prioritete të tjera, si dhe me refuzimin e Irlandës ndaj Traktatit të Lisbonës, BE-ja ka humbur pasionin dhe zellin e saj për të marrë drejtimin në Kosovë, duke fajësuar për mungesën e progresit të saj një situatë të paqartë ligjore brenda

<sup>7</sup> “Javier Solana, EU High Representative for the CFSP, Welcomes the Appointments of Pieter Feith as EU Special Representative in Kosovo and Yves de Kermabon as Head of Mission of EULEX Kosovo”, Council of the European Union, February 16, 2008, at [http://www.eupt-kosovo.eu/new/home/eng/080216\\_EUSR\\_and\\_HoM\\_Kosovo.pdf](http://www.eupt-kosovo.eu/new/home/eng/080216_EUSR_and_HoM_Kosovo.pdf) (September 26, 2008).

<sup>8</sup> Press Release, “The EU in Kosovo”, European Union, February 2008, at [http://www.eupt-kosovo.eu/new/home/eng/080216\\_EU\\_in\\_Kosovo\\_Global.pdf](http://www.eupt-kosovo.eu/new/home/eng/080216_EU_in_Kosovo_Global.pdf) (September 26, 2008).

<sup>9</sup> Council Joint Action 2006/304/CFSP, Official Journal of the European Union L112/19, April 26, 2006, at [http://www.eupt-kosovo.eu/new/legalbasis/docs/060426Joint\\_Action\\_Kosovo\\_EN.pdf](http://www.eupt-kosovo.eu/new/legalbasis/docs/060426Joint_Action_Kosovo_EN.pdf) (October 2, 2008).

<sup>10</sup> Patrick Jackson, “Failing to Start the Blue Car in Kosovo”, *BBC News*, July 29, 2008, at <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/7510181.stm> (September 26, 2008).

<sup>11</sup> EULEX Kosovo, “So, What Has EULEX Achieved?” at <http://www.eulex-kosovo.eu/?id=16> (September 26, 2008).

Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, Kosova është njohur nga 47 vende anëtare të OKB-së përfshirë shumicën e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit e me 11 njohje aktualisht në pritje.<sup>12</sup> Ajo ka aplikuar për anëtarësim në Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ajo madje ka lëshuar pasaportat e veta në vend të atyre të UNMIK-ut.<sup>13</sup> Shpresa e arritjes së një miratimi të OKB-së për Kosovën ishte e pamundur dhe BE-ja do të duhet të jetë e përgatitur për një rrugë të gjatë, sidomos duke marrë parasysh periudhën e konsiderueshme të planifikimit. Megjithatë BE-ja duket e vendosur të kryejë misionet vetëm në rast të një konflikti e në kushte të pajtueshmërisë perfekte BE-OKB.

Në këto momente, presidenti i Serbisë Boris Tadic ka thënë se Serbia do ta pranojë EULEX-in vetëm nëse ai miratohet nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së dhe nëse EULEX-i nuk mbështet planin e Ahtisarit, propozimin gjithëpërfshirës së OKB-së për statusin e Kosovës. Përveç faktit që Rusia është praktikisht e vendosur të vendosë sërish forcën e vetos në Këshillin e Sigurimit për të mohuar pavarësinë e Kosovës, BE-ja ka qënë një ihtar e fuqishme e planit Ahtisari që prej fillimit. Marti Ahtisari, i dërguari special i OKB-së për statusin e ardhshëm të Kosovës, kishte gjithashtu mbështetjen e OSBE-së, NATO-s, SHBA-së, Anëtarëve Perëndimorë të Grupit të Kontaktit për Kosovën dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Ban Ki-moon. Është e vështirë të imagjinohet një situatë ku BE-ja të ketë një legjitimitet më të madh ndërkombëtar për misionin e saj. Fillimi i EULEX-it nuk duhet të jetë pjesë e konsensusit të Serbisë, por të jetë në përputhje me detyrimet kushtetuese të Kosovës.

BE-ja ka qënë një partner i dobët në krahasim me NATO-n në Kosovë. Me një forcë prej 15.000 personash në terren dhe me një Forcë Operacionale Rezervë në dispozicion për misionet të reagimit të shpejtë, Forca e NATO-s në Kosovë (KFOR) ka dhënë një shtysë logjistike, ushtarake, politike dhe

<sup>12</sup> "Who Recognized Kosova as an Independent State?" at <http://www.kosovothanksyou.com/> (September 30, 2008).

<sup>13</sup> Philippa Runner, "Kosovo Passport Holders Face Uncertain EU Welcome", [euobserver.com](http://euobserver.com/9/26568), July 31, 2008, at <http://euobserver.com/9/26568> (September 30, 2008).

morale për të garantuar sigurinë në Kosovë, veçanërisht me një mandat për të përdorur forcën ku është absolutisht e domozdoshme si ishte gjatë trazirave etnike në mars 2004.<sup>14</sup> Në praktikë, ajo ka ndërmarrë një varg detyrash përfshirë sigurinë e kufijve, ndihmën mjekësore dhe mbështetjen për ngritjen e institucioneve civile.<sup>15</sup> Përkundër ndryshimit dhe mungesës së drejtimit për sa i përket BE-së, KFOR-i ka vazhduar të punojë për normalizimin e Kosovës. Madje edhe kur të fillojë EULEX-i, është KFOR-i ai i cili do të ofrojë sigurinë e tij.

EULEX-i do të jetë me gjasë një instrument i mirëpritur kur të fillojë më në fund në Kosovë. Megjithatë, ai do të veprojë në një arenë të cilën NATO-ja e ka siguruar tashmë dhe ku NATO-ja do të vazhdojë të ketë pjesën më të madhe të përgjegjësisë. Ai do të veprojë sipas programit dhe me një besim të reduktuar në vetë legjitimitetin e tij. BE-ja e ka humbur një mundësi të parë për të treguar vlerën e pritshme të shtuar të PESH-it për të cilin ajo lëvdohet vazhdimisht.

## Gjeorgjia

Pasi kishte kryer një mision ligjor në Gjeorgji në 2004, EUROJUST THEMIS, BE-ja u vu menjëherë në krye të përpjekjeve për ndërmjetësimin e paqes dhe zgjidhjen e krizës në konfliktin gjeorgjiano-rus. Megjithatë, përpjekjet e dobëta të Francës pas sulmit rus më 7 gusht, ilustrojnë atë çka SHBA-ja mund të presë nga një politikë e ardhshme e jashtme dhe e mbrojtjes së BE-së - një qasje e dominuar nga franko-gjermanët me një prirje të ulët të përbashkët për veprim.

Që prej fillimit të krizës, BE-ja, nën drejtimin e presidentit francez Nikolas Sarkozy, përjashtoi nga tryeza të gjitha opsionet ushtarake, duke filluar negociatat me Moskën nga një pozicion dobësie. Vetëm pas më shumë se një jave të veprimit jo proporcional ushtarak të Moskës, përfshirë shumë sulme në

<sup>14</sup> U.N. Security Council Resolution 1244 of June 10, 1999, was passed under Chapter VII of the Charter of the United Nations, which permits the use of both military and non-military action.

<sup>15</sup> NATO Factsheet, "Kosovo Force", February 15, 2008, at <http://www.nato.int/issues/kfor/index.html> (September 28, 2008).

territorin sovran gjeorgjian brenda disa miljeve nga Tbilisi, Rusia firmosi marrëveshjen 6 pikëshe të armëpushimit të ofruar nga Franca. Së fundmi, Sarkozy negocoi armëpushimin sipas kushteve të Moskës dhe nuk ofroi mekanizma shtërngues në rast se ai do të thyhej nga Rusia. Moska vazhdoi ta ekspozonte brutalisht dobësinë e diplomacisë shëtitëse të Sarkozy-së duke mos e përfillur armëpushimin në çdo rast e shpejt duke e grisur fare atë me njohjen e njëanshme të pavarësisë së Osetisë së Jugut dhe Abkhazisë.

Përmes kësaj njohjeje, Rusia po përpiqet ta bëjë precedent rishkrimin e kufijve nëpërmjet përdorimit të forcës. Përgjigjja e BE-së ishte kaq i vajtueshme sa e la Moskën ta lëndonte atë si një "ndjenjë të përbashkët".<sup>16</sup> Në Samitin e saj të jashtëzakonshëm më 1 shtator 2008, BE-ja dështoi në adresimin kuptimplotë të madje dhe çështjeve themelore si përmirësimi i Planit të Veprimit për Gjeorgjinë në kuadër të Politikës së saj Europiane të Fqinjësisë. BE-ja nuk ka më fare ide rreth marrëdhënies së saj të ardhshme me Rusinë dhe nuk ka ndërmarrë ndonjë hap konkret për të kundërshtuar ndryshimin e njëanshëm të kufirit shtetëror që rezultoi nga njohja e Rusisë për pavarësinë oseto-jugore dhe abkhaze. Rezolutat e dobëta në samitin e saj të jashtëzakonshëm i dërguan Rusisë mesazhin që më e keqja që ajo mund të presë nga BE-ja është një shuplakë në kurrizin e dorës dhe që veprimet e saj do t'i shpëtojnë ndëshkimit serioz.

Edhe më keq, BE-ja ra dakord për një marrëveshje ushtarake me Rusinë në të njëjtën ditë që ajo lëshoi deklaratën e saj për Rusinë, duke siguruar një angazhim rus për katër helikopterë e 200 ushtarakë për misionin e saj të PESHM-it në Çad.<sup>17</sup> Misioni i dominuar nga francezët ka pasur shumë nevojë për helikopterë që prej fillimit në mars 2008 dhe donacioni 1-vjeçar rus i katër helikopterëve të transportit Mi-8MT do të ndihmojë në mënyrë të ndjeshme mungesën operacionale për misionin. Por koha e kësaj marrëveshjeje mbështet një konflikt

<sup>16</sup> "EU Showed "Common Sense" on Georgia Crisis: Putin", Agence France-Presse, September 2, 2008.

<sup>17</sup> Jamie Smyth, "Russian Military Force to Assist EU Mission in Chad", *The Irish Times*, September 4, 2008, at <http://www.irishtimes.com/newspaper/world/2008/0904/1220372097381.html> (September 28, 2008).

të madh interesi nga ana e BE-së dhe veçanërisht e presidentit Sarkozy, i cili ka qenë forca drejtuese për misionin në Çad dhe për përgjigjen e BE-së ndaj sulmit rus mbi Gjeorgjinë.

Lufta gjeorgjiano-ruse ka treguar ndarje të thella mes fuqive europiane rreth mënyrës se si të veprojnë ndaj Ruisë, me shtetet e Europës Qendrore e Lindore dhe atyre nordike nga njëra anë dhe Europës Kontinentale drejtuar nga Franca e Gjermania nga ana tjetër. Nuk duhet të përbëjë surprizë që Europa e re dëshiron të shikojë një veprim më të fortë ndaj rizgjimit të agresionit rus, por Presidenti Sarkozy dhe kancelarja gjermane Angela Merkel kanë deklaruar prioritetin për të vepruar si “kryekomandantë” si ata bëjnë për të gjitha çështjet madhore të politikës së jashtme ku përfshihet BE-ja. Nëse lufta në Gjeorgji është një sinjal i ambicjeve gjeostrategjike të Ruisë dhe një pamje paraprake e asaj që Perëndimi mund të presë nga Moska në të ardhmen, është po ashtu e vërtetë që aksi franko-gjerman do të dominojë çdo reagim të jashtëm të BE-së.

### Ambicja franceze: Të gjithë flasin, asnjë veprim

Nën presidencën franceze të Bashkimit Europian, presidenti Sarkozy parashtrroi një axhendë ambicioze për të rritur identitetin dhe aftësitë e mbrojtjes së Europës, duke paraqitur planet për një strategji të re sigurie dhe për mënyrën si do të ndërmerret një gamë e gjerë misionesh që nga stabilizimi e rindërtimi deri te luftimet e rikonicioni. Parisi shpreson të bëjë progres domethënës në zhvillimin në kohë të PESH-it për samitin përmbyllës së presidencës së BE-së në dhjetor 2008 ku pritet që ai të njoftojë iniciativa të shumta, përfshirë, përmes të tjerash, një forcë të gatshme operationale prej 60.000 trupash të aftë të dislokohet njëherësh e për një periudhë prej 1 viti, një aftësi plotësisht të lëvizshme të ndërhyrjes e reagimit të shpejtë dhe programe të shkëmbimeve ushtarake europiane.<sup>18</sup> Megjithëse, në teori, pengesat e mëdha

---

<sup>18</sup> French Presidency of the Council of the European Union, *Work Programme*, Ue2008.fr, July 1-December 31 2008, pp. 23-25, at [http://www.ue2008.fr/webdav/site/PFUE/shared/ProgrammePFUE/Programme\\_EN.pdf](http://www.ue2008.fr/webdav/site/PFUE/shared/ProgrammePFUE/Programme_EN.pdf) (September 28, 2008).



ligjore ndalojnë progresionin e integritit të mbrojtjes duke marrë parasysh refuzimin e Traktatit të Lisbonës nga Irlanda, pavarësisht kësaj, francezët synojnë të përdorin presidencën e BE-së për të ecur përpara.

Është sigurisht rasti ku Europa si një e tërë kërkon dëshpërimisht të rrisë aftësitë ushtarake. Sërish ka shumë pak të ngjarë që BE-ja ta arrijë këtë. Ashtu si duket shumë qartë se BE-ja ka qenë e suksesshme në marrjen e fuqive politike e burokratike dhe shumë më pak e tillë për sa i përket shpenzimeve të mbrojtjes dhe personelit ushtarak.

Ambicja e Sarkozy-s për mbrojtjen e BE-së lidhet pak me rritjen e aftësive mbrojtëse të Europës dhe lidhet tërësisht me rritjen e fuqisë për një Bashkim European shumë të centralizuar.

Insistimi i Francës që BE-ja duhet të ketë celulën e vet të përhershme të planifikimit operacional shpjegon aspiratat franceze në këtë fushë. Berlin Plus-i u negocua në mënyrë të veçantë mbi mirëkuptimin që operacionet autonome të BE-së do të drejtoheshin nga kryeqytetet kombëtare ose nga Shtabi Suprem i Forcave Aleate në Europë (SHAPE), i vendosur në Belgjikë. Kryeministri Bler ishte i vendosur në këtë pikë kur u hartua Deklarata e St. Malo-s me presidentin francez Zhak Shirak. Për Blerin, një celulë e përhershme e planifikimit të BE-së paraqiste jo vetëm një dublikim të kotë të aseteve të NATO-s, por një shkëputje të dy organizatave. Sigurisht, ka shumë të ngjarë që Shiraku i synonte këto pasoja, por ai fillimisht i hapi rrugë Blerit, duke e ditur që centralizimi i fuqisë brenda Bashkimit European shkon vetëm në një drejtim.

Shiraku ishte korrekt që marrëveshja e St. Malo-s ishte vetëm fillimi i centralizimit në masë të politikës së mbrojtjes së BE-së. Qendra e operacioneve të BE-së me bazë në Bruksel u hap më 1 janar 2007 dhe u vu në provë në një ushtrim imagjinar në qershor të atij viti. Është një shtab i veçantë operacional i përkohshëm i BE-së që merret me operacionet civile a civilo-ushtarake dhe vetëm në rrethana të caktuara. Këto kufizime u zbatuan pas dështimit të objeksioneve britanike për ta eliminuar fare idenë, por sigurisht që do të hiqet pasi identiteti ushtarak i BE-së të marrë formë. Karta e

Bardhë franceze për Sigurinë Kombëtare dhe të Mbrojtjes deklaroi shprehimisht: “Forcohet në mënyrë të konsiderueshme aftësia planifikuese e komanduese europiane. BE-ja duhet të ketë një aftësi të pavarur e të qëndrueshme europiane të planifikimit strategjik. Numri në rritje i ndërhyrjeve të BE-së jashtë saj kërkon, gjithashtu, më shumë aftësi e mundësi të planifikimit e komandimit ushtarak operacional.”<sup>19</sup>

OpCen-i është thjesht ajo çarja e vogël që i hap derën e pasme një shtabi të përhershëm ushtarak të BE-së plotësisht operacional. Kur doli fillimisht propozimi në Bruksel, ambasadori i SHBA-së në NATO Nikolas Berns e përshkroi atë si “kërcënimin më të madh të Aleancës në të ardhmen”.<sup>20</sup> Megjithatë, ideja mori hov real në 2003-shin gjatë ndarjeve të thella të Europës mbi luftën në Irak. Franca, Gjermania, Belgjika dhe vende të tjera ishin të zemëruara nga veprimi i SHBA-së në Irak dhe përfituan nga rasti të hidhnin me forcë në tryezë idenë e një shtabi të pavarur të BE-së në përgjigje të kësaj çështjeje përçarëse të politikës së jashtme.

Fillimisht Britania kërcënoi më vete çdo propozim të tillë, por me avancimin e gjithë elementëve të sigurisë e mbrojtjes europiane, ata e pranuan atë gjithnjë e më shumë. Po kështu, Britania nuk ka pasur ndonjë aftësi reale lidhshme në Bruksel që nga ikja e Margaret Theçerit nga detyra. SHBA-ja dhe Mbretëria e Bashkuar e kanë mbyllur tashmë njërin sy në mbështetje të një politike të cilën fillimisht e kundërshtuan dhe në miratimin e një propozimi që do t’i shkulte zemrën NATO-s. Nuk ka absolutisht asnjë provë që OpCen-i do t’i rrisë vlerë ushtarake apo aftësi mbrojtëse nevojave të gjithanshme të mbrojtjes së Europës.

Synimi i Francës për t’iu bashkuar komandës së integruar ushtarake të NATO-s në shkëmbim të mbështetjes amerikane për një identitet të pavarur të mbrojtjes së BE-së, është një kryekonformizëm politik nga ana e Sarkozy-s, por paraqet asgjë

<sup>19</sup> “The French White Paper on Defence and National Security”, June 2008, Chapter 7, at [http://www.ambafrance-ca.org/IMG/pdf/Livre\\_blanc\\_Press\\_kit\\_english\\_version.pdf](http://www.ambafrance-ca.org/IMG/pdf/Livre_blanc_Press_kit_english_version.pdf) (September 28, 2008).

<sup>20</sup> “EU Military Plans Under Scrutiny”, BBC News Online, October 21, 2003, at <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/3210246.stm> (September 30, 2008).

më pak se sa kabanën e vdekjes për Aleancën e NATO-s. Parisi po i bashkohet strukturës së komandës së integruar ushtarake të NATO-s ndërsa është duke ngritur një dublikatë të saj në Europë e cila do të ndajë aleancën dhe në fund do të shkatërrojë NATO-n. Kur ambasadorja e SHBA-së në NATO Viktoria Nuland njoftoi në shkurt 2008 që administrata amerikane do të mbështesë një identitet të fortë ushtarak të BE-së, ajo përmbysi vite të politikës amerikane të punuara me kujdes. Uashingtoni është verbuar nga çtendosja e fundit e marrëdhënieve franko-amerikane shënjestruar nga enigmatiku Sarkozy.

Planet e drejtuara nga francezët për një krah autonom e të pavarur ushtarak brenda BE-së do të dëmtojnë, gjithashtu, aftësinë e SHBA-së për të vepruar me efektivitet brenda aleancës së NATO-s. Një rritje e identitetit të mbrojtjes së BE-së do të krijojë një grup të brendshëm në NATO ku vendet europiane do të mblidhen me njëri-tjetrin para takimeve të NATO-s. Kjo tashmë ndodh në njëfarë mase, si u tregua kur Gjermania u mor vesh me Francën për të përjashtuar Gjeorgjinë dhe Ukrainën nga marrja e Plan Veprimit të Anëtarësisë në Samitin e NATO-s në Bukuresht në prill 2008. SHBA-ja do të vazhdojë ta gjejë veten në një pozicion gjithnjë e më të dobët për të negociuar me aleatë individualë të NATO-s përpara samiteve dhe do ta gjejë veten të shkëputur nga debatet e sigurisë transatlantike.

Ideologjia gjerësisht pacifiste e Bashkimit European pritet të infektojë NATO-n dhe politika e BE-së do të mbizotërojë. Është shumë ironike që një identitet i ndarë i mbrojtjes së BE-së të jetë me gjasë më shumë për çmilitarizimin e Europës sesa për ripajisjen e saj për të përballuar kërcënimet globale të sigurisë. Si e ka treguar deri tani gjithë projekti european, marrëveshjet politike të shoqëruara me politikat e BE-së kërkojnë lëshime që efektivisht e ndalojnë atë nga ndërmarrja e veprimeve efektive. Kur bëhet fjalë për politikën e jashtme, interesat franko-gjermane janë prioritare dhe vendimet merren vetëm kur Berlioni dhe Parisi janë të sigurtë që ruhen interesat e tyre kombëtare. Me përdorimin e BE-së nga Gjermania e Franca si një mbulesë kozmetike për interesat e politikës së

tyre të jashtme dhe me marrëveshjen me anëtarët e tjerë të BE-së përpara takimeve të NATO-s, SHBA-ja humbet lidhjet e vlefshme me aleatët tradicionalë. Meqë të gjitha vendimet e NATO-s merren me konsensus, BE-ja do ta kthejë një nga forcat më të mëdha të NATO-s në një dobësi të madhe me anë të marrëveshjes paraprake për qëndrimet e saj dhe duke lënë pak vend që SHBA-ja të manovrojë apo edhe të formojë koalicione *ad hoc* me partnerë të gatshëm europianë.

### **Kriza e Mbrojtjes së Europës: Centralizimi i fuqisë, dështimi mbi personelin**

*Bashkimi duhet të ketë kapacitetin për veprim autonom, të mbështetur nga forca të besueshme ushtarake, mjetet për të vendosur t'i përdorë ato dhe një gadishmëri për ta bërë atë, me qëllim për t'iu përgjigjur krizave ndërkombëtare.<sup>21</sup>*

#### Deklarata e Përbashkët e Samitit franko-britanik mbi Mbrojtjen Europiane

Kur ish-kryeministri Toni Bler nënshkroi Deklaratën e St. Malo-s, ai ishte i vendosur që një identitet i mbrojtjes së BE-së duhej të paraqiste vlerë të shtuar për sigurinë transatlantike. Kur Bleri pa Qëllimin Kryesor të BE-së në 1999 - që synonte të kishte deri në 60.000 trupa të disponueshëm për një dislokim deri njëvjeçar për menaxhimin e krizave - ai donte të mundësonte një aftësi serioze të menaxhimit të krizave që më shumë të bashkëpunonte me të vërtetë me NATO-n sesa të krijonte një ushtri të qëndrueshme europiane. SHBA-ja ishte qartësisht e tërhequr nga perspektiva e marrjes nga BE-ja të më shumë përgjegjësi për sigurinë e Europës dhe dy organizatat përputhen strategjitë e tyre të planifikimit të mbrojtjes për të identifikuar fushat kyçe ku duheshin plotësuar boshllëqet. Angazhimi i Pragës për Aftësitë (PCC) e NATO-s dhe Plan Veprimi Europian për Aftësinë e BE-së (ECAP)

<sup>21</sup> "Franco-British Summit Joint Declaration on European Defense", Saint-Malo, December 5, 1998, at <http://www.atlanticcommunity.org/Saint-Malo%20Declaration%20Text.html> (September 28, 2008).

identifikuan shumë fusha bashkëpunimi, përfshirë urat strategjike ajrore e detare, furnizimin me karburant gjatë fluturimit dhe mbrojtjen nga armët nukleare, biologjike e kimike.

Fatkeqësisht, shumë pak është bërë nga fjalimet e mëdha të Europës dhe më shumë se sa vlerë të shtuar, tani BE-ja thjesht po ofron një përshtjellim nga detyrimet e anëtarëve të NATO-s. Në fakt, ka pasur më shumë konflikt se komplementaritet. Për shembull, kur Bashkimi Afrikan (BA) kërkoi mbështetje ajrore për Darfurin nga BE-ja, SHBA-ja dhe Kanadaja në qershor 2005, BE-ja refuzoi të koordinonte me NATO-n, duke insistuar për “markën” europiane për operacionin. Përfundimisht, u ngritën dy ura të ndara ajrore për të cilat BA-së iu kërkua t’i koordinonte, meqë Franca këmbënguli që BE-ja ta konsideronte veten si lojtari kryesor në çështjet e sigurisë afrikane.

Krijimi i Grupeve Luftuese të BE-së (BG) mishëron dëshirën e BE-së për fuqi në kurriz të NATO-s. BG-të janë njësi të njëjta me masën e batalionit, kombëtare ose shumëkombëshe, me 1500 trupa, të afta të dislokohen brenda 10 ditësh në zona të largëta e armiqësore. Këto numra mendohet t’i shtohen planit të Sarkozy-s për një ushtri të BE-së prej 60.000 trupash. BG-të arritën aftësi të plotë operacionale në janar 2007 dhe tani qëndrojnë në pritje për dislokim. Megjithatë, ato nuk janë një forcë e përhershme rezervë në pritje pasi shumica e vendeve kontribuuese janë ose jo të gatshëm ose të pamundur për të investuar në burime e personel për të krijuar kapacitet shtesë. Prandaj, në mënyrë të paevitueshme, BE-ja do të duhet të thithë të njëjtat rezerva të cilat janë në gadishmëri në kuadër të NATO-s.<sup>22</sup>

BG-të janë, gjithashtu, një dublim i Forcës së Reagimit të NATO-s (NRF). NRF-ja u propozua nga ish-Sekretari i Mbrojtjes së SHBA-së Donald Ramsfeld në 2002, si një mekanizëm i ri dhe i vlefshëm ku 20 deri 25 mijë trupa shumë të aftë e të stërvitur të mund të dislokoreshin në çdo zonë veprimi në botë për të ndërmarrë një numër misionesh për

---

<sup>22</sup> “NATO-EU Relations”, World Security Institute, Brussels, January 16, 2006, at <http://www.wsibrussels.org/showarticle.cfm?id=191> (September 30, 2008).

deri 30 ditë. Esencialisht, shumica e këtyre trupave do të vinin nga Europa, sesa nga SHBA-ja. NRF-ja paraqet një aspekt kyç transformimi të aleancës së NATO-s dhe është përdorur tashmë me sukses, përfshirë reagimin e saj të shpejtë në kriza humanitare si ajo e tërmetit shkatërrues në Pakistan në fund të 2005 dhe gjatë zgjedhjeve presidenciale në Afganistan në tetor 2004. Por NRF-ja do të mbetet pa forcat e saj të nevojshme nëse BE-ja therret BG-të e saj në të njëjtën kohë. Qeveritë janë sigurisht të kujdesshme për ta shmangur këtë konflikt, por ka kaq shumë për të bërë ndërkohë që burimet janë kaq të pakta. Pa euro të tjera për mbrojtjen dhe pa ushtarë të rinj europianë, BG-të e BE-së duhen parë si asgjë më pak sesa një dublikim direkt i mekanizmit të NATO-s dhe një sfidë ndaj iniciativës transformuese të NATO-s.

Pa dyshim që do të bëhet më e vështirë për planifikuesit ushtarakë të NATO-s për të ditur se cilat asete janë realisht të disponueshme për ta, veçanërisht kur BE-ja të realizojë ëndrrën e një shtabi të përhershëm planifikimi e komandimi jashtë SHAPE-s. Sarkozy është fare i ndërgjegjshëm që gati 10.000 trupa europiane të NATO-s janë tashmë të angazhuar, duke u tallur me anë të propozimit të tij për një forcë prej 60.000 trupash të dislokueshme.<sup>23</sup> Megjithatë, ai nuk shqetësohet për të numëruar dy herë ushtarët nga e njëjta rezervë e forcës kombëtare pasi ai parashikon mbizotërimin e BE-së në arenën e sigurisë europiane.

Në një raport themelor, *Aftësitë Ushtarake Europiane*, Instituti Ndërkombëtar për Studime Strategjike (IISS) konkludoi që vetëm 2.7% e personelit ushtarak prej 2 milionë personash të Britanisë dhe Europës mund të dislokohen përtej detit.<sup>24</sup> Kjo dallon dukshëm nga synimi i NATO-s që 40% e forcave të saj tokësore të jenë të dislokueshme, çka në vetvete ishte një synim modest dhe i arritshëm. Raporti i IISS-së theksoi një numër mangësish kritike të aftësive ushtarake të Europës - një mungesë të aftësive bazë, procedura të gjata e të kushtueshme

<sup>23</sup> Ibid.

<sup>24</sup> *Press Launch for European Military Capabilities: Building Armed Forces for Modern Operations*, International Institute for Strategic Studies, July 9, 2008, at <http://www.iiss.org/publications/strategic-dossiers/european-military-capabilities/press-statement> (October 8, 2008).

prokurimi dhe një mungesë të kërkim-zhvillimit në mbrojtje.<sup>25</sup> Duket qartë se anëtarët nuk po arrijnë të investojnë sa duhet as për aftësitë e NATO-s as në ato të BE-së duke përbërë një rast më të fortë për një fokus më të mprehtë vetëm në një arenë. Duke konsideruar që instrumentet civile të BE-së nuk janë të disponueshme për NATO-n sido që ta kthesh marrëveshjen Berlin Plus, është e vështirë të shohësh ndonjë vlerë për NATO-n nga PESH-i.

Një limit tjetër i NATO-s që nuk është arritur janë shpenzimet për mbrojtjen. Vetëm 4 nga 21 anëtarëve të BE-së - NATO-s shpenzojnë limitin e NATO-s prej 2% të GDP-së së tyre për mbrojtjen (Bullgaria, Franca, Greqia dhe Mbretëria e Bashkuar). Shpenzimet mesatare të BE-së për mbrojtjen janë ulur ndjeshëm 10 vitet e fundit, duke treguar që burimet e vlefshme thjesht do të kalojnë nga NATO-ja te PESH-i.

Një fushë ku BE-ja është shquar është krijimi i strukturave të përhershme politike e burokratike. Me një Komitet Politik e të Sigurisë (PSC), një Komitet Ushtarak dhe një Staf Ushtarak BE-ja ka krijuar një rrjet kompleks grupesh pune, forumesh konsultimi e rregullimesh të përhershme për të hyrë në hapësirën e NATO-s. Nga vetë natyra e saj, BE-ja është një burokraci teknike dhe prandaj, ka një vullnet të pareshtur për ndërtim institucionesh. Megjithatë, ajo nuk ka vullnetin politik për veprim serioz apo mjetet me të cilat të bëjë përçapje të tilla.

### **Dështimi në lidhshpërinë politike**

Një fushë ku BE-ja dhe NATO-ja kanë punuar bashkë tradicionalisht është çështja e zgjerimit. Në përgjithësi, zgjerimi i BE-së ka imituar zgjerimin e NATO-s, duke reflektuar një ndjenjë të angazhimeve të përbashkëta politike ndaj vendeve aspirante. Megjithatë, kjo politikë e BE-së duket t'i largohet sjelljes së saj historike.

Kroacia dhe Shqipëria nënshkruan marrëveshjen e pranimit në NATO në qershor 2008 dhe kur anëtarësia e tyre të ratifikohet nga parlamentet e tyre dhe nga 26 anëtarët ekzistues, dy vendet do të marrin anëtarësinë e plotë. Shtetet e Bashkuara

<sup>25</sup> Ibid.

i dërguan një sinjal pozitiv pjesës tjetër të aleancës së NATO-s kur Senati u bë i pari që e ratifikoi anëtarësinë në NATO të Kroacisë e Shqipërisë. SHBA-ja ka treguar lidhshmëri ndaj pjesës tjetër të aleancës së NATO-s duke deklaruar që ajo e konsideron NATO-n ende të hapur për aktivitete dhe një pjesë vitale të arkitekturës së sigurisë transatlantike.<sup>26</sup>

Në kontrast me këtë, Merkelu dhe Sarkozy tashmë kërcënojnë të bllokojnë çdo zgjerim tjetër të BE-së nëse nuk ratifikohet Traktati i Lisbonës (me gjithë refuzimin e Traktatit nga votuesit irlandezë), duke rrezikuar seriozisht hyrjen në kohë të Kroacisë në BE. Kjo lëvizje e pandershme dhe qartësisht politike nga Franca dhe Gjermania është kritikuar gjerësisht, së fundi dhe nga Komisioneri i BE-së për Zgjerimin Olli Rehn, i cili deklaroi se është e mundur të përfundohen negociatat teknike të anëtarësimit me Kroacinë para fundit të 2009.<sup>27</sup> Një vonesë serioze dhe e padrejtë e hyrjes së Kroacisë në BE do ta vendoste Shqipërinë dhe Maqedoninë në një neglizhencë të përhershme dhe do të dërgonte mesazhin e destabilitetit në rajon.

Përveç kësaj, në Samitin e NATO-s në Bukuresht, kancelarja Merkel i priu një koalicioni franko-gjerman për të shtyrë pranimin e Gjeorgjisë në Plan Veprimin e Anëtarësimit (MAP) deri në dhjetor 2008 në një përpjekje të dështuar për të shmangur “provokimin” e Rusisë. Ky akt përmbysi pozicionin e mëparshëm gjerman në mbështetje të një politike të dyerve të hapura për NATO-n dhe ishte në kontrast të drejtpërdrejtë me mbështetjen e qartë të presidentit Bush për Kievin dhe Tbilisin në samit.<sup>28</sup>

<sup>26</sup> “White House Welcomes Senate NATO Votes for Albania, Croatia”, Agence France-Presse, September 26, 2008, at <http://afp.google.com/article/ALeqM5jfv0sY3GywaT6c6VEYTbf7l9IHA> (September 30, 2008).

<sup>27</sup> Tony Barber, “Lisbon Treaty Rejection “No Excuse to Block Expansion””, *The Financial Times*, September 19, 2008, at [http://www.ft.com/cms/s/0/fc32fd36-85e2-11dd-a1ac-0000779fd18c.html?nclink\\_check=1](http://www.ft.com/cms/s/0/fc32fd36-85e2-11dd-a1ac-0000779fd18c.html?nclink_check=1) (September 28, 2008).

<sup>28</sup> Ministri gjerman i Mbrojtjes Franz-Josef Jung deklaroi në shkurt 2008: “NATO-ja nuk është vetëm një aleancë ushtarake. Ajo ishte dhe është ende një komunitet i bazuar mbi vlera. Dera jonë është e hapur për ata që janë të përgatitur t’u përshtaten parimeve të Aleancës sonë.” Franz-Josef Jung, “The World in Disarray-Shifting Powers, Lack of Strategies”, Munich Conference on Security Policy, February 8, 2008, at [http://www.securityconference.de/konferenzen/rede.php?menu\\_2008=&menu\\_konferenzen=&sprache=en&id=203](http://www.securityconference.de/konferenzen/rede.php?menu_2008=&menu_konferenzen=&sprache=en&id=203) (September 28, 2008).



BE-ja duhet të rivleresojë qasjen e saj në lidhje me anëtarësinë e Kroacisë në BE dhe Europa duhet të marrë në konsideratë përshpejtimin e hyrjes së Gjeorgjisë e Ukrainës në MAP-in e NATO-s. Kjo do të vazhdonte një nga politikat më pozitive të post-Luftës së Ftohtë për komunitetin transatlantik dhe do të dërgonte një mesazh që anëtarësimi në NATO dhe në BE është një mundësi për ata që e kërkojnë aktivisht atë.

### **Një marrëdhënie e re për NATO-n dhe BE-në**

*NATO-ja... lëvdohet me krenari që ka një “partneritet strategjik” ndërmjet NATO-s dhe BE-së. Nuk ka asgjë të tillë, vetëm një konkurrim bazë strategjik mes Amerikës dhe Europës.<sup>29</sup>*

**Robin Harris**

**Këshilltar i zonjës Theçer, maj 2006**

Nuk ka kohë më të mirë sesa tani për të riparë marrëdhëniet NATO-BE, ndërkohë që NATO-ja i afrohet samitit të 60-vjetorit të saj në 2009-n. Samiti i Strasburg - Kehl-it do të përfundojë me një Deklaratë mbi Sigurinë e Aleatëve që nënvizon qëllimin e NATO-s dhe potencialisht shtron rrugën për një Koncept të ri Strategjik për Aleancën. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jaap de Hoop Scheffer e ka përshkruar Deklaratën si “një produkt madhor” të samitit.<sup>30</sup>

Është pikërisht rasti që Europa dhe Amerika të kenë interesa të ndërsjellta sigurie. Megjithatë, sipas PESM-it, BE-ja po dublon rolin e NATO-s ndërkohë që po i ndan aleancat. Kjo nuk kontribuon në sigurinë globale. Prandaj, nëse samiti synon të qartësojë marrëdhëniet NATO-BE, ai nuk duhet të mbështesë përshpejtimin e një identiteti ushtarak të BE-së, por në vend të kësaj të shprehë qartë dy pika të paneglizhueshme:

<sup>29</sup> Robin Harris, *Beyond Friendship: The Future of Anglo-American Relations* (Washington, D.C.: The Heritage Foundation, 2006), May 24, 2006, p. 91, at <http://www.heritage.org/Research/Europe/wm1091Ch5.cfm>

<sup>30</sup> Fjala e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jaap de Hoop Scheffer në një seminar mbi marrëdhëniet mes BE-së dhe NATO-s, Paris, 7 korrik 2008, at <http://www.nato.int/docu/speech/2008/s080707b.html> (September 28, 2008).

1. prioriteti i NATO-s në aleancën e sigurisë transatlantike është suprem dhe
2. marrëdhënia e BE-së ndaj NATO-s është si një komplement civil dhe BE-ja përcaktohet si një aktor civil në aleancën e sigurisë transatlantike.

NATO-ja ka shumë marrëveshje partneriteti; në fakt, kjo është një nga pikat e saj të forta. Programet e saj të Partneritetit për Paqe dhe Dialogut Mesdhetar kanë rezultuar në shumë marrëdhënie të frytshme dhe bashkëpunuese. Nxitimi për të ngritur marrëdhënien e saj me BE-në mbi gjithë të tjerat është një gabim. Meqë shumica e anëtarëve të BE-së janë tashmë anëtarë të NATO-s dhe nuk ka asnjë forcë shtesë vetëm të BE-së, koncepti i bërjes së ushtrimeve të përbashkëta apo i kombinimit të forcave të reagimit të shpejtë është i panevojshëm. Në fakt, mbivendosja e anëtarësive shuan vlerat ushtarake të përfshirjes së BE-së në këtë fushë. Në një kohë kur nevojat e NATO-s për t'u përqendruar mbi mësimet nga praktika në Afganistan, duke zhvilluar një koncept të ri strategjik dhe duke adresuar çështjet e transformimit, marrëdhënia e saj me BE-në është një çoroditje e panevojshme.

Prandaj, një kategori e re duhet të formulohet për të përcaktuar statusin e marrëdhënies së BE-së me NATO-n. Ndërsa zgjidhja e konfliktit kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, BE-ja ofron mundësinë e qenies në radhë të parë një komplement civil, i dislokueshëm i aleancës së NATO-s. Rruga që NATO-ja dhe BE-ja të punojnë së bashku në fushën ushtarake është e mbushur me probleme dhe e udhëhequr nga një dëshirë për të siguruar një fuqi bazë të BE-së. BE-ja ka një ushtri burokratësh, trajnues policie, punonjës ndihmës dhe juristë për të plotësuar një qasje më të mirë për rindërtimin dhe zhvillimin. Si ka treguar Afganistani, shpesh është e nevojshme për këta profesionistë të punojnë përkrah ushtarakëve. Misionet civile janë detyra që BE-ja favorizon natyrshëm dhe për përmbushjen e të cilave BE-ja ka njëfarë kapaciteti. Pas Samitit të Feira-s në 2000-shin, kur BE-ja përvijoi synimet e saj për menaxhimin e krizave civile në nivel BE-je, ajo i tejkaloi shpejt pritshmëritë me 5.700 punonjës

policie, 630 ekspertë ligjorë, 560 ekspertë të administratës civile dhe 5.000 ekspertë të mbrojtjes civile aktualisht të disponueshëm për BE-në.

Në lidhje me këtë, mekanizmat konsultative të NATO-s mund të thjeshtohen, me pak nevojë për rrjetin kompleks të verifikimeve të sigurisë dhe komiteteve politike. BE-ja i ka rezistuar për një kohë të gjatë konceptit që çdo institucion duhet të punojë aty ku ai ndihet i fortë dhe në vend të kësaj është fokusuar në zhvillimin e roleve dublikate. Është provuar që kontributi i saj i kufizuar në sigurinë globale ndoshta mund të jepet në sferën civile, nëse ajo ka vullnetin për të përqendruar përpjekjet e saj në këtë fushë. Idealisht, duhet të miratohet një Strategji e thjeshtë dhe e modifikuar e Sigurisë Europiane.

Megjithatë në praktikë, BE-ja do të vazhdojë të armatohet në mënyrë institucionale e programore për një identitet të pavarur të mbrojtjes dhe duhet të përgatitet për të ndërmarrë investime politike e financiare të nevojshme për ta bërë atë realitet. Nëse BE-ja dëshiron të veprojë në zona të botës ku NATO-ja nuk vepron, atëherë nuk ka arsye pse NATO-ja duhet të pritët të ofrojë burimet e saj për këto misione. Nëse BE-ja vërtetë beson se siguria globale rritet duke u angazhuar në misione ushtarake në të cilat nuk vepron NATO-ja, atëherë ajo duhet të paguajë për ato ekskluzivisht nga buxhetet europiane dhe të përdorë asetet dhe personelin europian. Në përcaktimin e një marrëdhënieje të re NATO-BE, duhet të kërkohej që këto asete dhe burime të jepen *veç* kontributeve të anëtarëve për NATO-n e jo duke shpenzuar ato. Në radhë të parë, çdo investim në PESM nuk duhet të përshtjellojë angazhimet e anëtarëve ndaj NATO-s.

### **Çfarë duhet për ta realizuar**

**NATO-ja duhet të jetë guri i themelit** i aleancës transatlantike dhe aktorja parësore në sigurinë europiane. Kjo duhet të shprehet qartë në negociatat që po bëhen për një koncept të rishikuar strategjik për NATO-n dhe në Samitin e saj në 2009-n. Në përcaktimin e rolit të saj në arkitekturën e

sigurisë transatlantike, BE-ja duhet të inkurajohet të zhvillojë rolin e saj civil, duke punuar me Transformimin e Komandës Aleate të NATO-s për të koordinuar atë se çfarë roli mund të luajë në ndihmë të NATO-s.

**SHBA-ja duhet t'i ruajë burimet e NATO-s ekskluzivisht për misionet e NATO-s.** Të gjithë misionet ushtarake europiane duhet të financohen ekskluzivisht nga shtetet anëtare të BE-së. Taksapaguesit amerikanë nuk duhet të subvencionojnë aventurat ushtarake europiane. Kushtet e Berlin Plus-it duhet të rishikohen për ta reflektuar këtë, meqë bashkëpunimi NATO-BE është përcaktuar si komplementaritet civil i BE-së ndaj NATO-s. Asetet dhe mundësitë për një Politikë të rireformuar civile Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes duhet të jenë në dispozicion të NATO-s sipas kushteve të një marrëveshjeje të rishikuar të Berlin Plus-it.

**PESM-i duhet të paraqesë burime *shtesë*** për sigurinë europiane. Ai nuk duhet të jetë një opsion alternativ për anëtarët në BE dhe NATO për t'u tërhequr nga detyrimet e tyre të NATO-s. Krijimi i PESM-it si një komponent civil në arkitekturën e sigurisë globale duhet të japë vlerë të shtuar, më shumë sesa t'i lejojë anëtarët në BE e NATO për të zgjedhur mes misioneve të NATO-s apo t'i hapi derën një Aleance me lidhje të dyfishta.

**Anëtarët e NATO-s duhet të arrijnë limitin e NATO-s të shpenzimeve prej 2% të GDP-së së tyre për mbrojtjen kombëtare.** Ku është e mundur, anëtarët duhet të miratojnë buxhete afatgjata dhe shtesë për të financuar angazhimet e ardhshme dhe ato në zhvillim e sipër.

**Shtetet e Bashkuara duhet ta nxisin presidentin francez për të bërë një deklaratë pa ekuivoqe mbi supremacinë e NATO-s në Samitin e NATO-s në Strasburg më 2009.** Franca duhet të ripranohet në strukturat e komandës së integruar ushtarake të NATO-s vetëm nëse Parisi ka vullnetin të mbështesë supremacinë e NATO-s në bashkëpunimin e mbrojtjes europiane dhe kur aleanca mund të jetë e sigurtë se Parisi do të jetë një partner bashkëpunues sesa kundërshtues.

**SHBA-ja duhet të inkurajojë anëtarët e aleancës së NATO-s për të përshpejtuar ratifikimin e anëtarësisë në NATO të Kroacisë dhe Shqipërisë dhe të rideklarojë mbështetjen e saj për të përshpejtuar MAP-in për Gjeorgjinë dhe Ukrainën.** Shtetet e Bashkuara duhet të bashkëpunojnë ngushtë me aleatët e tyre në Europë dhe të vazhdojnë politikën e derës së hapur të NATO-s.

## **Konkluzion**

Qëllimi i NATO-s vazhdon të mbetet thelbësisht i njëjti: “Të ruajë lirinë dhe sigurinë e vendeve anëtare të saj me mjete politike e ushtarake”. PESHM-i ka luajtur një rol të vogël ose inekzistent në përmbushjen e këtij qëllimi dhe asgjë nuk ka ndodhur që prej firmosjes së Deklaratës së St. Malo-s që e përmiresoi ndjeshëm pozicionin ushtarak të Europës. Avokatët e PESHM-it vazhdojnë të pretendojnë përfitime nga integrimi i mëtejshëm evropian, ndërkohë që injorojnë dobësitë e saj të mëdha dhe arritjet e varfra. Rritja e fuqisë është forca kryesore motivuese që udhëheq PESHM-in, shoqëruar nga pretendimi që NATO-ja nuk është më guri i themelit të aleancës së sigurisë transatlantike.

Si një aleancë ushtarake, NATO-ja ka të drejtën të presë nga anëtarët e saj që të marrin përgjegjësitë e anëtarësimit si dhe të gëzojnë përfitimet. Por dëshira e Amerikës për të parë Europën të luajë një rol më të madh në çështjet botërore ka çuar në një humbje të besimit që kjo të mund të ndodhë nën drejtimin e Bashkimit Evropian. Anëtarët evropianë të aleancës së NATO-s, duke vepruar si vende sovraane e të pavarur, do të ishin më mirë të pozicionuar për t'i shërbyer interesave të sigurisë transatlantike brenda Aleancës sesa si anëtarë të një institucioni të tejnacionalizuar e antidemokratik.

*Sally McNamara është një analist politik në Çështjet Europiane në Qendrën për Lirinë Margaret Thatcher, pjesë e Institutit për Studime Ndërkombëtare Kathryn and Shelby Cullom Davis, në The Heritage Foundation. Autori falënderon Erica Munkwitz-in për ndihmën e saj në përgatitjen e këtij dokumenti.*

## NATO - BE: NJË PARTNERITET STRATEGJIK

NATO-ja dhe Bashkimi European punojnë së bashku për të parandaluar e zgjidhur krizat dhe konfliktet e armatosura në Europë e më gjerë.

Ato ndajnë interesa të përbashkëta strategjike dhe bashkëpunojnë në bazë të komplementaritetit dhe partneritetit. Vendimi për të bashkëpunuar për çështjet e sigurisë daton më 24 janar 2001, kur sekretari i përgjithshëm i NATO-s dhe Presidenca e BE-së shkëmbyen letrat duke përcaktuar qëllimin e bashkëpunimit dhe modalitetet e konsultimit mes dy organizatave.

Që atëherë bashkëpunimi ka avancuar, veçanërisht me firmosjen e “Deklaratës landmark NATO-BE për PESM-in”, e cila si pikë referimi shtroi rrugën për rregullimet e “Berlin Plus-it”, të cilat përbëjnë bazën e punës praktike në menaxhimin e krizave mes dy organizatave.

Që prej zgjerimit të dy organizatave në 2004, 21 vende anëtare të BE-së janë anëtarë të NATO-s.

### **Si evoluoi politika?**

“Deklarata NATO-BE për Politikën Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PESM)” dhe marrëveshja mbi rregullimet e “Berlin Plus”-it janë themelet në evoluimin e partneritetit strategjik NATO-BE.

### **“Deklarata NATO-BE për PESM-in”**

“Deklarata NATO-BE për PESM-in”, miratuar më 16 dhjetor 2002, jo vetëm riafirmoi se BE-ja siguroi akses në aftësitë planifikuese të NATO-s për operacionet e veta

ushtarake, por, gjithashtu, përsëriti principet e mëposhtme politike të partneritetit strategjik:

- Konsultim efektiv të ndërsjelltë;
- Barazi dhe respekt i duhur për autonominë e vendimmarrjes së BE-së dhe NATO-s;
- Respekt për interesat e shteteve anëtare të BE-së dhe NATO-s;
- Respekt për parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara;
- Zhvillim koherent, transparent dhe reciprokisht përforcues i kërkesave për aftësinë ushtarake, të përbashkëta për të dy organizatat.

### **Rregullimet e “Berlin Plus”-it**

Pas vendimit politik të dhjetorit 2002, rregullimet e “Berlin Plus”-it, të miratuara më 17 mars 2003, siguruan bazën për bashkëpunimin NATO-BE në menaxhimin e krizave duke i lejuar BE-së akses në asetet dhe mundësitë kolektive të NATO-s për operacionet e drejtuara nga BE-ja. Në fakt, ato i lejuan Aleancës të mbështesë operacionet e drejtuara nga BE-ja në të cilat NATO-ja nuk angazhohej. Ato konsistojnë në elementët e mëposhtëm madhorë:

- Një Marrëveshje e Sigurisë NATO-BE (mbulon shkëmbimin e informacionit të klasifikuar sipas rregullave reciproke të mbrojtjes së sigurisë);
- Akses i siguar i BE-së të aftësive planifikuese të NATO-s për përdorimin aktual në planifikimin ushtarak të operacioneve të menaxhimit të krizave të drejtuara nga BE-ja;
- Disponueshmëri e aftësive dhe asetëve të përbashkëta të NATO-s, si njësitë e komunikacionit dhe shtabet për operacionet e menaxhimit të krizave të drejtuara nga BE-ja.
- Procedura për lëshimin, monitorimin, rikthimin dhe kërkimin e asetëve dhe mundësive/aftësive të NATO-s;
- Terma reference për zëvendëskomandantin suprem aleat i NATO-s (DSACEUR) e NATO-s - i cili në parim do të jetë komandanti i operacionit për operacionet e drejtuara nga BE-ja sipas rregullimeve të “Berlin Plus”-it (dhe që

është gjithmonë një europian) - dhe opsionet e komandës europiane për NATO-n;

- Rregullimet e konsultimeve NATO-BE në kontekstin e një operacioni të menaxhimit të krizës të drejtuar nga BE-ja që sjellin përdorimin e asetëve e aftësive të NATO-s;
- Përfshirjen në sistemin e ngritur prej kohësh të planifikimit të mbrojtjes së NATO-s të nevojave dhe mundësive ushtarake që mund të kërkohen për operacionet ushtarake të drejtuara nga BE-ja, duke siguruar kështu disponueshmërinë e forcave të mirëpajisura, të stërvitura si për operacionet e drejtuara nga NATO-ja, si për ato të drejtuara nga BE-ja.

### **Çfarë nënkupton kjo në praktikë?**

Krahas takimeve të rregullta, dy organizatat punojnë së bashku në terren sipas rregullimeve të “Berlin Plus”-it. Ato kanë vendosur, gjithashtu, të zhvillojnë bashkëpunimin për të luftuar terrorizmin dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë dhe po punojnë për planifikimin e përbashkët të zhvillimit të aftësive.

Zyrtarët e NATO-s dhe BE-së takohen rregullisht në nivele të ndryshme, 2 herë në vit në nivel ministrash të jashtëm, në nivel ambasadorësh (Këshilli i Atlantikut të Veriut me Komitetin Politik dhe të Sigurisë së BE-së) minimalisht 3 herë në semestër, në nivel Komiteti Ushtarak 2 herë në semestër, rregullisht në nivel komiteti, në nivel stafi në mënyrë të shpeshtë e rutinore.

Ngritja e marrëveshjeve të ndërlidhjes së përhershme ushtarake konsiderohet të lehtësojë bashkëpunimin në nivel operacional. Propozimet përfshijnë ngritjen e një bërthame të BE-së në SHAPE (komanda strategjike e NATO-s për operacionet në Mons, Belgjikë) dhe marrëveshjet e ndërlidhjes/kontaktit të NATO-s në Stafin Ushtarak të BE-së.

### **Puna në terren sipas rregullimeve të “Berlin Plus”-it**

Nën dritën e përmirësimeve thelbësore në mjedisin e sigurisë së Bosnje-Hercegovinës, kërret e shteteve dhe qeverive



të NATO-s vendosën në Samitin e Stambollit të përfundojnë operacionin SFOR të Aleancës në këtë vend në fund të 2004-s dhe të përgatisin një tranzicion të butë për një mision vijues të drejtuar nga BE-ja në kuadrin e rregullimeve të “Berlin Plus”-it. Në praktikë, kjo do të nënkuptojë që BE-ja do ta kryejë misionin në koordinim e bashkëpunim të ngushtë me NATO-n: ajo do të ketë akses në asetet dhe planifikimin e NATO-s dhe zëvendëskomandantit suprem aleat i NATO-s në Europë do të jetë komandanti i Operacionit të BE-së. Emri i forcës së re të BE-së në Bosnje-Hercegovinë do të jetë “Althea”. NATO-ja do të mbetet e angazhuar në stabilizimin e Bosnje-Hercegovinës dhe do të ruajë praninë e saj në vend. Ajo do të mbajë një shtab në Sarajevë dhe do të vazhdojë ta ndihmojë këtë vend në fusha të tilla si reforma e mbrojtjes dhe lufta ndaj terrorizmit.

Më 31 mars 2003, Operacioni i drejtuar nga BE-ja “Concordia” mori përgjegjësitë e misionit të drejtuar nga NATO-ja, Operacioni “Allied Harmony”, në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Concordia përfundoi më 15 dhjetor 2003 dhe u zëvendësua nga misioni policor i drejtuar nga BE-ja “Proxima”.

Sipas rregullimeve të “Berlin Plus”-it, DSACEUR-i u caktua si komandant operacioni i këtij misioni të parë ushtarak paqeruajtjeje të drejtuar nga BE-ja. NATO-ja mbështeti BE-në në planifikimin strategjik, operacional e taktik. Një Shtab Operacional i BE-së (OHQ) u ngrit në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate të NATO-s në Europë (SHAPE), në Mons, Belgjikë, për të ndihmuar komandantin operacional. Përveç kësaj, një “Element i Komandës së BE-së” (EUCE) u ngrit në AFSOUTH në Napoli, Itali (e cila është komanda e Forcës së Bashkuar të NATO-s për operacionet në Ballkan). Shefi i Stafit të AFSOUTH-it u bë gjithashtu shefi i Stafit të Elementit të Komandës së BE-së, i asistuar nga një drejtor për Operacionet e BE-së.

Këto poste të dyfishta NATO-BE garantuan lidhjen ndërmjet zinxhirit të komandës operacionale të BE-së dhe NATO-s gjatë Concordia-s. Ky mision ishte i pari në të cilin asetet e NATO-s iu vunë në dispozicion BE-së.

Pak muaj më vonë, në qershor 2003, BE-ja dhe NATO-ja publikuan një “Qasje të Bashkërenduar për Ballkanin Perëndimor”, e cila përvijon fushat kryesore të bashkëpunimit dhe thekson vizionin dhe vendosmërinë e përbashkët që të dyja organizatat ndajnë për të sjellë stabilitet në rajon.

### **Fusha të tjera të bashkëpunimit**

Ministrat e Jashtëm të BE-së dhe NATO-s kanë riafirmuar vullnetin e tyre për të zhvilluar bashkëpunim më të ngushtë për të luftuar terrorizmin dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë. Institucionet kanë shkëmbyer tashmë informacion mbi aktivitetet e tyre në fushën e mbrojtjes së popullsisë civile ndaj sulmeve kimike, biologjike, radiologjike e nukleare. NATO-ja dhe BE-ja gjithashtu konsultohen për çështje të tjera me interes të përbashkët, si p.sh., situata në Moldavi dhe Afganistan.

Planifikimi i përbashkët i zhvillimit të aftësive dhe mbështetja e ndërsjellë ndërmjet Angazhimit të Pragës për Aftësitë (PCC), të NATO-s dhe Plan Veprimit Europian për Aftësitë, të BE-së (ECAP) janë bërë gjithashtu pjesë e axhendës NATO-BE.

Plan Veprimi i mëparshëm Europian për Aftësitë të BE-së (ECAP) përmbante një katalog të forcave dhe mundësive/ aftësive për Qëllimin Kryesor të BE-së (të mundet të dislokojë deri në 60.000 trupa në fund të 2003-shit për misione humanitare dhe shpëtimi, si dhe për paqeruajtje e paqevënie). Ekspertët e NATO-s siguruan këshillin ushtarak e teknik duke filluar nga përgatitjet deri tek implementimi i ECAP-it. Planifikimi i aftësive të NATO-s dhe BE-së dhe mbështetja e ndërsjellë ndërmjet Angazhimit të Pragës për Aftësitë (PCC), të NATO-s dhe Plan Veprimit Europian për Aftësitë, të BE-së (ECAP) po trajtohen në Grupin e Aftësisë NATO-BE, të ngritur në maj 2003.

Që prej asaj kohe, BE-ja njoftoi krijimin e një koncepti të ri në shkurt 2004, i cili do të çonte në ngritjen e njësie të reagimit të shpejtë të përbërë nga grupe të përbashkëta luftimi.

Sipas “Qëllimit të ri Kryesor” për vitin 2010, këto njësi do të zhvillohen plotësisht në 2007.

“Qëllimi Kryesor” parasheh, gjithashtu, krijimin e një Agjencie të BE-së për Mbrojtjen që do të fokusohet në zhvillimin e aftësive të mbrojtjes, kërkimit, blerjen dhe armatimit. Në fakt, “Qëllimi Kryesor” synon ta përkthejë Strategjinë Europiane të Sigurisë në objektiva konkrete ushtarake me qëllim për të përmbushur zhvillimin afatgjatë të aftësisë së BE-së.<sup>1</sup>

---

<sup>31</sup> [www.nato.int](http://www.nato.int)

Marco Vincenzino

## PUBLIKU NË PERËNDIM DUHET TË BLEJË NË AFGANISTAN - DHE SHPEJT

Marco Vincenzino ndien se publiku në vendet e NATO-s po humbet interesin për luftën në Afganistan. Dhe ai argumenton që humbja e interesit - dhe e mbështetjes - mund të çojë në humbjen e luftës.

Në fund të fundit, e ardhmja e Afganistanit do të varet gjerësisht nga fakti nëse qeveria qendrore do të mundet të përmbushë, apo të paktën të krijojë perceptimin e përmbushjes së pritshmërive kryesore të afganeve. Nëse ajo nuk i përmbush, mundësia për një humbje të pakthyeshme të legjitimitetit të saj do të jetë një nga kërcënimet më të mëdha afatgjatë për “suksesin” në Afganistan.

Megjithëse komuniteti ndërkombëtar ende mund të përmirësojë nivelet e tij të angazhimit në shumë sektorë, më e mira që ai mund të bëjë është të blejë kohë në Afganistan. Sidoqoftë, publiku afgan kërkon siguri që angazhimi i komunitetit ndërkombëtar do të jetë afatgjatë, i qëndrueshëm dhe i besueshëm. Kujtimet e neglizhencës ndërkombëtare pas tërheqjes sovjetike e mandej me rritjen e talebanëve, mbeten të freskëta në mendjet e shumë afganëve.

Pra, sa i angazhuar është komuniteti ndërkombëtar në Afganistan? Megjithëse niveli i mbështetjes varion nga një shtet në tjetrin, në përgjithësi shenjat nuk kanë qenë shumë inkurajuese, veçanërisht për afganët e thjeshtë.

Për dikë, marrja e fondeve dhe furnizimeve shtesë nga shtetet e NATO-s për Afganistanin ka qenë e ngjashme me shkulljen e dhëmbëve. Debate të ashpra janë zhvilluar në parlamentet, mediat dhe në opinionin publik të shumë shteteve të NATO-s. Megjithëse të 40 vendet e angazhuara në

Afganistan kontribuojnë, në tërësi përpjekjet dhe burimet janë ende të pamjaftueshme për misionin. Gjithashtu, kërkohet një ndarje më e madhe e barrës në të gjitha frontet. Për shembull, trupat amerikane, britanike, kanadeze e holandeze vazhdojnë të mbajnë peshën kryesore të luftimeve të ashpra në jug dhe lindje të Afganistanit.

Kërcënimi se parlamentet e vendeve të NATO-s nuk do të mund të rinovojnë mandatin e tyre pas pak viteve, mbetet real, ndërkohë që mbështetja publike në shumë nga këto shtete vazhdon të bjerë. Duhet bërë shumë për sa i përket mosangazhimit të liderëve politikë në një dialog direkt me publikun për të shpjeguar rëndësinë e misionit. Ky mosangazhim, apo ndoshta kjo mungesë vullneti vjen së pari nga frika e politikanëve prej ndëshkimit gjatë zgjedhjeve.

Çështja primare që sfidon vetë ekzistencën e NATO-s është misioni në Afganistan. Fatkeqësisht, kjo nuk po merr ende vëmendjen e duhur apo debatin kritik që meriton mes vendeve të NATO-s. Megjithëse disa vende kanë njoftuar njëfarë rritjeje të kontributeve në muajt e fundit, nevojitet angazhim më i madh për të siguruar mbështetje publike afatgjatë për ta bërë misionin ndërkombëtar në Afganistan të qëndrueshëm dhe të suksesshëm.

Në SHBA, Afganistani tërheq një vëmendje të kufizuar, ndërkohë që çështjet e brendshme vazhdojnë të dominojnë debatin presidencial. Shpenzimi i parave të taksapaguesve amerikanë në Afganistan është relativisht i ulët në krahasim me Irakun. Fakti që afganët janë përgjithësisht në favor të pranisë dhe vullnetit të huaj për të përmbushur përgjegjësitë e tyre në vijat e frontit e bën konfliktin shumë më pak të diskutueshëm se atë të Irakut.

Për ata që nuk kanë interes për çështjet e jashtme, konflikti në Afganistan është bërë “lufta e së djeshmes”. Për ata me interes të kufizuar është bërë “lufta tjetër”, një që gjeneron fjalime të fushatës së rastit për t’u dalluar nga Iraku apo tituj mbi një bombë të tmerrshme vetëvrasëse ose sulm taliban.

Liderët e të dyja anëve të Atlantikut kanë një përgjegjësi për të filluar një debat më të gjerë me publikun e tyre mbi

konfliktin në Afganistan. Kjo kërkon një diskutim të mprehtë e thelbësor përtej fjalimeve mondane e retorikave të shumta.

Thjesht, ajo çka është në pikëpyetje do të ndikojë në sigurinë kombëtare, stabilitetin ndërkombëtar dhe gjeneratat e ardhshme për SHBA-në dhe Aleatët e saj. Shumë veta duhet të kenë parasysh që 9/11 e kishte më së shumti prejardhjen nga Afganistani dhe që rajoni vazhdon të përbëjë një kërcënim rajonal e ndërkombëtar.

Liderët politikë kanë një detyrim të qartësojnë një afat dhe përmasën e operacionit. Duhet theksuar se beteja në Afganistan dhe në pjesët e tjera të botës do të kërkojnë të paktën një gjeneratë angazhimesh e burimesh. Një mungesë mbështetjeje në frontet e brendshme në SHBA e Europë do të dekurajojë seriozisht publikun afgan, i cili ka nevojë të bindet nga fjalët dhe mbi të gjitha nga veprimet që mbështetja afatgjatë ekziston dhe është e qëndrueshme.

Synimi është të blihet kohë në periudhë afatshkurtër me objektivin afatgjatë që afganët të bëhen me rezultativë dhe të sigurojnë kontrollin në të gjitha sferat, veçanërisht në fushën e sigurisë. Pas tri dekadave luftë, detyra duket tepër e vështirë, por suksesi nuk është i pamundur.

### **Informacioni... dhe rezultatet**

Për të ruajtur mbështetjen publike, liderët politikë duhet të bëjnë raporte progresi të rregullta e jo sporadike, veçanërisht në sferën jo-ushtarake. Njerëzit duan të shohin rezultate nga paratë e taksave të tyre.

Në SHBA, kjo bëhet edhe më sfiduese për shkak të vështirësive sistematike, kryesisht nivelit të papërshtatshëm të ekspertizës jo-ushtarake të qeverisë amerikane. Ka, gjithashtu, kohëzgjatje të shkurtra të emërimeve të ekspertëve në vende specifike përtej detit, çka nënkupton që edhe nëse gjendet një ekspert i kualifikuar, pozicioni i tij apo i saj shpesh nuk mund të zgjasë më shumë se 1 vit, duke penguar shpesh programet e mirëfinancuar në sektorë si bujqësia, arsimi, shëndetësia dhe zbatimi i ligjit. Numri i vogël i njerëzve kompetentë dhe mungesa e vazhdimësisë kanë dëmtuar

seriozisht aftësinë për të raportuar mbi progresin apo të metat e programeve.

Në frontin e brendshëm të SHBA-së, një shkëputje ka ndodhur mes publikut amerikan dhe pjesëtarëve të shërbimeve të armatosura, veçanërisht në ushtri dhe marinë. Shumë veta në ushtri i shohin qytetarët e thjeshtë si të shkëputur plotësisht nga realiteti i tyre, përfshirë luftimet e drejtpërdrejta, periudhave të zgjatura të shërbimit dhe sforcimeve në jetën familjare.

Pas pritshmërive të larta të krijuara nga arkitektët e luftës së Irakut, është e kuptueshme që shumë amerikanë të thjeshtë të kenë mendime të ndryshme për angazhimet përtej detit.

Kjo është ajo ku lidershipi i përgjegjshëm politik luan një rol thelbësor.

Së pari, ai mund të shpjegojë pasojat serioze të dështimit në Afganistan, duke ndihmuar në ringritjen e besueshmërisë ndaj misionit.

Së dyti, ai mund të risigurojë mbështetjen e publikut të brendshëm dhe të opinionit të publikut afgan për synimet afatgjata të Amerikës dhe NATO-s.

Për më tepër, liderët politikë duhet të theksojnë që me një Pakistan të paqëndrueshëm në lindje të Afganistanit dhe me një Iran gjithnjë e më të vendosur në perëndim, SHBA-ja dhe NATO-ja nuk mund ta përballojnë humbjen në Afganistan.

Për SHBA-në, dështimi në Afganistan do të dëmtonin më tej besueshmërinë dhe prestigjin e saj si një fuqi botërore dhe do ta ekspozonin ndaj rreziqeve më të mëdha ndërkombëtare.

Për NATO-n, dështimi në Afganistan mund të përbëjë fundin e aleancës më të suksesshme ushtarake në histori pas angazhimit të saj të parë përtej perimetrit të saj. Dhe dështimi do të minonte seriozisht marrëdhënien transatlantike dhe stabilitetin ndërkombëtar, meqë NATO-ja mbetet një pikë kyçe e sigurisë globale.

Për popullin afgan, dështimi do të përbënte një mundësi tjetër tragjike të humbur. Historia do të regjistronte që aftësia e tij përtëritëse dhe angazhimi i tij për të rindërtuar vendin pas 30 vitesh konflikti nuk u ngjiz me komunitetin ndërkombëtar i cili premtoi tepër e ofroi pak.

Së fundi, dështimi në Afganistan do të përbënte një disfatë kolektive për të gjithë me pasoja shqetësuese të paparashikueshme dhe irracionale.

Kjo thekson nevojën fundamentale për një eficensë më të madhe, angazhim të plotë e afatgjatë nga komuniteti ndërkombëtar në Afganistan, kryesisht nga SHBA-ja dhe aleatët e saj të NATO-s.

Ndërsa diskutimet për zgjerimin e NATO-s janë sigurisht të rëndësishme, stabilizimi i Afganistanit është një synim shumë më kritik për Aleancën dhe i tillë që pas secilit anëtarët e saj duhet të bashkohen.

*Marco Vicenzino, i diplomuar në Universitetin e Oxford-it dhe në Qendrën Ligjore të Universitetit të Georgetown-it, është Drejtor i Projektit të Strategjisë Globale në Washington DC dhe këshilltar strategjik për rrezikun global. Ai ofron komente për Shërbimin Botëror të BBC-së, CNN International, FOX News-in dhe Al-Jazeera-n dhe ftohet rregullisht të mbajë fjalime në konferenca në mbarë botën. Ai mund të kontaktohet në [msv@globalsp.org](mailto:msv@globalsp.org)*



Enri Hide (MA)

## TERRORIZMI NDËRKOMBËTAR - KONCEPTUALIZIMI DHE TERMINOLOGJIA

Ky artikull synon të dalë paksa jashtë analizës konvencionale të terrorizmit ndërkombëtar. Përmes tij do të përpiqemi të propozojmë një kuadër konceptual të ri të terrorizmit ndërkombëtar për ambientin akademik shqiptar të sigurisë ndërkombëtare dhe, për aq sa na takon edhe të ambientit akademik rajonal në këtë fushë. Përpyekjet e shumta teorike të analizës së fenomenit të dhunës politike, ideologjike apo fetare, të ushtruar nga një ose më shumë individë, kanë rrokur jo vetëm fushën e sigurisë por edhe më gjerë, atë të vetë disiplinës së marrëdhënieve ndërkombëtare. Ky artikull synon t'u japë përgjigje disa pyetjeve themeltare në lidhje me terminologjinë e terrorizmit, të tilla si: Përse është i vështirë përkufizimi i terrorizmit? Cilat janë rrënjët sociale, politike dhe fetare të radikalizmit islamik? Si dhe përse ngërthehet empirikisht dhe teorikisht terrorizmi ndërkombëtar me ekstremizmin islamik? Qëllimi ynë nuk është të analizojmë politikën e jashtme aktuale amerikane dhe doktrinën Bush (2002 e 2006) - e cila sidoqoftë domosdoshmërisht ka vendin e saj në çfarëdo analize të terrorizmit ndërkombëtar - por të kuptojmë përse endet pambarimisht mjegullnaja analitike rreth terrorizmit ndërkombëtar si fenomenologji dhe cilat janë implikimet akademike që sjell forma aktuale e shprehjes së tij, ekstremizmi islamik.

### **Historia e një termi**

Aktet terroriste ose kërcënimi për akte të tilla ka ekzistuar për mijëvjeçarë të tërë të historisë së njerëzimit. Megjithatë kjo dukuri ka një histori më të gjatë se ajo e shtetit-komb,

përdorimi i terrorit nga qeveritë dhe ata që kontestojnë pushtetin e tyre vazhdon të kuptohet në mënyrë të mjegullt. Ndërsa domethënia e fjalës “terror” është e qartë në vetvete, vërehet një pështjellim i domethënies së termit kur aplikohet në akte dhe aktorë të botës reale. Pjesë e këtij pështjellimi ndodh për shkak të përdorimit të taktikave të terrorit nga aktorë që u përkasin të gjitha niveleve të një ambienti social dhe politik. Për shembull, si mund/duhet ta emërtojmë Unabomber-in, dhe fushatën e tij vetmitare të terrorit: kriminel, terrorist apo revolucionar? Po sulmet e Al-Kaedës?

A mund të krahasohen shembujt e sipërpërmendur me qeveritë revolucionare franceze të cilat sajuan fjalën “terrorizëm” duke institucionalizuar përdorimin sistematik të terrorizmit shtetëror kundër popullsisë së Francës në vitet 1790, duke vrarë me mijëra qytetarë? A janë të njëjta në kuptim, si grupet revolucionare të dikurshmet “Baarder-Meinhof Gang” në Gjermaninë Perëndimore apo “Brigade Rosse” në Italinë e Luftës së Ftohtë, apo “Weather Underground” në Shtetet e Bashkuara?

Pra, shohim se dallimet në përmasa dhe legjitimitet politikë të aktorëve që përdorin terrorin shtrojnë pyetjen: Çfarë është dhe çfarë nuk mund të jetë terrorizëm? Shpeshherë edhe koncepti i ekuivalencës morale përdoret si argument për të zgjeruar dhe pështjelluar përkufizimin e terrorizmit. Ky koncept argumenton se ajo çka ka rëndësi është produkti i një veprimi, dhe jo qëllimi i tij. Dëmet kolaterale, ose të paqëllimta, ndaj civilëve prej një sulmi nga forca të armatosura në uniformë mbi një objektiv legjitim ushtarak është e njëjta gjë me një bombë terroriste të drejtuar në mënyrë të qëllimshme drejt një trageti civil me qëllim shkaktimin e një dëmi.

E thënë ndryshe, një makinë-bombë në rrugën e një qyteti dhe një avion bombardues që lëshon një bombë mbi një tank janë të dyja akte dhune që prodhojnë vdekje dhe terror. Prandaj (në skajin më ekstrem të këtij argumenti) çdo aksion ushtarak është terrorizëm, por me një emërtim tjetër. Kjo është arsyeshmëria pas frazës së famshme: “Terroristi për dikë, është luftëtar i lirisë për dikë tjetër”. Terrorizmi është, gjithashtu, një trashëgimi e legjitimitet të përdorimit të

terrorit nga lëvizje të suksesshme revolucionare faktit të përdorimit të terrorizmit si instrument i arritjes së qëllimshmërisë politike.

Vetë fleksibiliteti dhe aftësia që ka terrori për t'u përshtatur me kalimin e viteve, ka kontribuar për të krijuar këtë konfuzion të madh në nivel konceptual. Ata që synojnë të përçajjnë, rikonfigurojnë rendin ose të shkatërrojnë një statuko specifikë, kanë synuar vazhdimisht të identifikojnë rrugë dhe mënyra të reja dhe krijuese për të arritur qëllimet e tyre. Ndryshimet në taktikat dhe teknikat e terroristëve kanë qenë domethënëse, por edhe më të rëndësishme janë rritja e numrit të shkaqeve dhe kontekstet sociale në të cilat përdoret terrorizmi.

Gjatë njëzet viteve të fundit, vërehet se terroristët janë angazhuar në akte jashtëzakonisht të dhunshme për shkaqe të pretenduara politike ose fetare. Ideologjia politike varion nga ekstremi i majtë deri në atë të djathtë. Për shembull, e majta ekstreme mund të përbëhet nga grupe si marksistët dhe leninistët, të cilët propozojnë revolucionin e punëtorëve të udhëhequr nga një elitë revolucionare. Nga e djathta ekstreme, ne gjejmë diktatorë dhe diktatura që besojnë në mënyrë tipike në shkrirjen e shtetit dhe lidërshipt të biznesit.

Nacionalizmi është devotshmëria ndaj interesave ose kulturës së një grupi njerëzish ose të një kombi. Zakonisht, nacionalistët ndajnë mes tyre një sfond të përbashkët dhe dëshirojnë të themelojnë ose rifitojnë një atdhe. Ekstremistët fetarë e mohojnë shpeshherë autoritetin e qeverive laike dhe i konsiderojnë të jashtëligjshme sistemet ligjore që nuk bazohen në bindjet e tyre fetare. Ata i shohin përpjekjet modernizuese si influenca të kalbura mbi kulturën tradicionale. Grupet speciale të interesit përfshijnë njerëz të kahut radikal të shumë kauzave legjitime: për shembull individë që e përdorin terrorizmin për të ndaluar pikëpamjet anti-abortit, të drejtat e kafshëve apo ambientalizmin radikal. Këto grupe besojnë se dhuna është moralisht e justifikueshme për të arritur qëllimin e tyre.

## **Problematika e konceptualizimit**

### **- Përse është e vështirë të përkufizohet terrorizmi?**

Sikurse u tha më sipër, terrorizmi nuk është një fenomen i ri dhe, ndonëse është përdorur që prej fillimeve të historisë së njerëzimit, ai mund të jetë relativisht i vështirë për t'u përkufizuar. Ai është një koncept tepër i gjerë.<sup>1</sup> Terrorizmi është përshkruar në mënyra të ndryshme: si taktikë dhe si strategji; si krim dhe si detyrë e shenjtë; si një reagim i justifikuar ndaj shtypjes dhe urrejtjes së pafalshme. Normalisht që shumë prej këtyre pikëpamjeve varen nga këndvështrimi i atij që përfaqësohet prej dukurisë. Si një formë asimetrike konflikti, ai i referohet fuqisë imponuese, me shumicën e avantazheve të fuqisë ushtarake në një fraksion kostoje. Për shkak të natyrës së tij sekretive dhe të madhësisë së vogël të organizatave terroriste, këto të fundit nuk u ofrojnë pothuajse asnjëherë kundërshtarëve të tyre një organizim të qartë prej të cilit këta duhet të mbrohen, apo të cilin këta duhet të parandalojnë.

Për këtë arsye parandalimi është bërë tanimë kaq i rëndësishëm. Në disa raste, terrorizmi ka qenë një mjet për të kryer një konflikt ku kundërshtari të mos kuptojë dot natyrën e kërcënimit, duke keqinterpretuar terrorizmin si aktivitet kriminal. Për shkak të këtyre karakteristikave, terrorizmi është bërë përherë e më shumë i zakonshëm midis atyre që përpiqen të arrijnë qëllime ekstreme anëmbanë botës. Por, me gjithë popullaritetin e tij, terrorizmi është një koncept i mjegullt. Madje dhe brenda vetë qeverisë së Shteteve të Bashkuara, agjencitë përgjegjëse për funksione të ndryshme në përballjen me terrorizmin përdorin përkufizime të ndryshme.

Departamenti Amerikan i Mbrojtjes e përkufizon terrorizmin si “përdorimi ose kërcënim i paramenduar dhe i përllogaritur i dhunës së jashtëligjshme në përsiatje të

---

<sup>1</sup> Për një qasje të plotës konceptuale dhe kuptimore të terrorizmit shih: A. Schmid dhe A. Jongman, *“Political Terrorism: A New Guide to Actors, Authors, Concepts, Data Bases, Theories and Literatures”*, Amsterdam, 1988. Gjithashtu, një udhërrëfyes i vlefshëm është edhe libri i Paul Wilkinson, *“Political Terrorism”*, Londër, 1974. Po ashtu shih, Paul Wilkinson, *“Terrorism and the Liberal State”*, 2<sup>nd</sup> Edition, Basingstoke, 1986, Pjesa e Parë.

qëllimeve që janë përgjithësisht politike, fetare ose ideologjike”.<sup>2</sup> Brenda këtij përkufizimi ekzistojnë tri elemente kyçe - dhuna, frika dhe kanosja - dhe secili element prodhon terror mbi viktimat e tij. Ndërkaq, FBI-ja përdor këtë përkufizim: “Terrorizmi është përdorimi i jashtëligjshëm i forcës dhe dhunës kundër individëve ose pasurisë për të frikësuar ose detyruar (imponuar) një qeveri, popullsinë civile, ose çdo segment specifik të tyre, në promovimin e objektivave sociale ose politike”. Nga ana tjetër, Departamenti Amerikan i Shtetit e përkufizon “terrorizmin” si “dhunë të paramenduar, të orientuar politikisht, e ushtruar kundër objektivave joluftarakë nga grupe nënkombëtare ose agjentë klandestinë, zakonisht me qëllim influencimin e një audience të caktuar”.<sup>3</sup>

Jashtë Shteteve të Bashkuara ekzistojnë variacione edhe më të mëdha në tiparet e terrorizmit që vihen në dukje gjatë përkufizimit të tij. Liga e Kombeve ishte e para që u përpoq të arrinte në një përkufizim të sajën për terrorizmin. Ky përkufizim, që i përket viteve '30 (më konkretisht, 1937), u bazua në dhunën e ushtruar nga lëvizjet etnike separatiste dhe konsideronte terroriste: “...të gjitha aktet kriminale të drejtuara kundër një shteti me synim dhe paramendim të krijonin një gjendje terrori në mendjet e individëve të veçantë, të një grupi njerëzish, ose më në përgjithësi të opinionit publik...”.<sup>4</sup> Ndërsa, për herë të parë dhe në formë embrionale, Kombet e Bashkuara u morën me aktet terroriste në kontekstin e Zyrës kundër Drogës dhe Krimin të Organizuar, në vitin 1963. Megjithatë, përcaktimet e Kombeve të Bashkuara nuk u morën me përkufizimin e terrorizmit në vetvete, por me akte të ndryshme, si rrëmbime avionësh, sulme kundër diplomatëve etj.<sup>5</sup> Vetëm në vitin 2005 u arrit të miratohej nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së rezoluta 60/1, e cila “...duke riafirmuar se aktet, metodat dhe praktikat e terrorizmit në të gjitha format dhe mënyrat e shfaqjes së tij janë aktivitete që synojnë shkatërrimin e të drejtave të njeriut, liritë fundamentale dhe

<sup>2</sup> Shih [http://terrorism.about.com/od/whatisterroris1/ss/DefineTerrorism\\_4.htm](http://terrorism.about.com/od/whatisterroris1/ss/DefineTerrorism_4.htm), 14.03.07.

<sup>3</sup> Shih <http://www.state.gov/s/ct/rls/crt/2000/2419.htm>, 14/03/07.

<sup>4</sup> Shih [http://terrorism.about.com/od/whatisterroris1/ss/DefineTerrorism\\_2.htm](http://terrorism.about.com/od/whatisterroris1/ss/DefineTerrorism_2.htm), 13.04.07.

<sup>5</sup> Shih <http://terrorism.about.com/od/whatisterroris1/a/TerrorProtocols.htm>, 12.03.07.

demokracinë, kërcënojnë integritetin territorial të Shteteve, sigurinë e tyre dhe destabilizojnë Qeveritë legjitimisht të konstituara, dhe ndaj të cilave komuniteti ndërkombëtarë duhet të marrë hapat e duhur për të promovuar bashkëpunimin për të parandaluar dhe luftuar terrorizmin”.<sup>6</sup>

Kombet e Bashkuara prodhuan një përkufizim të tillë në vitin 1992, duke emërtuar si terroriste: “Çdo metodë veprimi të përsëritur dhune që shkakton ankth, i kryer nga një individ, grup ose aktorë shtetërorë (gjysmë)klandestinë, për shkaqe ideosinkretike, kriminale ose politike, ku - në të kundërt nga akti i vrasjes - objektivat e drejtpërdrejta të dhunës nuk përbëjnë objektivat e synuar”. Përkufizimi më gjerësisht i pranuar në qarqet akademike fillon me përkufizimin e sipërcituar të Kombeve të Bashkuara, duke i shtuar atij dy fjali, për një total prej 77 fjalësh (në gjuhën angleze). Në të përfshihen koncepte fjalëshuma si “prodhuesit e mesazhit” apo “procese komunikuese të bazuara në dhunë”. Përkufizimi i qeverisë britanike, i vitit 1974, është më konkret dhe më fjalëpakë. Sipas këtij përkufizimi terrorizmi është: “...përdorimi i dhunës për qëllime politike dhe përfshin çdo përdorim dhune me qëllim shkaktimin e frikës në publik, ose në çdo seksion të tij”.

Nëse kalojmë në sferën akademike Paul Wilkinson, duke u përpjekur të japë një përkufizim të terrorizmit, pohon se: “...terrorizmi politik mund të përshkruhet shkurtimisht si “kërcënim imponues”. Një përdorim sistematik i vrasjes dhe shkatërrimit me qëllim terrorizimin e individëve, grupeve të individëve dhe komuniteteve - madje edhe të qeverive - në përsiatje të plotësimin të kërkesave të caktuara “politike”...”.<sup>7</sup> Nga ana tjetër, Robert Jervis e përkufizon terrorizmin si: “...përdorimin e dhunës për arritjen e qëllimeve politike ose

---

<sup>6</sup> Shih përfaqësinë e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Drogës dhe Krimit: [http://terrorism.about.com/gi/dynamic/offsite.htm?zi=1/XJ&sdn=terrorism&cdn=newsissues&tm=236&gps=350\\_411\\_1276\\_674&f=00&tt=2&bt=0&bts=1&zu=http%3A//www.unodc.org/unodc/terrorism\\_convention\\_hostages.html](http://terrorism.about.com/gi/dynamic/offsite.htm?zi=1/XJ&sdn=terrorism&cdn=newsissues&tm=236&gps=350_411_1276_674&f=00&tt=2&bt=0&bts=1&zu=http%3A//www.unodc.org/unodc/terrorism_convention_hostages.html), 12.04.07. Kjo rezolutë u zgjerua me një rezolutë tjetër për një “Strategji antiterror”, të miratuar në 08/09/06 nga Asambleja e Përgjithshme.

<sup>7</sup> Shih P. Wilkinson, “*Terrorism and the Liberal Stat*” Macmillan, London, 1986, f. 51.

sociale; dhunë e cila nuk është autorizuar publikisht nga liderë të entiteteve të pranuara politike; përfshirë aktet që janë financuar dhe mbështetur nga shtetet për të njëjtat qëllime, por që nuk janë njohur e pranuar publikisht...”.<sup>8</sup>

*Terrorizmi është një akt kriminal, i cili influencon një audiencë përtej viktimave të menjëhershme të tij.* Strategjia e terroristëve është të kryejnë akte dhune që tërheqin vëmendjen e popullsisë lokale, të qeverisë dhe të botës për kauzën e tyre. Terroristët i planifikojnë sulmet e tyre për të përfutur publicitetin maksimal të mundshëm, duke përzgjedhur objektiva që simbolizojnë atë të cilës ata i kundërvihen. Efikasiteti i aktit terrorist nuk bazohet në vetë aktin, por në reagimin publik ose atë të qeverisë ndaj tij. Për shembull, në vitin 1972, në Olimpiadën e Mynihut, Organizata e Shtatorit të Zi, vrau 11 izraelitë. Izraelitët ishin viktimat e menjëhershme të sulmit. Por objektivi i vërtetë ishin një miliardë njerëzit që po shihnin në ato momente eventin televiziv.

Organizata e Shtatorit të Zi përdori vizibilitetin e lartë të Lojërave Olimpikë për të bërë publike opinionin e saj ndaj kushteve të vështira në të cilat ndodheshin refugjatët palestinezë. Në mënyrë të ngjashme, në tetor të vitit 1983, terroristë nga vendet e Lindjes së Mesme bombarduan Shtabin e Përgjithshëm të Batalionit Marins Tokësor në Aeroportin Ndërkombëtar të Bejrutit. Viktimat e menjëhershme të sulmit ishin personeli prej 241 ushtarësh amerikanë që u vranë dhe rreth 100 të tjerët që u plagosën. Por objektivi i tyre i vërtetë ishte vetë populli amerikan dhe Kongresi i Shteteve të Bashkuara. Një akt i tyre i vetëm dhune terroriste influenoi vendimin e Shteteve të Bashkuara për të tërhequr trupat Marinse nga Bejruti dhe, për këtë arsye, ai sulm konsiderohet një prej sukseseve më të mëdha të terrorizmit ndërkombëtar.

Ekzistojnë tre këndvështrime ndaj terrorizmit: ai i terroristit; i viktimës; dhe i opinionit publik në përgjithësi. Shprehja “terroristi për dikë është luftëtar lirie” është një pikëpamje e cila do të mund të pranohej dhe nga vetë

---

<sup>8</sup> Robert Jervis, *An Interim Assessment of September 11: What Has Changed and What Has Not?*, në Demetrios James Caraley (ed.) “September 11, Terrorist Attack and US Foreign Policy”, Academy of Political Science, Columbia University, 2002, f. 180.

terroristët. Terroristët nuk e shohin veten e tyre si të këqij. Ata besojnë në mënyrë të palëkundur në legjitimitetin e luftës së tyre, luftojnë për atë çka besojnë, me të gjitha mjetet që kanë në dispozicion. Nga ana tjetër e spektrit analitik ndodhet viktima e një akti terrorist, e cila e sheh terroristin si një kriminel për të cilin jeta njerëzore nuk ka asnjë kuptim. Por më i paqëndrueshmi është pozicioni i opinionit publik. Terroristët dhe grupet e tyre përpiqen me të gjitha mënyrat të krijojnë imazhin e një “Robin Hudi” me shpresën e devijimit të qasjes së opinionit publik drejt kauzës së tyre. Këndvështrimi i tyre zemërdhembshur ndaj terrorizmit është shndërruar në një pjesë integrale të betejës dhe luftës së tyre psikologjike dhe duhet marrë seriozisht në konsideratë gjatë çdo analize të mundshme të terrorizmit.

Ekzistojnë disa probleme themelore gjatë përkufizimit të nocionit të terrorizmit dhe debati shkencor mbi përkufizimin e terrorizmit vështirësohet edhe më shumë kur përpiqemi ta përcaktojmë këtë term në mënyrë që të përshkruajë metodat e përdorimit të dhunës së nivelit të ulët kundrejt luftërave të mirëfillta moderne ndërshtetërore. Kjo ndodh *së pari* sepse përkufizimi i terrorizmit tenton të mbulohet nga propaganda zyrtare (apo “gjysmë-zyrtare”) dhe, *së dyti*, sepse format e dhunës terroriste mbulojnë një gamë të gjerë dhe të çrregullt kushtesh dhe rastesh. Të dyja këto vështirësi e bëjnë shumë të vështirë përkufizimin e fenomenit të terrorizmit.<sup>9</sup>

Fillimisht, komponenti kryesor i konceptualizimit të terrorizmit ishte përdorimi i terrorit për arritjen e qëllimeve të caktuara politike. Megjithatë, sot, ky term përbën për shumë qeveri “pikëmbështetjen” kryesore për pasqyrimin e kundërshtarëve të tyre në çdo konflikt të dhunshëm ose, më gjerësisht, në çdo veprimtari që përmban dhunë me të cilën një qeveri mund të mos bjerë dakord.<sup>10</sup>

<sup>9</sup> Shih Joffé G., “*Low-Level Violence and Terrorism*”, “*Security Challenges in the Mediterranean Region*”, (ed.) Aliboni R., Joffé G., Niblock T., Franc Cass, London, 1996, f. 139. Gjithashtu, Thachuk K., “*Terrorism’s Lifetime: Can it be Severed?*”, Strategic Forum of Institute for National Strategic Studies, National Defense University (USA), No 181, May 2002, ff. 1-3.

<sup>10</sup> Shih B. Ganor, “*Israel’s Counter-Terrorism Policy: Efficacy Versus Liberal-Democratic Values 1983-1999*”, Hebrew University, Jeruzalem, Gusht 2002, ff. 12-13.



Kur ndonjë grup kërkon akses në një ideologji e cila të legjitimojë parimin e shtetit, do ta përdorë atë si bazë për përdorimin e dhunës. Kështu, "...fakti që kjo dhunë në vetvete mund të emërtohet (ose jetë realisht) terrorizëm, merr rëndësi dytësore pasi justifikimi i saj moral tejkalon atë të një sistemi juridik i cili mund të legjitimohet nga monopoli shtetëror mbi përdorimin e dhunës..."<sup>11</sup>. Ç'është e vërteta, monopoli përbën bazën e përdorimit të çdo lloji dhune nga ana e pushtetit shtetëror. Pikërisht ky arsytim (ndoshta, sipas disa studiuesve<sup>12</sup>, përligjije ose justifikimi) rreth terrorizmit, i cili na rikthen në fillosat e anarkizmit të shekullit të 18-të, merr rëndësi vendimtare kur studiohet gjendja aktuale e terrorizmit.

Duke qenë se në shoqëritë moderne njerëzit jetojnë dhe punojnë së bashku në rajone me dendësi tepër të lartë banimi dhe nivel të lartë ndërldhjes dhe ndërveprimesh sociale mes tyre<sup>13</sup>, atëherë dhe probabiliteti i një numri të lartë viktimash nga një sulm terrorist në qendra të këtilla urbane do të rritet dukshëm. Në sulmet e 11 shtatorit, përdorimi i teknologjisë së lartë u mundësoi rrëmbyesve të avionëve të përdorin në mënyrë asimetrike<sup>14</sup> aeroplanët për arritjen e qëllimit të tyre

<sup>11</sup> Water Laqueur, "The New Terrorism, Fanaticism and the Arms of Mass Destruction", Londër, Oxford University Press/ Phoenix Press, 2001, ff. 3-4.

<sup>12</sup> Shih Chomsky Noam, "Neoliberalism and the Global Order", Seven Stories Press, NJ, USA, 2004. Earl Shorris, "Ignoble Liars: Leo Strauss, George Bush and the Philosophy of Mass Deception", Harper's Magazine, Vol. 308, No. 1849, June 2004. f. 65-72. Gregory Gause, "Can Democracy Stop Terrorism?", "Foreign Affairs", Sept.-Oct., 2005.

<sup>13</sup> Këtu mund të përmendim qytete të tilla si Londra, Nju-Jorku, Parisi, Roma, Mexico Siti, Stambolli, Kairo, e sa e sa qytete të tjera, qendra të mëdha urbane, me popullsi disa dhjetëra milionë banorë, dendësia e banimit në të cilat është jashtëzakonisht e lartë dhe ku shkalla e shkatërrimit nga një sulm terrorist asimetrik shumëfishohet.

<sup>14</sup> "Kërcënime Asimetrike" është një term i shumëpërdorur nga Pentagononi (Departamenti Amerikan i Mbrojtjes) kryesisht në periudhën që pasoi fundin e Luftës së Ftohtë. Termi nënkupton përdorimin e teknologjisë dhe të mjeteve të tjera nga grupe të vogla (shtetërore ose jo), duke i aftësuar këto të fundit t'i shkaktojnë një ushtrie ose një shteti dëme të cilat për nga përlllogaritja e pasojave janë të përafërta me ato të shkaktuara nga një ushtri. Për "luftën dhe goditjet asimetrike" shih Doktrinën e Pentagonit, të vitit '92, '96, 2002 dhe 2006, si dhe Kenneth McKenzie Jr., "The Revenge of the Melians: Assymmetric Threats and the Next QDR" (ku QDR=Quadrennial Defense Report; raportet katërvjeçare të Pentagonit për vlerësimin e nivelit të kërcënimit ndaj Shteteve të Bashkuara. Është dokumenti/raporti më i rëndësishëm i prodhuar nga Pentagononi në nivel zyrtar), McNair Paper 62, Institute for National and Strategic Studies, National Defense University, Uashington, 2000.

taktik. Por gjithashtu, shoqëritë tona perëndimore janë, në të njëjtën kohë, tepër të ndjeshme dhe shumë të brishta psikologjikisht.<sup>15</sup> Në këtë kontribuon edhe rrjeti global i informacionit si dhe fuqia e imazhit, shpejtësia e përcimit të të cilave është tepër e madhe, duke e vendosur çdo individ përballë një dileme, deri diku artificiale<sup>16</sup>, të kanozjes së rrezikut nga terrorizmi ndërkombëtar. Impakti i madh psikologjik që ka terrorizmi në shoqëritë perëndimore mund, deri diku, të shpjegohet me faktin e “çmësimit” të tyre me luftën dhe mizoritë e saj.<sup>17</sup>

Ndonëse është shumë e vështirë të përkufizohet terrorizmi si fenomen, për arsytet që u përmendën më lart, gjithsesi është e mundshme që të arrihet në një përkufizim i cili do të lehtësonte analizën e fenomenit. Kështu *terrorizmi mund të përkufizohet si përdorimi (ose kërcënimi) sistematik i dhunës për arritjen e synimeve politike, fetare apo nacionalçlirimtare, drejtuar një shënjestre simbolike apo një grupi viktimash, me qëllim shkaktimin e frikës masive në grupin shoqëror të cilësuar si kundërshtar, i cili nuk lidhet domosdoshmërisht me qëllimin terrorist.*

Sipas Wilkinson: “Forma e veçantë e dhunës që njihet si terrorizëm (së ushtruar kryesisht për arsye politike) ka pesë karakteristika qendrore:

1. Është e paramenduar dhe synon të krijojë një klimë frike ekstreme dhe terrori.
2. I drejtohet një grupi më të gjerë njerëzish nga ata që janë viktimat e menjëhershme të tij.

<sup>15</sup> Mbi impaktin psikologjik të terrorizmit dhe një analizë për pasojat psikosociale të tij, shih Martha Crenshaw, “*The Psychology of Terrorism: An Agenda for the 21st Century*”, *Political Psychology*, Vol. 21, No. 2 (Qershor 2000), ff. 405-420.

<sup>16</sup> Themi artificiale pasi në vendet perëndimore ekziston një probabilitet rreth 100 herë më i lartë të vritesh nga shumë mënyra të tjera (përfshi udhëtimin me makinë, një grabitje të mundshme në bankë etj.) sesa nga ndonjë sulm terrorist. Kjo analizë bëhet bazuar në frekuencat e goditjeve terroriste, viktimat që ato kanë shkaktuar këto 15 vitet e fundit, si dhe pjesa që ato zënë në të gjitha llojet e vdekjeve jo natyrore në shoqëritë perëndimore. Për të dhëna statistikore rreth këtyre që sapo thamë shih Brenda Lutz dhe James Lutz “*Terrorism*”, te “*Contemporary Security Issues*”, Oxford University Press, Londër, 2006, kap. 16.

<sup>17</sup> Imazhet e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore për shumicën e qytetarëve perëndimorë i takojnë historisë dhe një të kaluarë “të largët”. Në këtë pikë është e nevojshme të bëhet dallimi midis lidhshive politike dhe ushtarake nga njëra anë dhe masave të gjera sociale. Në këtë pikë të analizës i referohemi pikërisht këtyre të fundit.

3. Shënjestrat e sulmeve përzgjidhen në mënyrë të rastësishme dhe janë pothuajse gjithnjë simbolike, duke përfshirë këtu dhe shënjestra jo ushtarake.
4. Aktet e dhunës terroriste përballohen nga shoqëria si shkelje e rëndë e vlerave dhe normave shoqërore.
5. Dhuna terroriste është përdorur gjerësisht për të arritur qëllime të caktuara politike si nga grupe njerëzish të cilët nuk janë pjesë e pushtetit, ashtu dhe nga ata që ndodhen në pushtet. Këto qëllime përfshijnë detyrimin e kundërshtarëve politikë për t'u tërhequr, zgjerimin e grupit të përkrahësve të akteve të dhunës etj.”<sup>18</sup>

Nëse do të tentonim të bënim një ndarje tipologjike të fenomenit të terrorizmit, do të konstatojmë diferencimin midis *terrorizmit shtetëror* dhe atij *separatist*, midis *terrorizmit ndërkombëtar* dhe atij *të brendshëm*. Një lloj tjetër ndarjeje, e cila ka fituar vend të veçantë në studimin e fenomenit të terrorizmit është ajo që bëhet sipas *kritereve politike dhe orientimit ideologjik të grupeve të ndryshme ekstremiste*. Duke përdorur këtë tipologji, terrorizmi islamik i përket ndarjes së dytë dhe të tretë tipologjike. Më poshtë do të analizojmë pikërisht lidhjen konceptuale të radikalizmit islamik me terrorizmin që buron prej grupeve të caktuara ekstremiste të botës islamike, duke i ndarë paraprakisht këto dy aspekte nga njëri-tjetri, për të evituar kështu përshtjellimin që ka përmbytur masivisht literaturën e radikalizmit, ekstremizmit dhe terrorizmit fetar.

### **Radikalizmi islamik si pjesë konceptuale e terminologjisë së terrorizmit**

Fundamentalizmi islamik dhe ekstremizmi që buron prej tij identifikohen gjeografikisht në hapësirën gjeografike të Lindjes së Mesme dhe të Afrikës së Veriut. Ky është një *fenomen me një fuqi të papërcaktueshme qartë për vetë dinamikën dhe llojin e veprimit të tij. Kjo pasi përfshin dhe integron në ideologjinë e tij një sërë parametrash sociale, ekonomike dhe kulturorë*. Prandaj ka lindur

---

<sup>18</sup> Paul Wilkinson, “*The Strategic Implications of Terrorism*”, në “*Terrorism & Political Violence. A Source Book*”, M. L. Sondhi (ed.), Indian Council of Social Science Research, Har-Anand Publications, India, 2000.

tashmë nevoja që *gjatë analizës së këtij fenomeni të mënjanojmë thjeshtimin dhe qasjet e njëanshme të tij*. Shpeshherë këto lloj qasjesh tepër të thjeshtuara “për efekt studimi empirik dhe teorik”, dhe të para në mënyrë subjektive, kanë çuar shumë analistë në nxjerrjen e konkluzioneve të gabuara.<sup>19</sup> Një prej tyre është identifikimi që i bëhet shpeshherë islamizmit politik me një fenomen tërësisht fetar.

Feja islame cilësohet si doktrina fetare me përhapjen më të madhe, sidomos gjatë viteve të fundit. Sipas përlllogaritjeve të viteve të fundit afërsisht 1/5 e banorëve të globit i përkasin kësaj feje. Kina, për shembull, ka tre herë më shumë myslimanë se sa Arabia Saudite. Gjithashtu, në SHBA islamizmi si doktrinë cilësohet si feja me ritmin më të lartë të përhapjes. Ndërkohë doktrina islamike fetare përmban pothuajse aq diferencime ideologjike sa dhe protestantizmi, ndërsa në vetë fundamentalizmin islamik gjendet një shumëllojshmëri edhe më e madhe dhe e më larmishme mendimesh.<sup>20</sup> *Por, me gjithë diferencimet (të kuptueshme dhe të natyrshme deri diku) mund të dallohen disa pika të njëjta në të gjitha tendencat e fundamentalistëve, të tilla si: besimi i tyre te ndryshimi ndaj “të pafëve”, besimi i tyre absolut në materializmin dhe korrupsionin e “Djallit të Madh” (shprehje me të cilën identifikohet gjithmonë Perëndimi, sistemi politik i tij dhe vlerat perëndimore). Të njëjtin vlerësim fundamentalizmi islamik mban dhe për të gjithë ato vende islamike qeveritë e të cilave bashkëpunojnë me SHBA-në, Perëndimin dhe Izraelin. Një pikë tjetër e përbashkët e fundamentalistëve islamikë është shprehja e solidaritetit për të gjithë myslimanët e tjerë, kur këta ndodhen në gjendje lufte me “Fuqitë e Djallit” (apo, si quhen ndryshe “të pafetë”). Shembuj që ilustronjë këtë dimension të fundamentalizmit islamik janë pjesëmarrja në zonat e luftimeve dhe konfliktet në Afganistan (1980), Bosnje, Sudan, Çeçeni, Gjeorgji, Algjeri, Filipine, Indonezi, Kashmir, Kosovë, Afganistan (2001-sot), si edhe Irak.*

<sup>19</sup> Shih Francis Fukuyama and Adam Garfinkle, “Promote democracy and prevent terrorism - but don’t conflate the two”, *The Wall Street Journal*, 27 mars 2006.

<sup>20</sup> Shih, Medd R. and Goldstein F. “International Terrorism on the Eve of the New Millenium”, *Studies in Conflict and Terrorism*, Vol. 20, No. 3, July-September 1997, fq. 290.

*Fundamentalizmi islamik (sikundër mbizotëroi fillimisht termi - ose më saktë "ekstremizmi islamik" sikundër u zhvillua), është një fenomen shoqëror me dimensione të paparashikueshme dhe një lloj të veçantë aftësie për t'u përhapur. Aftësia për t'u përhapur që ky fenomen bart në vetvete përmbahet me shumë vështirësi dhe me më shumë vështirësi ndalohet. Në fazën e tij më ekstreme, kjo lloj ideologjie ekstremiste prodhon terrorizëm. Rritja e përmasave të terrorizmit që buron nga arsye fetare ka ndryshuar mënyrën e përcaktimit të strukturës së terrorizmit ndërkombëtar. Por marrëdhëniet midis fesë dhe dhunës ekstremiste terroriste nuk përbëjnë një fenomen të ri për analizën e çështjeve të sigurisë ndërkombëtare. Dhuna ka qenë pjesë e shprehjes ekstremiste të shumicës së feve në një periudhë kohore apo në një tjetër.*

*Me fjalë të tjera, ekstremizmi islamik është produkt i një feje realisht ekspansioniste. Por është njëkohësisht dhe fenomen shoqëror i hasur në popuj të cilët vetëm gjatë kohëve të fundit fituan pavarësinë e tyre dhe krijuan tepër vonë një ndërgjegje kombëtare. Shembujt në këtë rast janë të shumtë, ku mund të përmenden vendet e Lindjes së Mesme, apo vende të tjera si Afganistani, Indonezia, Pakistani etj. Paralelisht ky është një fenomen i cili përfshin kryesisht klasat e varfra, të cilat për një sërë arsyesh mund të ndikohen më lehtë nga kjo lloj ideologjie. Kjo ndodh kryesisht për arsye arsimimi të pamjaftueshëm, niveli të ulët të ardhurash, mosbesimit në klasën politike dhe në elitat e vendeve të tyre, gjë e cila i bën njerëzit lehtësisht pre të propagandës antiperëndimore. Kohët e fundit, sidoqoftë duhet vënë në dukje se ekstremizmi islamik është përhapur dhe në klasat elitare të shoqërive myslimane, duke përfshirë një numër në rritje përkrahësish fanatikë me nivel të lartë ekonomik dhe edukimi. Si ide fetare ekstremizmit islamik i bashkëngjitet ngushtësisht një aktivizëm i theksuar "nacionalist". Ky lloj "nacionalizmi" shprehet kundër një armiku "të pafe" dhe "materialist" ndaj të cilit të gjithë myslimanët duhet të bashkohen dhe të luftojnë.*

*Kështu, terrorizmi islamik si forma më e njohur e shprehjes së ekstremizmit islamik, ka rrënjë të thella në historinë politike të vendeve të Lindjes së Mesme. Këtu bazohet në shumë raste struktura e propagandës ekstremiste islamike, e cila legjitimon veprimtarinë e saj duke përdorur periudhën koloniale dhe*

post-koloniale. Gjatë këtyre periudhave Perëndimi (kryesisht Britania e Madhe, Franca dhe, deri diku, SHBA-ja) ka shfrytëzuar ekonomikisht pothuajse gjithë shtetet e Lindjes së Mesme, si dhe ka ndikuar gjatë fazës post-koloniale nëpërmjet krijimit të elitave politike në këto vende të cilat u shërbejnë interesave të tyre. Kështu, *shfrytëzimi i madh ekonomik dhe gjeostrategjik* i gjithë këtyre vendeve prej vendeve Perëndimore koloniale ka lënë doemos shije të hidhur në historinë e popujve të Lindjes së Mesme. *Një armë shtesë në duart e propagandës ekstremiste ka qenë dhe mbetet politika mbështetëse e Perëndimit (dhe kryesisht e SHBA-së) ndaj Izraelit*, që prej themelimit të shtetit Izraelit dhe deri në ditët tona. Konflikti midis Izraelit dhe palestinezëve për krijimin e një shteti palestinez si dhe ai midis Izraelit dhe arabëve për çështje territoriale (dhe jo vetëm) kanë lënë shenja të thella në memorien kolektive të vendeve arabe në Lindjen e Mesme.

Këto çështje, të cilat në thelb nuk ishin fetare, gjatë rrjedhës së historisë shpeshherë tentuan të përdreshin nga ekstremizmi islamik, duke u dhënë atyre nuanca fetare. Kur në vitin 1928, Hasan al-Bana krijoi Vëllazërinë Myslimane në Egjipt, përpjekja e tij u fokusua në krizën e identitetit si pasojë e rendit kolonial si dhe në kthimin drejt së shkuarës për të rigjetur vetveten. Kjo tendencë e organizatës më të madhe fundamentaliste islamike, e cila i ka fillimet pikërisht në vitin 1928, përmbante një sërë pozicionesh të cilat, në pjesën më të madhe të tyre, vazhdojnë të ekzistojnë ende dhe sot:

- 1) Mohimin e çdo lloj bashkëpunimi me qeveritë Perëndimore dhe bashkëpunëtorët e tyre. Në këtë kontekst nuk pranohet, gjithashtu, dhe mënyra perëndimore e jetesës si edhe qytetërimi perëndimor.
- 2) Kryengritje e armatosur ndaj të gjitha qeverive arabe që bashkëpunojnë me Perëndimin dhe nuk janë të afta të qeverisin.
- 3) Akuza të fuqishme ndaj korrupsionit dhe mekanizmave qeveritare që e lejojnë atë.
- 4) Ndihma ndaj gjithë popujve arabë (dhe myslimanë) që do të luftojnë kundër çdo lloj pushtuesi perëndimor.

Përqaqimi i kësaj ideologjie, e cila bazohej në fenë islame, ishte i menjëhershëm. Shtresat e ulëta dhe ato të mesme

shoqërore, që nuk kishin luksin e diferencimit politik (shpeshherë për shkak të absolutizmit dhe totalitarizmit të sistemeve politike të këtyre vendeve), u integruan shumë shpejt dhe përqafuan trinomin: “Islami është Zgjidhja”. Kjo filozofi disi e thjeshtëzuar krijon iluzionin e një ndarjeje më të mirë të pasurive kombëtare, barazisë dhe prosperitetit ekonomik.

Megjithatë, pavarësisht teorisë imperialiste, të parashtruar më lart, e cila “shpall” fajtor Perëndimin dhe politikën e tij kolonialiste dhe neokolonialiste, *rrënja e fenomenit të radikalizmit gjendet më shumë në doktrinën radikale islamiste, sesa në nivelin e historisë së këtyre vendeve të Lindjes së Mesme (dhe jo vetëm). Ajo identifikohet në tërësinë e problemeve të tyre ekonomike, sociale, kulturore dhe politike. Probleme këto prej të cilave lindin empirikisht kërkesat dhe synimet e ekstremistëve islamikë. Këtu nuk bëhet natyrisht fjalë për të ulur rolin e përballjes së doktrinave fetare midis dy feve kryesore të globit në një sërë fushash të jetës njerëzore, porse për të mënjeluar konfuzionin dhe për të diferencuar fenomene të natyrës së ndryshme.*

Nga ana tjetër, vetë tendenca dhe dinamika e fundamentalizmit islamik u paraqit në vendet perëndimore në mënyrë arbitrare dhe absolutiste, duke e baraspeshuar atë me tërësinë e islamizmit. Kjo lloj qasjeje nga shumica e analistëve perëndimorë pengoi analizën reale të fenomenit dhe ndihmoi në krijimin e paragjykimeve të theksuara përgjithësuese në shoqëritë perëndimore ndaj tërësisë së myslimanëve.

### **Konstatime përmbyllëse**

Terrorizmi vazhdon të jetë një problem i cili krijon “*pasiguri dhe frikë me qëllim sulmin ndaj sistemit aktual sociopolitike*”.<sup>21</sup> Në të gjitha shfaqjet e tij terrorizmi ka prodhuar mohim dhe agresion, duke fragmentarizuar paralelisht procesin e integritetit të shoqërive perëndimore nëpërmjet mësymjes

---

<sup>21</sup> Shih: Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, “Alleged secret detentions and unlawful inter-state transfers involving Council of Europe member states”, Committee on Legal Affairs and Human Rights, Explanatory memorandum by Mr. Dick Marty, Rapporteur, Council of Europe, AS/Jur (2006) 16 Part II, 7 June 2006.

kundër çdo vlere qytetërimi dhe moslejimit të promovimit të vlerave demokratike globale. Nevoja për të kuptuar rrënjët e ekzistencës dhe përjetësisht të terrorizmit vazhdon të jetë e një rëndësie themeltare. Identifikimi i tyre do të ndihmojë në çdo formë parandalimi të tij në të ardhmen. Por, për t'u përballur me kërcënime potenciale terroriste apo kriminale nuk duhet të mohojmë vlerat demokratike të shoqërive në të cilat jetojmë. Vetëm duke mbrojtur demokracinë - kuptimin dhe thelbin e saj - do mund të garantojmë parandalimin e dhunës.

Duhet pranuar gjithësesi se terrorizmi, si terminologji, është mbivlerësuar, thjeshtëzuar dhe keqpërdorur në funksion të promovimit të operacioneve të aktorëve të ndryshëm shtetërorë. Nëpërmjet ligjërimit politik ky fenomen është sigurizuar, duke u zhvendosur në krye të axhendës politike ndërkombëtare, çka e ka bërë relativisht të lehtë legjitimitetin e masave kundër tij, sidomos në Shtetet e Bashkuara (dhe më pak në Bashkimin Europian), ndonëse këto masa nuk janë fokusuar në shkaqet themeltare të lindjes së ekstremizmit. Por një gjë është e sigurtë: kurdoherë një shoqëri demokratike apo sistem politik përdor dhunën si justifikim për të ndëshkuar dhunën, atëherë e ardhmja jonë ndodhet në rrezik.

*Autori është pedagog i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin European të Tiranës. Pasi ka zhvilluar studimet e larta për Marrëdhënie dhe Organizata Ndërkombëtare, ai ka vijuar me një MA në fushën e "Marrëdhënieve të BE-së me Vendet në Zhvillim" dhe një MA në "Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Strategjike" në Athinë. Interesat e tij akademike përfshijnë fushën e sigurisë ndërkombëtare me fokus në çështjet e terrorizmit ndërkombëtar.*



Erjon Alikaj

## KONFLIKTI NË KAUKAZ 2008: ORIGJINA, ZHVILLIMI DHE PASOJAT

Gusht 2008: Atëherë kur mbarë bota e kishte përqendruar vëmendjen te Lojërat Olimpike të Pekinit, “temperaturat” kishin arritur kulmin dhe në rajonet kaukaziane të Osetisë së Jugut dhe Abkhazisë në Gjeorgji. Një konflikt i ashpër shpërtheu mes trupave ushtarake gjeorgjiane dhe atyre oseto-jugore e mandej abkhaziane me mbështetjen dhe ndërhyrjen e forcave ruse. Po cili është historiku i konfliktit, aktorët, shkaqet dhe pasojat e tij? Si ndikoi kriza në marrëdhëniet e NATO-s me Rusinë e me partnerin e saj Gjeorgjinë? Më poshtë po mundohemi të bëjmë një paraqitje të fakteve historike e analizave të disa prej mediave dhe organizatave prestigjioze ndërkombëtare.

### **Kronologji marrëshëniesh Gjeorgji - Oseti e Jugut / Abkhazi**

Marrëdhëniet datojnë që në vitet 1780 kur Perandoria Ruse u shtri në Kaukaz dhe përfshiu dhe rajonet gjeorgjiane. Abkhazia u fut nën mbrojtjen e Carit rus më 1810 dhe më 1864 u aneksua forcërisht nga Rusia. Me rënien e perandorisë ruse, 1917-1918, Abkhazia kaloi nën shtetin e pavarur gjeorgjian. Fillimisht me njëfarë autonomie, minoritetet abkhaze e oseto-jugore filluan të persekutoheshin si pasojë e veprimtarisë bolshevike në rajonet e tyre.

’21-’31 vendoset pushteti sovjetik e krijohen Republikat e ndara Sovjetike të Gjeorgjisë e Abkhazisë. Më ’31 statusi i Abkhazisë reduktohet në Republikë Autonome Sovjetike brenda Republikës së Gjeorgjisë çka sanksionohet dhe nga

Kushtetuta e '36-s e BRSS-së. '33-'53 është periudhë diskriminimi për abkhazët; përfaqësim i kufizuar, shkolla të mbyllura e gjuha amtare e ndaluar etj. u zbatuan nga Beria, kreu i ardhshëm i policisë sekrete sovjetike. Periudha u quajt gjeorgjifikim i Abkhazisë dhe rusifikim i Gjeorgjisë pas lëvizjeve të imponuara demografike. '53-'78 këto politika u zbutën me vdekjen e Stalinit dhe Berias dhe Abkhazia kërkoi ndarjen nga Gjeorgjia, çka u refuzua. '86-'89 Glasnosti dhe Perestrojka forcuan përpjekjet e të dyja republikave për t'u ndarë nga varësia përkatëse madje dhe duke u përshkallëzuar në dhunë e viktima. Sovjeti Suprem i Osetisë së Jugut miraton një akt për kalimin nga rajon në republikë autonome brenda Gjeorgjisë çka u hodh poshtë nga parlamenti gjeorgjian e u shoqërua me përleshje të armatosura.

1990 Gjeorgjia shpall sovranitetin. Osetia e Jugut vetëshpallet Republikë Sovjetike dhe i bën thirrje për njohje si subjekt i pavarur brenda Federatës Sovjetike. Abkhazia shpall sovranitetin dhe gadishmërinë për negociata me Gjeorgjinë për marrëdhënie federative, çka anulohet menjëherë nga qeveria gjeorgjiane. Gjeorgjia anulon autonominë e Osetisë së Jugut dhe vendos një bllokadë 18-mujore; shpallet gjendja e jashtëzakonshme që shoqërohet me përplasje të armatosura e zhvendosje popullsie.

1991 - Gjeorgjia shpall pavarësinë pas fitores së referendumit me 98% të votave pro dhe zgjedh presidentin e saj.

1992 - presidenti largohet pas një grushti shteti dhe Këshilli Ushtarak që vjen në pushtet rikthen në fuqi Kushtetutën e vitit '21 dhe intensifikon veprimin ushtarak në Osetinë e Jugut pas një shumice referendare në këtë rajon për t'iu bashkuar Federatës ruse. Shevardnaze kthehet në Gjeorgji për të kryesuar Këshillin Shtetëror Gjeorgjian e fillon njohja ndërkombëtare e Gjeorgjisë dhe anëtarësimi i saj në FMN, Organizatën e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi, OKB e Bankën Botërore. Arrihet marrëveshja për armëpushim me oseto-jugorët e për vendosjen e paqeruajtësve rusë, gjeorgjianë e oseto-jugorë. Konfliktet mes gjeorgjianëve e abkhazëve pas vendimeve të njëanshme politike reciproke për varësi e pavarësi, kulmojnë me hyrjen e trupave gjeorgjiane në Abkhazi,

me luftime të ashpra e akuza reciproke për genocid dhe mandej me një mision fakt-mbledhës së OKB-së në Abkhazi.

1993 - luftimet vazhdojnë edhe pas ndërhyrjeve të Rosisë e OKB-së. Më në fund gjeorgjianët dalin nga territori i Abkhazisë, vijojnë zhvendosjet masive të popullsisë gjeorgjiane. Në shtator nënshkruhet një Memorandum Mirëkuptimi në Gjenevë mes Gjeorgjisë e Abkhazisë, por statusi i kësaj të fundit mbetet i paqartë.

1994 - raundet e tjera të bisedimeve në Gjenevë nuk japin ndonjë rezultat. Nënshkruhet Traktati Dypalësh i Miqësisë e Bashkëpunimit Gjeorgji-Rusi që sanksionon rivendosjen e mundshme të bazave ushtarake ruse në Gjeorgji; nuk ratifikohet nga parlamenti gjeorgjian. Nënshkruhet një armëpushim dhe një marrëveshje katërpalëshe mes Gjeorgjisë, Abkhazisë, Rosisë e OKB-së për zgjidhjen politike të konfliktit e për vendosjen e paqeruajtësve. Abkhazia miraton një Kushtetutë të re si një shtet sovran demokratik, subjekt i ligjit ndërkombëtar, por mbeti e dykuptimtë nëse kjo përbënte shpallje pavarësie apo jo. Vijojnë përpjekjet e grupeve abkhaze për prishjen e armëpushimit e marrjen e pushtetit me forcë. Gjeorgjia mbështet Rusinë në fushatën e Çeçenisë dhe Rusia nga ana e saj vendos sanksione ndaj Abkhazisë. OSBE-ja inicion negociata mes Gjeorgjisë e Osetisë së Jugut.

1995 - vijojnë incidente të armatosura. Gjeorgjia miraton një Kushtetutë të re por që nuk shprehet për strukturën territoriale e administrative të Abkhazisë dhe Osetisë së jugut. Shevardnaze propozon një zgjidhje federale për konfliktet me to, ndërkohë që Abkhazia vijon të kërkojë sovranitet dhe marrëdhënie të barabarta me Gjeorgjinë.

1996 - përplasjet e armatosura vazhdojnë e rajoni i Galit mbetet problematik. Shfaqen shqetësime për zgjatjen e mandatit të misionit paqeruajtës, Gjeorgjia, Rusia dhe Osetitë e Jugut e të Veriut firmosin një marrëveshje mbi Osetinë e Jugut. Progresi i bërë në bisedimet Gjeorgji-Abkhazi rrënohet nga zgjedhjet parlamentare në Abkhazi që deklarohen të paligjshme nga qeveria gjeorgjiane.

1997 - mandati i paqeruajtësve zgjatet dhe dialogu përparon: krerët gjeorgjanë e abkhazë takohen dhe negociatat

kurorëzohen në Gjenevë me ndërmjetësimin e të Dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së me ngritjen e një Komisioni Koordinimi dhe të grupeve të punës.

1998 - misionet e OKB-së dhe të paqeruajtësve ruse përfshihen në hetimet për shkeljet e marrëveshjes së '94-s, si dhe caktohet një mision i OKB-së për vlerësim të nevojave ekonomike e humanitare në Abkhazi, por rekomandimet nuk merren parasysh. Bisedimet intensifikohen me takimet në Gjeorgji, Athinë etj., por pa rezultate konkrete. OSBE-ja angazhohet të marrë pjesë më aktivisht në zgjidhjen e konfliktit në bashkëpunim me OKB-në, por ndërkohë konfliktet e armatosura në Gali e gjetkë u intensifikuan, aktivizohet “qeveria abkhaze hije” e vendosur në Tbilisi, Gjeorgji.

1999 - konfliktet vazhdojnë e shfaqen të reja kësaj radhe mes Gjeorgjisë e Rosisë për kthimin e pronave gjeorgjiane të përdorura nga ushtria ruse, për heqjen e rojeve kufitare ruse nga territori gjeorgjian, për internacionalizimin e paqeruajtjes në Abkhazi etj. Abkhazia propozon kthimin e gjeorgjianëve të shpërngulur më '92-'93 e '98, por Gjeorgjia kërkon koordinimin e OKB-së në këtë proces. Gjeorgjia pranohet në Këshillin e Europës me kushte, si p.sh., kthimin e turqve meskhetianë të dëbuar nga Stalini. Pavarësisht mbarimit të mandatit, paqeruajtësit rusë vazhdojnë të qëndrojnë. Këshilli i Sigurimit të OKB-së refuzon t'i cilësojë sulmet e abkhazëve mbi gjeorgjianët etnikë si spastrim etnik duke i dhënë fund shpresës gjeorgjiane për sanksione ndaj Abkhazisë. Mandati i misionit të OKB-së zgjatet deri më 31 janar 2000. Ndërmjetësimi i OKB-së e Rosisë vazhdon, megjithatë konfliktet mbeten permanente dhe kthimi i kundërshtarëve të Gjeorgjisë në Abkhazi mbeti problematik.<sup>1</sup>

Ky konflikt etnik mes Gjeorgjisë që ka propozuar autonominë e Abkhazisë, *de facto* e pavarur, që kërkon pavarësi *de juro*, vazhdoi edhe në shekullin XXI. Rusia ndoqi një politikë të mbështetjes ekonomike të Abkhazisë dhe të dhënies së pasaportave të saj dhe pensioneve abkhazëve, çka u dënua ashpër nga Gjeorgjia. Pas ardhjes në pushtet të presidentit të ri gjeorgjian Saakashvili, rinisën bisedimet e ndërprera që në

<sup>1</sup> <http://www.c-r.org/our-work/accord/georgia-abkhazia/chronology.php>

2001-shin. Në 2006-n u njoh *de juro* qeveria e Abkhazisë. Në maj 2008, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një Rezolutë që njeh të drejtat e refugjatëve për t'u kthyer në Abkhazi dhe njeh të drejtën e tyre të pronës, si dhe bën thirrje për një kthim të shpejtë të tyre.

Gjatë luftës, separatistët abkhazë ndërmorën një fushatë pastrimi etnik që shpërnguli rreth 250.000 gjeorgjianë etnikë dhe vrau më shumë se 15.000.<sup>2</sup> Ky spastrim etnik ndaj gjeorgjianëve u njoh zyrtarisht nga konventat e Lisbonës, Budapestit e Stambollit të OSBE-së (e përmendur gjithashtu në Rezolutën GA/10708 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.<sup>3</sup>

Gusht 2008, shpërthen lufta në Osetinë e Jugut, e cila shtrihet dhe në Abkhazi. Seperatistët aseto-jugorë e abkhazë të mbështetur nga trupat ushtarake ruse u përfshinë në një konflikt të armatosur me ushtrinë gjeorgjiane.

## Kronologji konflikti

**7 gusht:** Pas bombardimeve të ndërsjellta të qyteteve në Gjeorgji e Osetinë e Jugut, presidenti gjeorgjian Mikhail Saakashvili urdhëron një armëpushim. Por me një lëvizje të papritur trupat e tij sulmojnë më pas Tskhinvalin, kryeqytetin e Osetisë së Jugut. Sipas gjeorgjianëve kjo nisi pasi trupat ruse kishin filluar të lëviznin nga Osetia e Veriut drejt asaj të Jugut përmes tunelit të Rokit.

**8 gusht:** Saakashvili urdhëron një mobilizim të përgjithshëm ushtarak të trupave të rregullta e atyre rezerviste gjeorgjiane dhe i bën thirrje Ruisë të qëndrojë jashtë konfliktit. Në mbrëmje, konflikti ushtarak kishte marrë përmasat e një lufte me të vrarë e të plagosur të shumtë.

---

<sup>2</sup> [http://en.wikipedia.org/wiki/Georgian%E2%80%93Abkhazian\\_conflict](http://en.wikipedia.org/wiki/Georgian%E2%80%93Abkhazian_conflict) - (09.09.2008 "Georgian-Abkhazian conflict") - US State Department, Country Reports on Human Rights Practices for 1993, Abkhazia case - Chervonnaia, Svetlana Mikhailovna. Conflict in the Caucasus: Georgia, Abkhazia, and the Russian Shadow. Gothic Image Publications, 1994 - US State Department, Country Reports on Human Rights Practices for 1993, February 1994, Chapter 17.

<sup>3</sup> [http://en.wikipedia.org/wiki/Georgian%E2%80%93Abkhazian\\_conflict](http://en.wikipedia.org/wiki/Georgian%E2%80%93Abkhazian_conflict) - (09.09.2008 "Georgian-Abkhazian conflict") - UN GA/10708 - Resolution of the OSCE Budapest Summit, OSCE, 1994-12-06.

**9 gusht:** Aviacioni rus bombardon objektiva brenda territorit gjeorgjian. Po kështu sulmohen dhe pozicionet gjeorgjiane në Abkhazi dhe në Detin e Zi.

**10 gusht:** Abkhazia fut në fuqi ligjin e luftës; drejtuesit pro Moskës urdhërojnë një mobilizim të përgjithshëm të forcave të tyre.

**12 gusht:** Rusia dhe Gjeorgjia bien dakord për një armëpushim të ndërmjetësuar nga presidenti francez Nicolas Sarkozy, kryesuesi aktual i i radhës së presidencës së BE-së.

**14 gusht:** Osetia e Jugut dhe Abkhazia miratojnë marrëveshjen e armëpushimit.

**15 gusht:** Saakashvili nënshkruan planin e paqes prej 6 pikash të ndërmjetësuar nga BE-ja. Plani parashikon një armëpushim dhe tërheqjen e trupave.

**16 gusht:** Presidenti Rus Dmitry Medvedev nënshkruan planin e paqes.

**18 gusht:** Forcat ruse fillojnë tërheqjen nga rajonet e Gjeorgjisë.

**19 gusht:** Me një gjuhë të ashpër, NATO-ja dhe BE-ja kërkojnë tërheqjen e menjëhershme të trupave ruse nga Gjeorgjia. Rusia thotë se planifikon të tërhiqet plotësisht më 22 gusht, por se do të lejë forca mbrojtëse në disa pika kalimi. Kjo lëvizje shkaktoi kritika ndërkombëtare.

**20 gusht:** Rusia njofton një ngrirje të bashkëpunimit me NATO-n. Ajo paraqet në OKB një projekt-rezolutë të vetën.

**22 gusht:** Rusia përfundon tërheqjen, por disa qindra ushtarë mbesin me qëllim kontrollin e disa zonave rreth Abkhazisë dhe Osetisë së Jugut.

**25 gusht:** Ligjvënësit rusë të të dyja dhomave të parlamentit votojnë unanimisht për njohjen e pavarësisë së Abkhazisë dhe Osetisë së Jugut.

**26 gusht:** Presidenti Medvedev shpall njohjen nga Rusia të pavarësisë së dy rajoneve. Politikanët perëndimorë kritikojnë vendimin rus.<sup>4</sup>

**...13 shtator:** Rusia tërhiqet nga qyteti i Potit, Gjeorgji, në bazë të planit francez të armëpushimit.

---

<sup>4</sup> <http://www.dw-world.de/dw/article/0,2144,3595501,00.html> (26.08.2008 Chronology: Events in the South Ossetia, Abkhazia Crisis).

**Fund shtatori 2008:** Rusia deklaroi se duke respektuar ligjin ndërkombëtar, do të dislokojë trupat e saj në Osetinë e Jugut dhe Abkhazi, të njohura prej saj si shtete të pavarura - deklarime që gjithashtu janë kritikuar ashpër në perëndim.

### **Prologu dhe pasojat e konfliktit**

Perspektiva e një lufte dukej e afërt në muajt e fundit. Shkelja e hapësirës ajrore gjeorgjiane mbi Osetinë e Jugut nga avionët rusë e reagimi i ashpër i zyrtarëve gjeorgjiane, deklaratat e majit 2008 të ish-presidentit rus Putin për njohjen e Abkhazisë si një entitet ligjor dhe akuzat e Gjeorgjisë se Rusia po përpiqej të aneksonte territoret e saj problematike në Detin e Zi ishin shenja të qarta se një konflikt po shfaqej në horizont. Në të vërtetë, konflikti mes Rusisë e Gjeorgjisë nuk ishte vetëm rreth Abkhazisë, por rreth zemërimit të Rusisë për atë çka ajo e sheh si rrethimi i Perëndimit.

Pas rënies së Traktatit të Varshavës e fundit të Luftës së Ftohtë, Rusia besonte se kishte një siguri nga NATO-ja dhe Perëndimi se nuk do të kishte shtrirje drejt kufirit rus. Por ndodhi e kundërta. Vendet e ish-Traktatit të Varshavës nxituan t'i bashkoheshin NATO-s. Gjeorgjia dhe Ukraina janë të fundit që kërkojnë anëtarësimin. Nëse Gjeorgjia i bashkohet Planit të Veprimit të Anëtarësisë së NATO-s - me gjasë në 2009 - përgjigjja e Moskës pritet të jetë e ashpër. Presidenti i ri rus Medvedev sulmoi planet e SHBA-së për sistemin antiraketë në Poloni e Republikën Çeke, denoncoi pavarësinë e Kosovës e akuzoi fqinjët balltikë për rishkrarje të Luftës II Botërore.

Por nga një perspektivë perëndimore, Rusia është fajtorë për detyrimin dhe korrupsionin e fqinjëve. Si vende sovraane, Gjeorgjia dhe Ukraina sigurisht që kanë të drejtën të vendosin ç'drejtim do të zgjedhin. Pikëpamjet false të elitës politike ruse nuk morën fund me vdekjen e Bashkimit Sovjetik. Dhe ishte detyra kyçe ideologjike e Putinit të rivendoste madhësinë e humbur të Rusisë. Megjithatë asgjë nuk e ndihmon shumë Gjeorgjinë në betejën e saj ekzistenciale. Përballë një fqinji

shumë më të madh e më të fuqishëm, Saakashvili duhet të eci me kujdes<sup>5</sup>.

Megjithatë konflikti i armatosur nuk u shmang. Cilat ishin disa nga arsytet e tij? Përveç aspiratave të dy rajoneve për pavarësi, edhe pse de fakto ato e kishin atë, mund të përmendet politika e Ruisë, faktori Gjeorgji si shembull i përparimit të NATO-s në thithjen e vendeve të ish-Traktatit të Varshavës, si dhe analogjitë me Kosovën në parlamentin rus.<sup>6</sup>

Reagimet e NATO-s, BE-së, SHBA-së etj., në dukje të ashpra, u komentuan në mënyra të ndryshme.

Në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut në nivel ministrash të Jashtëm, aleatët krahas mbështetjes për zgjidhjen politike të konfliktit, për respektimin e marrëveshjes së nënshkruar nga palët, sovranitetit, pavarësisë dhe integritetit territorial të Gjeorgjisë, vendosën si vijim të vendimeve të Samitit të Bukureshtit ngritjen e një Komisioni NATO-Gjeorgji që do të jetë një mekanizëm konsultimesh i ngjashëm me Komisionin NATO-Ukrainë, dërgimin e ekspertëve për vlerësimin e dëmeve në infrastrukturën civile dhe të gjendjes së Ministrisë së Mbrojtjes dhe ushtrisë gjeorgjiane, mbështetjen e rivendosjes së sistemit të trafikut ajror dhe ndihmën ndaj Gjeorgjisë në fushën e sulmeve informatike.

Sekretari i Përgjithshëm Scheffer njoftoi dërgimin e një të Dërguari Special për Kaukazin dhe Azinë Qendrore. Gjithashtu, ai nënvizoi se takimet e Këshillit NATO-Rusi do të pezulloheshin deri në aderimin e kësaj të fundit në armëpushim. “Ne nuk po mbyllim dyert, por ne nuk mund të vazhdojmë të kemi të njëjtat marrëdhënie si zakonisht... për aq kohë sa Rusia nuk respekton principet mbi të cilat kemi rënë dakord të bazojmë lidhjet tona!” - tha ai<sup>7</sup>.

Sarkazma ruse nuk do të mungonte. “U mbars mali e polli një mi,” - deklaroi Dimitri Rogozin, ambasadori rus në NATO.

---

<sup>5</sup> [www.guardian.co.uk](http://www.guardian.co.uk) (“A furious Kremlin is determined to bar NATO from its backyard but conflict will solve nothing” Sunday July 20 2008).

<sup>6</sup> <http://edition.cnn.com/2008/WORLD/europe/08/26/russia.georgia.oakley.analysis/index.html> - A new Cold War - or more hot air?

<sup>7</sup> [www.nato.int](http://www.nato.int) (19 Aug 2008 “NATO’s foreign ministers reiterate their support for Georgia”).



Po ashtu, ministri i Jashtëm rus Sergey Lavrov akuzoi Aleancën se “po përpiquej të cilësonte agresorin si viktimë”.

Masat e propozuara ishin larg presionit amerikan për penalitete më të ashpra. Megjithatë, Shtëpia e Bardhë i kërkoi Ruisë të tërhiqej nga Gjeorgjia më shpejt. “Nuk u mori realisht 3-4 ditë për të hyrë në Gjeorgji dhe nuk duhet t’u marrë as 3-4 ditë për të dalë prej andej”, - tha Gordon Johndroe, një zëdhënës i Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Megjithëse SHBA-ja kërkonte veprim më të ashpër, u detyrua të tërhiqej pasi kuptoi se disa aleatë europianë - sidomos ata që vareshin energjitikisht nga Rusia - ishin të lëkundur në izolimin e Moskës. Sidoqoftë, sekretarja e shtetit Rice u shpreh më vonë se Aleanca e mbështeti fort Gjeorgjinë dhe se ra dakord për rikonsiderimin e procesit të anëtarësimit të saj në NATO në dhjetor. Ajo shtoi se NATO-ja e bëri “shumë të qartë” se nuk do ta lejojë Ruisë të rikrijë një perde të hekurt për të ndarë Europën lindore e perëndimore.<sup>8</sup>

Mbështetësja e vijës së ashpër ndaj Ruisë për krizën në Gjeorgji, SHBA-ja u angazhua në dërgimin e ndihmës për aleatën e saj. Me radhë presidenti Bush dhe kandidatët John McCain e Barack Obama u shprehën për respektimin e sovranitetit të Gjeorgjisë dhe paralajmëruan Ruisë për pasoja të rënda afatgjata nga konflikti. Sekretarja e shtetit Rice paralajmëroi Ruisë për rrezikun e integritetit të saj në institucionet ndërkombëtare.

Kriza në Gjeorgji theksoi ndarjen në BE për mënyrën e trajtimit të Ruisë. Një politikë e veçantë në këtë drejtim është e vështirë. Një zyrtar i lartë i Komisionit Europian tha se kjo që ndodhi i dha fund muajit të mjalitit mes Perëndimit dhe Medvedevit. “Është e qartë se është Putini dhe jo Medvedevi në fuqi. Ne shpresuam për një fillim të ri. Tani kemi një të tillë, por në një këndvështrim tjetër, veprimi ushtarak rus do të ketë pasojat e veta për marrëdhëniet BE-Rusi,” - shtoi ai. Ndërsa disa vende anëtare të BE-së akuzuan Ruisë për provokim të qëllimshëm të luftës, të tjerë besojnë se Rusia e Gjeorgjia janë bashkëfajtorë e të tjerë mendojnë se Gjeorgjia shkaktoi vetë ndërhyrjen e Ruisë.

<sup>8</sup> <http://www.iht.com/articles/ap/2008/08/19/america/NATO-Georgia.php> - (August 19, 2008 “NATO puts relations with Russia on hold”).

Ndarja u duk dhe në gjirin e NATO-s për urtësinë e anëtarësimit të fqinjëve të Ruisë, Gjeorgjisë dhe Ukrainës. Konflikti forcoi të gjitha palët në bindjet e tyre në Samitin e Bukureshtit në prill 2008 ku NATO-ja nuk miratoi propozimet amerikane për t'i ofruar Gjeorgjisë dhe Ukrainës një plan për anëtarësimin e plotë në Aleancë. Nga njëra anë SHBA-ja dhe shtetet balltike e diçka më pak Polonia e Republika Çeke sulmuan “agresionin” rus. Nga ana tjetër, Franca dhe Gjermania, bllokuese të dhënies së planit të anëtarësimit në Bukuresht, kundërshtuan ndonjë dënim të hapur ndaj Ruisë. Ministri i Jashtëm italian Franco Frattini tha se nuk duhet të ketë “front antirus” e diplomatët thonë se kjo pikëpamje ndahet dhe nga Spanja, Irlanda, Greqia, Belgjika, Austria e Qiproja.<sup>9</sup> Gjithashtu, ministri i Jashtëm gjerman Frank-Walter Steinmeier u shpreh se kanalet e bisedimeve duhet të mbahen të hapura dhe se Perëndimi nuk duhet ta përjashtojë Rusinë nga G8-ta apo OBT-ja. Sidoqoftë, si u vendos nga Aleanca, bashkëpunimi me Gjeorgjinë do të intensifikohet dhe do shkohet drejt anëtarësimit. Kancelarja gjermane Merkel u shpreh: “Gjeorgjia do të bëhet anëtare e NATO-s nëse ajo do dhe e dëshiron këtë. Megjithatë nuk ka një kalendar anëtarësimi dhe Gjeorgjia e Ukraina duhet të përmbushin së pari planet e veprimit të anëtarësimit të cilët vendosin kushte, njëri prej të cilëve është zgjidhja e çdo mosmarrëveshjeje territoriale ndërkombëtare, etnike a e jashtme me mjete paqësore.”<sup>10</sup>

Por cila është saktësisht vlera e anëtarësimit në NATO sot, pas 60 vjetësh që nga krijimi i saj? “Është e njëjta vlerë si në 1949,” - tha Sekretari i Përgjithshëm Scheffer në një konferencë shtypi. Gjithashtu, ai i cilësoi “patetike” kërcënimet e Ruisë për lëshim raketash balistike ndaj një vendi anëtar të NATO-s, Polonisë, në përgjigje të planit amerikan për instalimin e një sistemi antiraketë (plan i cili po vihet në jetë me firmosjen e traktatit përkatës pak ditë më parë mes SHBA-së dhe Polonisë).

<sup>9</sup> <http://www.reuters.com/article/asiaCrisis/idUSLE424255> - (August 14 2008 “Georgia crisis trenches Europe & NATO splits”).

<sup>10</sup> <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/7568209.stm> - 18.08.2008 (“Nato wonders what to do about Russia”).

Shqetësimi është se në 1949, Aleanca u krijua me një parim themelor të mbrojtjes së përbashkët parashikuar në Nenin 5 të Traktatit. Por ky parim është shumë më i ndërlikuar sot me 26 vende anëtare e sipas disa ekspertëve të politikës së jashtme, në rastin e Gjeorgjisë e Ukrainës bie plotësisht edhe nëse ato do të ishin anëtarë të NATO-s. Sidoqoftë, në rastin e krizës së fundit, edhe pse Aleanca nuk i mbylli rrugën marrëdhënieve me Rusinë, në rast të mosmbajtjes së premtimeve nga kjo e fundit, ajo do të duhej të reagoje e të qëndronte fort, si u shpreh ministri i Jashtëm francez Bernard Kouchner.<sup>11</sup>

NATO-ja dhe mbarë Perëndimi reagoi fort për hapat e Ruisë në konfliktin në Kaukaz, për ndërhyrjen e tij ushtarake, për njohjen e pavarësisë së dy rajoneve dhe për deklarimin e ridërgimit të trupave kësaj radhe në të ashtuquajturit dy shtetet e rinj të pavarur për sigurinë e tyre në kundërshtim me marrëveshjen e arritur. Mirëpo sa larg mund të shkonte Perëndimi e NATO-ja në veprimet e tyre? Vështirësimin e rrugës së Ruisë drejt OBT-së, kërcënime për ta përjashtuar nga G8-ta etj. Por ç'do të fitonin, sidomos kur BE-ja varet nga furnizimi me energji nga Rusia? E për më tepër kur prej vitesh ata janë përpjekur ta tërheqin Rusinë e jo ta shtyjnë drejt ftohjes. Atyre u duhet Rusia për të bashkëpunuar për ndryshimin e klimës, luftën ndaj terrorizmit, paqen në Lindjen e Mesme, frenimin e ambicieve nukleare të Iranit, misionin në Afganistan etj. Sidoqoftë, më e keqja do të ishte bërja e kërcënimeve që nuk mund e nuk do të realizohen.<sup>12</sup>

### **Bashkëpunimi aktual Perëndim/NATO-Rusi, pasojat e konfliktit**

NATO-ja bashkëpunon me Rusinë në trajnime dhe ushtrime në mënyrë që trupat e tyre të mund të angazhohen në operacione të përbashkëta; në trajnime antidrogë nga specialistët rusë në Afganistan; në koordinimin me anijet ruse

<sup>11</sup> <http://www.nytimes.com/2008/08/20/world/europe/20diplo.html?hp> - August 19, 2008 (Once Its Rationale, Collective Defense Poses New Challenges to a Larger NATO).

<sup>12</sup> <http://edition.cnn.com/2008/WORLD/europe/08/26/russia.georgia.oakley.analysis/index.html> - A new Cold War - or more hot air?

në operacionin antiterrorist të NATO-s në Mesdhe; në zhvillimin e bashkëpunimit për kërkim-shpëtimin, më 2005-n Rusia mori pjesë në ushtrimin më të madh të NATO-s në këtë fushë; në ushtrimet e menaxhimit të krizave dhe në bashkëpunimin mbi sulmet ajrore terroriste. Nga 1996 deri në 2003 Rusia ishte kontribuesi më i madh me trupa i operacioneve paqeruajtëse të NATO-s mes vendeve jo anëtare. Gjithashtu, Rusia i kishte ofruar NATO-s një rrugë tokësore për kalimin e karvanëve civilë të furnizimeve drejt Afganistanit. Edhe pse ende jo operacionale, ky hap i Ruisë shihej si një shenjë thelbësore e përmirësimit të bashkëpunimit të saj me Aleancën. Tashmë pas konfliktit kur ky bashkëpunim është vënë në rrezik, komandantët e NATO-s presin të shohin nëse Rusia do të tërhiqet nga ky angazhim. Edhe pse Rusia ka deklaruar pezullimin e lidhjeve me Aleancën (ashtu si dhe Aleanca bëri me Këshillin NATO-Rusi), zyrtarët e kësaj të fundit shprehen se Moska nuk ka bërë ndonjë deklaratë zyrtare për tërheqjen e angazhimit.<sup>13</sup>

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe Këshilli i Atlantikut të Veriut dënuan vendimin rus për të njohur rajonet e Osetisë së Jugut dhe Abkhazisë dhe i bënë thirrje Ruisë të tërheqë vendimin e saj. Ato kujtuan se ky vendim dhunon shumë rezoluta të Këshillit të Sigurimit të OKB-së në lidhje me integritetin territorial të Gjeorgjisë dhe është në kundërshtim me parimet themelore të OSBE-së për stabilitet në Europë. Ata i bënë, gjithashtu, thirrje Ruisë ta respektojë këtë integritet dhe të përmbushë angazhimet e marrëveshjes 6 pikëshe të firmosur nga palët.<sup>14</sup>

## **Pasojat ekonomike**

Përveç humbjeve njerëzore e pasojave politike e ushtarake, konflikti në Kaukaz pati e do të ketë pasoja të rënda ekonomike.

<sup>13</sup> <http://www.timesonline.co.uk/tol/news/world/europe/article4615105.ece> - (August 27, 2008 "Nato agreements are at risk").

<sup>14</sup> [www.nato.int](http://www.nato.int) - Statement by the Secretary General of NATO on the Russian recognition of Abkhazia and South Ossetia 26 Aug 2008 / Statement by the North Atlantic Council on the Russian recognition of South Ossetia and Abkhazia regions of Georgia 27 Aug 2008.

Humbjet e përgjithshme ekonomike të Gjeorgjisë duke përfshirë infrastrukturën e dëmtuar, humbjet e produkteve, uljen e eksporteve dhe dërgesave financiare mund të vlerësohen në rreth 2 miliard euro. Shpejtësia e rikuperimit do të varet gjerësisht nga stabiliteti politik i cili nuk ka garanci.

Abkhazia me rreth 340.000 banorë nuk u përfshi direkt nga konflikti i fundit ushtarak. Ajo mund të përfitojë nga investimet ruse, nga zhvillimi i industrisë së ndërtimit, turizmi dhe potenciali bujqësor.

Osetia e Jugut me më pak se 70.000 banorë nuk ka burime që do t'i jepnin shansin e një qëndrueshmërie ekonomike si një shtet i pavarur, pavarësisht ndihmës ruse.<sup>15</sup>

Rusia mund të jetë fare mirë humbësja e madhe afatmesme dhe afatgjatë nga konflikti gjeorgjian, megjithëse kostot direkte të gushtit ishin të vogla. Shanset për një diversifikim ekonomik të suksesshëm dhe për një zhvillim të ri janë ulur përfundimisht. Shqetësimi më i madh është se prishja e keqe e marrëdhënive të Ruisë me Perëndimin do të ketë pasoja serioze për të ardhmen e reformave të saj ekonomike. Pranimi me vonesë në OBT do të përbëjë një pengesë të madhe për të. Gjithashtu, shtyrja e negociatave për një Marrëveshje të re Partneriteti BE-Rusi do të dobësojë më tej pozitën e reformave liberale në këtë vend. Marrëdhënia BE-Rusi dominohet nga energjia: BE-ja varet nga burimet ruse të energjisë dhe Rusia varet nga tregu evropian për eksportet e saj. Për këtë arsye Osetia e jugut dhe Abkhazia janë të parëndësishme për tregun botëror të energjisë, ndërkohë që vete Gjeorgjia është një korridor i rëndësishëm për transitin e energjisë nga baseni i Kaspikut e duke shmangur Rusinë. Konflikti mund të ketë pasoja negative për perspektivën gjeorgjiane për të konsoliduar rolin e saj si një korridor alternativ ndaj Ruisë për transitin e naftës dhe gazit të Kaspikut drejt Europës.

Pra, duket se konflikti pati e do të ketë pasoja për të gjitha palët. E ndërkohë që Aleanca u pozicionua qartë ndaj Ruisë e veprimeve të saj, ajo i ofroi një mbështetje të fortë partneres së saj, Gjeorgjisë.

---

<sup>15</sup> Vienna Institute for International Economic Studies [www.wiiv.ac.at](http://www.wiiv.ac.at) - (2 September 2008 "Economic consequences of the Georgian-Russian conflict").

## **Bashkëpunimi Gjeorgji-NATO dhe perspektiva e marrëdhënieve**

Si ka lindur bashkëpunimi mes NATO-s dhe Gjeorgjisë e si ka evoluar ai deri sot kur kjo e fundit aspiron të anëtarësohet? Më poshtë do të përpiqemi të hedhim një vështrim mbi këtë marrëdhënie, zhvillimet aktuale e perspektivën e tyre.

NATO-ja dhe Gjeorgjia bashkëpunojnë për reformat demokratike, institucionale dhe ato të mbrojtjes dhe kanë zhvilluar një bashkëpunim praktik në shumë fusha të tjera. Ato mbajnë zhvillojnë një Dialog Intensiv mbi aspiratat e vendit për anëtarësim. Plani i Veprimit të Partneritetit detajon programin e bashkëpunimit ndërmjet tyre. Marrëdhëniet datojnë më 1992 pas rënies së Bashkimit Sovjetik e shpalljes së pavarësisë kur Gjeorgjia iu bashkua Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (quajtur më vonë Këshilli i Partneritetit Euroatlantik, më 1997). Bashkëpunimi u thellua pasi ajo iu bashkua programit Partneritet për Paqe, më 1994, dhe Procesit për Rishikimin dhe Planizimin e këtij Partneriteti, më 1999. Më 1999, ajo dërgon trupa në Kosovë në kuadrin e KFOR-it. Pas Revolucionit të Trëndafilte, më 2003, mbështetja për procesin e reformave të brendshme të Gjeorgjisë u intensifikua, veçanërisht përmes zhvillimit të Planit Individual të Veprimit për Partneritet me NATO-n, më 2004. Më 2004, merr pjesë me trupa dhe, më 2005, i mundëson NATO-s e aleatëve të tjerë transitin e trupave dhe furnizimeve përmes territorit të saj për në Afganistan. Asaj iu akordua një Dialog Intensiv për aspiratat e anëtarësimit më 2006. Në Samitin e Bukureshtit, u ra dakord që Gjeorgjia do të bëhej anëtare e Aleancës. Vendimet e mëvonshme do të shkojnë drejt një Plani Veprimi për Anëtarësimin dhe drejt anëtarësimit eventual sipas performancës së Gjeorgjisë në zbatimin e reformave kyç.

Në praktikë NATO-ja ofron këshillim me qëllim reformat në Gjeorgji. Kjo e fundit ka si prioritete transformimin e sektorëve publikë e privatë për të promovuar demokracinë, qeverisjen e mirë, zbatimin e ligjit dhe zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik, si dhe reformimin e sektorit

të sigurisë. Synim tjetër i bashkëpunimit është zhvillimi i aftësisë së vendit për pjesëmarrje të përbashkët me Aleancën në operacione paqeruajtje e menaxhimi krizash.

**Bashkëpunimi në fushën e sigurisë:** Falë pjesëmarrjes në trajnimin dhe ushtrimet e Partneritetit për Paqe, Gjeorgjia ka qenë në gjendje të kontribuojë në sigurinë euroatlanike duke mbështetur NATO-n në operacionet e saj në mbështetje të paqes si në Kosovë, Afganistan, në ofrimin e një mbështetjeje të rëndësishme transiti të furnizimeve të trupave të koalicionit në Afganistan, si dhe kontribuon në luftën kundër terrorizmit përmes pjesëmarrjes së saj në Planin e Veprimit të Partneritetit mbi terrorizmin e ku përfshihen ndarja e informacionit dhe analizave me NATO-n, rritja e kapaciteteve kombëtare kundër terrorizmit dhe e sigurisë së kufijve.

**Reforma e sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë:** NATO-ja është mbështetëse e procesit të gjerë të reformave demokratike e institucionale që po zhvillohen në Gjeorgji që parashikohen në Planin e saj të Partneritetit. Kjo mbështetje shprehet veçanërisht në fushën e reformave të sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë ku NATO-ja dhe aleatë të veçantë kanë një ekspertizë të konsiderueshme të cilën mund ta përfitojë Gjeorgjia. Një prioritet kyç për Gjeorgjinë është sigurimi i kontrollit demokratik të forcave të armatosura. Tashmë është emëruar një ministër mbrojtjeje civil dhe me një staf po ashtu civil. Po kështu edhe Komisioni Parlamentar i Mbrojtjes e Sigurisë luan një rol në monitorimin e aktiviteteve të mbrojtjes. Nënshkrimi i Plan Veprimit të Partneritetit mbi Ngritjen e Institucioneve të Mbrojtjes përforcon këto përpjekje duke promovuar mbikëqyrjen efektive gjyqësore dhe rregullimet e duhura të komandës e kontrollit të mbrojtjes përmes një numri objektivash të matshme brenda Plan Veprimit Individual të Partneritetit. Pjesëmarrja e saj në Procesin e Rishikimit dhe Planizimit të Partneritetit për Paqe që prej '99-s ka ndihmuar në zhvillimin e aftësive të forcave të saj për të punuar bashkë me NATO-n. Kjo e fundit e ka ndihmuar në ngritjen e njërive të gatshme sipas standardeve të Aleancës në ndërveprim me trupat e saj. Objektivat e reformës së mbrojtjes kanë përmirësuar menaxhimin financiar të Ministrisë së Mbrojtjes,

reformimin e strukturave informative të forcave të armatosura etj. Bashkëpunimi zhvillohet edhe në menaxhimin e terreneve ushtarake si dhe në çmontimin e predhave tokë-ajër.

**Planizimi i emergjencave civile:** Gjeorgjia po rrit kapacitetet e saj të menaxhimit të emergjencave civile e fatkeqësive kombëtare në bashkëpunim me NATO-n dhe përmes pjesëmarrjes në aktivitetet e zhvilluara nga Qendra Euroatlantike e Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive.

**Shkenca dhe ambienti:** Në bazë të Programit të Shkencës për Paqen dhe Sigurinë, Gjeorgjia ka marrë financime për më shumë se 40 projekte për bashkëpunimin shkencor dhe mjedisor. Shumë aktivitete synojnë ndihmë në reformat e saj në kërkime e teknologji mbi sistemet e mbrojtjes ajrore dhe standardizimin e të dhënave si dhe në uljen e pasojave mjedisore të aktiviteteve ushtarake. Të tjerë synojnë përmirësimin e cilësisë së ujit, studime për sigurinë, kundër terrorizmit, sigurinë detare e teknologjinë e rrjeteve. Gjeorgjia merr pjesë në projektin “Virtual Silk Highway” i cili synon përmirësimin e aksesit të internetit përmes rrjetit satelitor.

**Informimi publik:** Fushë tjetër bashkëpunimi është rritja e ndërgjegjësimit publik për NATO-n dhe marrëdhëniet e saj me Gjeorgjinë. Që më 2002, në bashkëpunim me OJF lokale dhe autoritete shtetërore, NATO-ja ka organizuar aktivitete të shumta për këtë qëllim. “Javët e NATO-s” dhe shkolla verore organizohen çdo vit për të tërhequr audiencën rinore. Grupe opinionbërësish gjeorgjianë ftohen rregullisht të vizitojnë Selinë e NATO-s dhe Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Europë. Zyrtarë të NATO-s vizitojnë po ashtu Gjeorgjinë për të folur në ngjarje publike. Divizioni i Diplomacisë Publike të NATO-s ka mbështetur krijimin e një Qendre Kombëtare Informimi mbi NATO-n që është bërë kyçe për shpërndarjen e informacionit.

**Dialogu Intensiv:** NATO-ja i ofroi Gjeorgjisë në shtator 2006 një Dialog Intensiv mbi aspiratat e saj për anëtarësim. Dialogu i dha asaj akses në një shkëmbim më intensiv politik me NATO-n mbi standardet e nevojshme për të arritur anëtarësimin dhe për rrugën që duhej të ndiqnin reformat e saj për të arritur këto standarde. Në Samitin e Bukureshtit në



prill 2008, liderët e Aleancës ranë dakord që Gjeorgjia do të bëhej anëtare e saj. Aktualisht vazhdon angazhimi i përbashkët për trajtimin e çështjeve të papërfunduara para se të kalohet në vendimet për stadin e Plan Veprimit të Anëtarësimit dhe për Anëtarësimin e mundshëm. Kjo do të varet nga performanca e Gjeorgjisë në fushën e reformave kyçe. Aplikimi për këtë Plan Veprimi do të rishikohet nga ministrat e Jashtëm aleatë në dhjetor 2008.

Konflikti i armatosur në Kaukaz duket se intensifikoi bashkëpunimin NATO-Gjeorgji. Në ditët e konfliktit, gusht 2008, Aleatët propozuan ngritjen e një Komisioni NATO-Gjeorgji për të mbikëqyrur zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve si dhe për të vijuar në rrugën e vendimeve të marra në Bukuresht në lidhje me aspiratat gjeorgjiane për anëtarësim. Ministrat e Jashtëm aleatë në mbledhjen e Këshillit të Atlantikut të Veriut më 19 gusht, bënë thirrje për një zgjidhje paqësore e të qëndrueshme të konfliktit në respekt të pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Gjeorgjisë. Ata dënuan përdorimin e forcës i cili nuk pajtohet me angazhimet e Gjeorgjisë e Ruisë sipas Partneritetit për Paqe e as me marrëveshje të tjera. Ata u shprehën të shqetësuar për përdorimin e tepruar të forcës ushtarake nga Rusia që nuk përputhet me rolin e saj paqeruajtës në rajonin e konfliktit. I bënë thirrje Ruisë për tërheqje të menjëhershme të trupave sipas planit 6 pikësh të ndërmjetësuar nga BE-ja, OSBE-ja e SHBA-ja. Aleatët ranë dakord të mbështesin Gjeorgjinë sipas kërkesës së saj në një numër fushash si vlerësimi i dëmeve në infrastrukturën civile, mbështetje në ringritjen e sistemit të trafikut ajror etj.

Më 26 gusht, NATO-ja dhe Gjeorgjia finalizuan zbatimin e programit të Shkëmbimit të të Dhënave mbi Situatën Ajrore i cili lehtëson shkëmbimin e informacioneve mes tyre, rrit pamjen e lëvizjeve ajrore në kufirin e përbashkët ajror mes vendit partner e Aleatëve e përmirëson sigurinë ajrore e menaxhimin e këtij trafiku. Pas Austrisë, Gjeorgjia bëhet vendi i dytë partner që ka funksional këtë program në lidhje me NATO-n.

Në vijim të një kërkesë për ndihmë humanitare nga Gjeorgjia, NATO-ja koordinoi mbledhjen nga vendet anëtare

e partnere, si dhe shpërndarjen e tyre në bazë të procedurave të saj të Planizimit të Emergjencave Civile.

Në vijim të një takimi në nivel ambasadorësh NATO-Gjeorgji më 12 gusht në Selinë e NATO-s, më 11 shtator '08 Këshilli i Atlantikut të Veriut mbajti një takim me ambasadorin e Gjeorgjisë. Në takim u shkëmbyen pikëpamje mbi zhvillimet aktuale dhe situatën e sigurisë në Gjeorgji. Aleatët theksuan një vullnet të pandryshueshëm për t'i ofruar Gjeorgjisë ndihmë të gjerë duke përfshirë fushën humanitare. Gjithashtu, u diskutua për vizitën e pritshme të Këshillit në Gjeorgji.

15 shtator 2008, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe Përfaqësuesit e Përhershëm të Këshillit të Atlantikut të Veriut, shkuan për një vizitë 2-ditore në kuadër të Dialogut Intensiv.

Gjatë vizitës u mbajt ceremonia e nënshkrimit të Dokumentit Kuadër për ngritjen e Komisionit NATO-Gjeorgji. Nënshkrimi u konsiderua historik nga Sekretari i Përgjithshëm Scheffer pasi Dokumenti mundëson mjete të reja për thellimin e marrëdhënieve NATO-Gjeorgji dhe të procesit të reformave në këtë vend me qëllim përmbushjen e aspiratave të tij për anëtarësim. Gjithashtu, u mbajt dhe takimi ngurues i Komisionit i cili do të sigurojë një kuadër të rëndësishëm shtesë për bashkëpunimin mes NATO-s e Gjeorgjisë. Synimet kryesore të Komisionit janë thellimi i dialogut politik mes tyre, i bashkëpunimit në rrugën e reformave, mbikëqyrja e procesit të nisur në Bukuresht me qëllim anëtarësimit të Gjeorgjisë dhe koordinimi i asistencës së NATO-s në rimëkëmbjen e këtij vendi pas konfliktit.

Delegacioni i nivelit të lartë të NATO-s vizitoi, gjithashtu, qytetin e Gorit me qëllim marrjen e informacionit në terren rreth pasojave të konfliktit të gushtit dhe konsiderimin e disa prej sfidave që shtrihen para Gjeorgjisë. Ata vizituan repartet ushtarake të dëmtuara gjatë konfliktit dhe takuan disa prej 2.200 personave të shpërngulur që gjendeshin në një kamp të menaxhuar nga UNHCR-ja.

Gjatë vizitës u zhvilluan takime me presidentin gjeorgjian Saakashvili, zyrtarë të tjerë të lartë, parlamentarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Në takime u shkëmbyen pikëpamjet mbi progresin e reformave në kuadër të

partneritetit me NATO-n, mbi situatën në vend pas konfliktit etj. Zyrtarët e Aleancës përsëriten mbështetjen për integritetin territorial të Gjeorgjisë dhe për aspiratat e saj Euroatlantike<sup>16</sup> çka pavarësisht krizave apo kohëzgjatjes, tregon dhe një herë konsistencën e NATO-s për ta pranuar Gjeorgjinë si anëtare të saj.

Gjergji Vurmo\* & Steven Blockmans\*\*

ANËTARËSIMI NË BE - KOHA E DUHUR PËR  
APLIMIKIN E SHQIPËRISË:  
NJË ZGJEDHJE MIDIS PRESIDENCËS  
FRANCEZE, ÇEKE DHE SUEDEZE

**PËRMBLEDHJE**

Thuajse dy vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA) dhe hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Ndërmjetme (dhjetor 2006) aktorët politikë shqiptarë po shqyrtojnë mundësinë e përgatitjes së aplikimit për anëtarësim të vendit në Bashkimin Europian (BE). Kjo çështje në fakt u ngrit më herët këtë vit nëpërmjet deklaratave politike individuale të cilat i kërkonin qeverisë shqiptare të dorëzojë aplikimin brenda vitit 2008.<sup>1</sup> Sidoqoftë, debati publik në lidhje me këtë hap nuk u nxit, kryesisht si pasojë e përfshirjes së dobët të politikës, opinionbërësve dhe ekspertëve. Në fakt, mungesa e debatit nxori në pah mungesën e një qasje të mirëstrukturuar ndaj aplikimit nga ana e aktorëve politikë. Ekspertët dhe opinionbërësit, gjithashtu, u shfaqën të ndarë në opinionet e tyre sa i përket kohës së duhur për aplikim. Tre skenarë janë aktualë. I pari sugjeron që aplikimi për anëtarësim në BE të bëhet gjatë presidencës franceze<sup>2</sup>, i dyti nën

\* *Ky policy brief* është pjesë e serisë së dokumenteve të politikave të hartuar nga IDN nëpërmjet mbështetjes së *Think Tank Fund*, Program i Rrjetit të Fondacioneve për Shoqëri të Hapur (Budapest, Hungari). Opinionet e shprehura në këtë dokument janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të donatorit.

\*\* Opinionet e shprehura në këtë dokument janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të punëdhënësit të tij.

<sup>1</sup> Në mars 2008, lideri i opozitës z. Edi Rama i bëri thirrje qeverisë shqiptare të dorëzojë aplikimin për anëtarësim në BE brenda vitit 2008. Nga ana tjetër, qeveria shqiptare ende nuk ka përcaktuar një datë për aplikimin, por ka ofruar vetëm disa sinjale jo të qartë, të cilët e lidhin datën e aplikimit me përfundimin e ratifikimit të MSA.

<sup>2</sup> Si u kërkuar nga lideri i opozitës në fillim të këtij viti dhe si u mbështet nga *European Stability Initiative* ("The Adriatic push for enlargement", burimi: <http://>

presidencën çeke në gjysmën e parë të 2009-s, dhe i treti, pas zgjedhjeve parlamentare, pra gjatë presidencës suedeze.<sup>3</sup> Rekomandimi ynë sugjeron që Shqipëria duhet të dorëzojë aplikimin për anëtarësim në BE në presidencën çeke, në mënyrë që të sigurohet një aplikim i suksesshëm dhe një procesim i shpejtë i tij. Ky pozicion mbështetet nga argumentet e një analize të gjithanshme dhe qasje të ekuilibruar ndaj dinamikës së proceseve politike dhe integruese në vend, si edhe ndaj dinamikës rajonale dhe asaj të BE-së.

Një qasje realiste dhe analizë e ekuilibruar në lidhje me këto dinamika, të çon në përfundimin se aplikimi i Shqipërisë për anëtarësim në BE duhet bërë nën presidencën çeke në mënyrë që të sigurohet statusi i vendit kandidat brenda mesit të vitit 2011. Si i tillë, qëllimi kryesor i vendit në këtë fazë nuk duhet të kufizohet vetëm tek aplikimi. Përkundrazi, caktimi i afateve të qarta kohore në lidhje me fazën e pasaplikimit dhe angazhimi për të përmbushur kushtet e nevojshme përbën elementin thelbësor i cili duhet të udhëheqë të gjithë procesin e aplikimit. Si rrjedhojë, një **kuadër kohor realist** në lidhje me procesin, për të cilin duhet të angazhohen aktorët politikë do të përfshinte:

Arritja e një konsensusi të gjerë politik në vend (për aplikimin)	Para fundit të 2008-s
Përgatitja dhe dorëzimi i aplikimit për anëtarësim	mars - prill 2009
Këshilli i kërkon Komisionit të përgatisë <i>avis</i>	tetor ose dhjetor 2009
Procesi i përgjigjes ndaj Pyetësorit të Komisionit	2010
Komisioni i dorëzon <i>avis</i> pozitiv Këshillit	Fundi i 2010-s ose fillimi i 2011-s
Vendim i Këshillit që jep statusin e vendit kandidat	Mesi i 2011-s
Hapja e negociatave të anëtarësimit	Fundi i 2011-s ose fillimi i 2012-s

Përmbushja e këtij synimi kërkon vëmendjen e duhur në lidhje me disa masa të rëndësishme, të cilat diskutohen në detaje në pjesën vijuese të këtij *policy brief*.

---

*/www.esiweb.org/index.php?lang=en&id=312* dhe nga një *policy brief* i Institutit Agenda (shih “The Cost of Delay - Why Albania should submit an Application for EU Membership this Year”, burimi: <http://www.agendainstitute.org/index.php?faqe=detail&id=60>).

<sup>3</sup> Si sugjerohet nga skeptikët (në vend dhe në Europë) e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

## I. ANËTARËSIMI NË BE - KOHA E DUHUR PËR APLIKIMIN E SHQIPËRISË

### *I.1. Zhvillimet europiane dhe angazhimet e Shqipërisë*

Dorëzimi i aplikimit për anëtarësim përbën hapin më të rëndësishëm të historisë relativisht të shkurtër të marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Europian. Si i tillë, kërkon përgatitje serioze. Sigurisht që këto përgatitje duhet të udhëhiqen nga një qëllim strategjik i cili nuk kufizohet te procesi i aplikimit, por një qëllim i cili përfshin në vetvete edhe sigurimin e një përgjigjeje pozitive ndaj aplikimit, marrjen e statusit të vendit kandidat dhe zhvillimin e suksesshëm të negociatave për anëtarësim. Në këtë kontekst, nevoja për një debat të mirinformuar shfaqet si mjaft e rëndësishme jo vetëm për aktorët politikë dhe administratën publike të cilët duhet të përgatiten për një proces të gjatë (i cili fillon me aplikimin dhe Pyetësorin e Komisionit Europian), por edhe për publikun e gjerë dhe aktorët e interesuar dhe grupet e interesit. Ky debat deri më tani ka munguar. Megjithatë, përgjigja e pyetjes “Kur duhet të aplikojë Shqipëria për anëtarësim në BE?” ka shënuar edhe një nga të paktat çështje për të cilat politika shqiptare nuk ka arritur ende një pozicion të përbashkët. E njëjta gjë vlen edhe për ekspertët dhe opinionbërësit.

Përmbajtja e “kondicionalitetit” për anëtarësim në BE - instrumenti kryesor i reformës dhe integritit të vendeve kandidatë për anëtarësim në BE - ka ndryshuar në vite paralelisht me zhvillimin e legjislacionit të BE-së (“*acquis*”), nivelin e ulët të përgatitjes nga ana e vendeve candidate dhe oponenta në rritje e vendeve anëtare ndaj zgjerimit të mëtejshëm. Prej vitit 1999, Traktati i BE-së përmban një referencë në Nenin 49 sipas së cilës “*çdo shtet europian*” që aplikon për anëtarësim në BE duhet të respektojë principet themelore të Unionit për lirinë, demokracinë, të drejtat e njeriut, liritë themelore dhe shtetin ligjor. Po atë vit, Komisioni Europian inicioi Procesin e Stabilizim-Asocimit, i cili e shndërroi konceptin e “kondicionalitetit për anëtarësim” në një instrument shumëdimensional që synonte reformat dhe integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në progres-raportet vjetore

*Komisioni monitoron nga afër progresin e arritur nga vendet aspirante për anëtarësim në përmbushjen e kushteve të caktuara. Komisioni identifikon mangësitë kryesore dhe nevojat për përshtatje nga ana e vendeve (potencialisht) kandidatë, cakton prioritetet dhe standardet përkatëse, si dhe kanalizon fondet e BE-së drejt reformave përkatëse.*

*Megjithëse vendimi për dhënien e statusit të vendit kandidat mbetet para së gjithash një vendim politik i cili merret unanimisht nga vendet anëtare të BE-së, aplikanti duhet të demonstrojë rezultate konkrete të arritjeve të tij si edhe të vërtetojë se posedon të gjitha kapacitetet e duhura për të përmbushur kushtet e sipërpërmendura politike për anëtarësim në BE. Sigurimi i mbështetjes së vendeve anëtare dhe identifikimi mes tyre i “mbështetësve” kryesorë që do ta përfshinin aplikimin e Shqipërisë në axhendën politike të BE-së është thelbësore në këtë kontekst, edhe kur kjo mbështetje bazohet në kriteret e sipërpërmendura – kapacitete dhe rezultate konkrete. Më saktë, Shqipëria do të duhet:*

- Të përmirësojë **kapacitetet administrative** dhe të përgatitë **strukturat institucionale** që do të merren me procedurën e aplikimit dhe më pas me “pyetësorin”, procesin e “screening” të legjislacionit dhe atë të negociatave për anëtarësim;
- Të ndërmarrë një **tur diplomatik** (veçanërisht me aktorët kryesorë në Bruksel, Pragë, Stokolm, Berlin, Paris dhe Romë) për të lobuar për statusin e vendit kandidat dhe anëtarësimin në BE.

Ndërsa do të ishte jorealiste çdo spekulim në lidhje me datën e anëtarësimit, identifikimi i një date për marrjen e statusit të vendit kandidat është pa dyshim një element, i cili duhet të udhëheqë përpjekjet e integritetit në BE të vendit, dhe veçanërisht qasjen ndaj aplikimit për anëtarësim. Nga ky këndvështrim, periudha e dytë e Trojkës aktuale të BE-së - presidenca çeke - ofron kohën e duhur për aplikimin e vendit, sepse jo vetëm i lejon administratës shqiptare të përgatitet dhe të zbatojë me sukses fazën e procesit të aplikimit, por edhe sepse u ofron kohën e nevojshme dy presidencave të BE-së në vitin 2009 (suedeze dhe çeke) për të procesuar këtë aplikim. Sigurisht, koha në të cilën bëhet aplikimi përbën vetëm një element, i cili mund të ndikojë në marrjen e statusit kandidat

dhe vendimi i BE-së për statusin do të varet mjaft nga progresi i Shqipërisë. Megjithatë, duke pasur parasysh kompleksitetin e procedurës së aplikimit, dinamikën politike dhe të paraanëtarësimit në Shqipëri dhe zhvillimet në BE, skenari i dytë ofron kohën më të mirë për të garantuar një proces më të lehtë drejt marrjes së statusit të vendit kandidat deri në mesin e vitit 2011.

## ***1.2. Një qasje realiste: dinamika e brendshme vs. e jashtme***

Duket se Shqipëria më në fund i ka lënë pas pasojat e të ashtuquajturit sindrom i “*Sisyphus*” (progres i ndjekur nga hapa pas) dhe po ecën drejt integritit në BE me vendosmëri. Negociatat për MSA u përmbyllën rreth dy vjet më parë dhe, ndërkohë që ratifikimi i saj është drejt përfundimit, Marrëveshja e Ndërmjetme ka aktivizuar dispozitat në lidhje me tregtinë dhe ka intensifikuar gjithashtu edhe procesin e përafrimit të legjislacionit me *acquis*. Pavarësisht progresit, është e rëndësishme të theksohet se raportet e Komisionit në vazhdimësi kanë nënvizuar faktin se kapacitetet zbatuese dhe zbatimi i ligjit mbeten të dobëta në disa fusha. Duke i shtuar kësaj edhe procesin e tejzgjatur të reformës së gjyqësorit, elektorale, pronave dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, do të ishte e lehtë të arrihej në konkluzionin se kjo nuk është koha e duhur për aplikimin për anëtarësim. Nga ana tjetër, ka një numër arsyesh dhe argumentesh të cilat mbështesin të kundërtën. Si rrjedhojë, çdo vendim eventual në lidhje me aplikimin për anëtarësim do të duhet të bazohet thellësisht në një analizë realiste, përtej emocioneve të ditës, të dinamikës së brendshme dhe asaj të jashtme të procesit.

***Faktorët e brendshëm*** të cilët do të ndikonin në rezultatin e aplikimit të Shqipërisë për anëtarësim në BE shfaqen në këtë pikë si veçanërisht të rëndësishëm. Më saktë, vendet anëtare të BE-së do të testojnë “kredencialet” politike të vendit veçanërisht në lidhje me: stabilitetin e institucioneve, respektimin e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe shtetin ligjor. Kjo do të thotë se faktorët kryesorë të cilët do të ndikojnë



ndjeshëm në vendimin eventual të BE-së dhe për të cilët Shqipëria nuk mund t'i lejojë vetes dështimin, përfshijnë:

- Mbajtja e zgjedhjeve parlamentare të lira dhe të ndershme (të cilat me shumë gjasa do të mbahen në qershor 2009). Për këtë, duhet finalizuar reforma e kodit elektoral dhe procesi i regjistrimit elektronik të bazuar në kartat e reja të identitetit;
- Përfundimi i reformës në drejtësi nëpërmjet një konsensusi të gjerë dhe përmirësimi i efikasitetit të institucioneve të gjyqësorit duke respektuar pavarësinë e tyre;
- Përmirësim i performancës në zbatimin e masave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- Arritja e rezultateve konkrete në zbatimin e Marrëveshjes së Ndërmjetme dhe të MSA (pasi të hyjë në fuqi);
- Përafrim i legjislacionit me *acquis* dhe vëmendje e veçantë ndaj kapaciteteve për të zbatuar legjislacionin e përafruar;
- Përmirësim i mëtejshëm i kapaciteteve administrative për të drejtuar dhe zbatuar proceset e sipërpërmendura.

Në mbështetje të këtyre faktorëve, qasja e politikës do të përmirësohet ndjeshëm me ndërmarrjen e një dialogu të mirëstrukturuar - pra jo thjesht fushata informimi, por një marrëdhënie partneriteti - me aktorë të rëndësishëm jopublikë (biznesi, shoqëria civile, grupet e interesit, shoqëria akademike etj.).<sup>4</sup>

Ndërkohë që vlerësimi i duhur i zhvillimeve të brendshme kryesore mbetet thelbësor për një aplikim anëtarësimi të suksesshëm, *dinamika e jashtme* përbën një tjetër element i cili ndikon në shanset për sukses. Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një vendim politik të vendeve anëtare të BE-së në lidhje me aplikimin për anëtarësim, është e rëndësishme të sigurohemi se konteksti në të cilin merret ky vendim të jetë i përshtatshëm për të siguruar një rezultat të favorshëm.

---

<sup>4</sup> Duket se mbështetja e shqiptarëve për anëtarësimin në BE do të vazhdojë të mbetet e lartë edhe në vitet në vijim. Për këtë, përpjekjet e qeverisë, politikës në përgjithësi dhe shoqërisë civile duhet të vazhdojnë të promovojnë një debat të mirinformuar, veçanërisht në lidhje me çështje të stadit aktual dhe sfidave të së ardhmes në procesin e integritit evropian.

Në këtë kuptim, duhet të kemi parasysh se gjashtë valët e zgjerimit kanë ndikuar në funksionimin e BE 27 si edhe në zgjerimin e mëtejshëm të tij. Megjithëse analizat e vlerësimit të hershëm të ndikimit sugjerojnë se vendimmarrja në institucionet kryesore të BE-së nuk është vështirësuar nga zgjerimi i 2004-s dhe 2007-s, vështirësitë e shfaqura gjatë tentativave për të arritur një pozicion të përbashkët në politikat e BE-së, veçanërisht në fushën e marrëdhënieve të jashtme (p.sh. Rusia, Kosova), si edhe në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit europian, mund të shpjegohen kryesisht si rezultat i “vështirësive institucionale”. Për më tepër, me zgjerimin e vitit 2004 dhe me atë që nga shumë prej vendeve anëtare shihet si anëtarësim i parakohshëm i Bullgarisë dhe Rumanisë në 2007, publiku dhe elitat politike në disa vende anëtare duket se vuajnë pasojat e dy proceseve: ndikimi i dy valëve të fundit të zgjerimit; dhe “frika e zgjerimit” - prospektet për zgjerim të mëtejshëm të BE-së, veçanërisht drejt Turqisë. Që prej votës “kundër” në Francë dhe Holandë ndaj ratifikimit të Kushtetutës Europiane, planet e zgjerimit të BE-së hynë në një debat edhe më të ashpër midis grupeve rivale të vendeve anëtare të cilat nuk bien dakord mbi synimet afatgjata të Bashkimit, formën institucionale dhe kufijtë përfundimtarë të tij. Edhe pse Traktati i Lisbonës u dha fund përkohësisht debateve politike mbi reformën institucionale të BE-së, ky dokument nuk arriti të bashkojë në një të vetëm vizionet e ndryshme mbi madhësinë dhe formën e ardhshme të Unionit. Për më tepër, vota kundër e Irlandës ndaj Traktatit të Lisbonës ka vënë në pikëpyetje fatin e tij (ose të datës së hyrjes në fuqi të tij). Duket se institucionet e BE-së do të duhet të “mbijetojnë” me kuadrin e vjetër institucional edhe pas zgjedhjeve për Parlamentin Europian në qershor 2009.

Pavarësisht pasigurive në lidhje me zgjerimin e BE-së, Komisioni vazhdon të theksojë se ky nuk është dhe nuk duhet të jetë fundi i rrugës së zgjerimit. Arsyeja për këtë është e thjeshtë. BE ka filluar tashmë negociatat e anëtarësimit me Turqinë dhe Kroacinë, ndërsa i ka caktuar statusin e vendit kandidat Maqedonisë, Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Malit të Zi, Serbisë (dhe në mënyrë indirekte edhe Kosovës,

megjithëse kjo në kohën kur ende konsiderohej si pjesë e Serbisë) u është premtuar perspektiva e anëtarësimit dhe konsiderohen si vende potencialisht kandidatë (përveç Kosovës). Ndërsa Serbisë i është “premtuar” statusi kandidat në vitin 2009 dhe me Malin e Zi, i cili do të shpallë ofertën e vet për anëtarësim rreth të njëjtës periudhë, duket se BE-ja do të grupojë këto vende së bashku me aplikimin e Shqipërisë gjatë vitit 2009. Në këtë kontekst, një nivel i kënaqshëm koordinimi midis Tiranës, Beogradit dhe Podgoricës do të jepte një mesazh të fuqishëm për Brukselin dhe do të rriste shanset për procesim të shpejtë të aplikimit.

Sa më sipër, është e qartë se përcaktimi i periudhës në të cilën do të dorëzohet aplikimi i Shqipërisë duhet të bazohet në një *analizë të ekuilibruar* të dinamikës së brendshme dhe të jashtme në lidhje me procesin e integritit në BE. Kjo analizë përbën të vetmin instrument realist për të identifikuar një qasje të favorshme për “PRO-të dhe KUNDËR-at”, jo vetëm në vendin aplikant por edhe te vendet anëtare, institucionet e BE-së dhe aktorët e tjerë me ndikim. Kjo, gjithashtu, do të shmangte marrjen e vendimeve të shpejtuara për aplikimin si edhe vonesat e panevojshme në procesimin e tij.

### ***1.3. Aplikim nën presidencat franceze dhe suedeze - “Kurthet” e entuziazmit të tepruar dhe të mungesës së besimit te vetvetja***

Pavarësisht se ky skenar tashmë është pak i mundshëm - me vetëm dy muaj nga përfundimi i presidencës franceze dhe me një mungesë thujse të plotë të debatit mbi aplikimin për anëtarësim - është e rëndësishme të kuptojmë pse ky opsion ishte jorealit edhe në kohën kur u sugjerua në fillim të këtij viti (mars 2008). Si u përmend edhe më sipër, progresi i vendit në reformat kyçe do të jetë vendimtar për çdo lloj ndryshimi (të statusit) në kuadër të integritit në BE. Një listë e shkurtër e këtyre reformave do të përfshinte të *paktën*: përfundimin e reformës elektorale (përfshirë kartat e reja të identitetit); zgjedhje parlamentare në përputhje me standardet

ndërkombëtare; reformë konsensuale e gjyqësorit; dhe rezultate në masat kundër korrupsionit.

Në krahun e BE-së, një aplikim për anëtarësim nën presidencën franceze me shumë gjasa do të ishte kaluar në heshtje deri pas zgjedhjeve parlamentare të qershorit 2009 në vend, për të shmangur çdo lloj keqpërdorimi (për qëllime elektorale) të reagimit eventual të Këshillit në lidhje me aplikimin. Nga ana tjetër, një qasje e tillë “e heshtur” do të ishte po aq e dëmshme në rast se do të shfrytëzohej nga aktorët politikë gjatë fushatës elektorale. Një tjetër argument, i cili do të konfliktonte direkt korrektësinë dhe vetë shanset për një procesim të shpejtë të aplikimit për anëtarësim, është edhe gatishmëria e administratës publike për t’u përballur me procesin e përgjigjes së *pyetësorit* të Komisionit në një vit elektorale. Ndërsa cilësia e përgatitjeve dhe përpjekjeve për këtë proces mbetet jo “e dyshimtë”, ajo që është e sigurtë në këtë pikë është fakti se këto plane do të ndikonin negativisht në perceptimin mbi Shqipërinë si një partner serioz në marrëdhëniet me BE-në. Kjo, nga ana tjetër, do të sillte pengesa edhe për përpjekjet për të siguruar mbështetje te vendet anëtare dhe te Parlamenti European.<sup>5</sup>

Si rrjedhojë, një aplikim gjatë presidencës franceze vetëm do ta kishte dëmtuar procesin dhe sigurisht që nuk do ta kishte përshpejtuar procesimin e aplikimit. Në rastin më të mirë kjo lëvizje do të impononte të njëjtin ritëm si në rastin kur aplikimi do të bëhej nën presidencën çeke. Në rastin më të keq, kjo do të rezultonte në një proces të vonuar të cilit do t’i mungonte perspektiva e qartë e kuadrit kohor të aplikimit - çka përbënte edhe “frikën” kryesore të mbështetësve të skenarit francez.<sup>6</sup>

Nga ana tjetër, as vendimi për të aplikuar gjatë presidencës

<sup>5</sup> Këto janë vetëm një pjesë e arsyeve që kundërshtojnë opsionin e dorëzimit të aplikimit gjatë presidencës franceze.

<sup>6</sup> Në fakt, një nga shqetësimet kryesore të mbështetësve të “skenarit francez” është shmangia e vonesave në procesin e aplikimit dhe veçanërisht, e grupit të Shqipërisë me vendet më pak të avancuara të Ballkanit Perëndimor (Bosnje-Hercegovina dhe Kosova). Ndërkohë që kjo vështirë se mund të justifikohet nën opsionin e dytë (aplikim nën presidencën çeke) duke marrë të mirëqenë progresin e reformave të PSA në vend, ky shqetësim mund të provohet pjesërisht si i vërtetë në realitet në rast se aplikimi bëhet nën presidencën suedeze (dhe në rast se performanca e procesit të integritetit nuk është e kënaqshme).

suedeze nuk duket i bazuar në një analizë të ekuilibruar të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm me ndikim në këtë hap të procesit të integritimit në BE të Shqipërisë. Ndërsa aplikimi nën presidencën franceze i përgjigjet kryesisht nevojave dhe ambicieve të brendshme për një proces të përshpejtuar të anëtarësimit, skenari i aplikimit nën presidencën suedeze duket se kushtëzohet ndjeshëm nga faktorët e jashtëm. Sigurisht që asnjë vend aspirant për anëtarësim në BE nuk mund t'i lejojë vetes një qasje pasive në lidhje me aplikimin për anëtarësim (si edhe gjatë negociatave të anëtarësimit). BE-ja nuk ka ftuar asnjëherë ndonjë vend që të aplikojë për anëtarësim dhe nuk pritet që ta bëjë këtë në të ardhmen. Ndaj i mbetet vendit aplikant që të marrë një qasje aktive për të bindur BE-në nëpërmjet provave konkrete se është i gatshëm të përballojë detyrimet dhe sfidat e fazës vijuese.

Problemi kryesor i planeve për të aplikuar gjatë presidencës suedeze ka të bëjë me faktorin kohë. Më saktë, aplikimi i Shqipërisë do të vonohej jo vetëm për shkak të zgjedhjeve parlamentare, por edhe për shkak të zgjedhjeve të Parlamentit Europian dhe të procedurës së emërimit të Komisionit Europian. Mungesa e aplikimit të Shqipërisë si një çështje e axhendës suedeze të presidencës do t'i kushtonte vendit të paktën edhe një mandat shtesë të presidencës në fazën fillestare (dorëzimi i aplikimit) si edhe një vit më shumë në fazën finale (vendimi për të dhënë statusin e vendit kandidat).

Si rrjedhojë, presidencat franceze dhe suedeze si skenare pozitive për aplikimin e Shqipërisë shfaqin dy probleme kryesore - i pari me mungesën e rezultateve konkrete (në aspektin e brendshëm); dhe i dyti me mungesën e besimit (qasje pasive) çka mund të çojë në ritme të ulëta të integritimit.

### ***1.3. Të bësh zgjedhjen e duhur:***

#### ***Një aplikim për anëtarësim nën presidencën çeke***

Analiza e mësipërme deri tani ofroi argumente të cilat pjesërisht dhe në mënyrë indirekte mbështesin rekomandimin e këtij *policy brief* - gjysma e parë e vitit 2009 është momenti i duhur për të dorëzuar aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim

në BE. Në fund të fundit, dy “të gabuara” nuk sjellin domosdoshmërisht një “të saktë”. Le të shohim tani përsë skenari i fundit është jo vetëm i favorshëm por edhe një opsion realist për të pasur një rezultat pozitiv dhe të shpejtë.

Dorëzimi i aplikimit për anëtarësim nën presidencën çeke do t’u përgjigjej më së miri shqetësimeve në lidhje me gatishmërinë e vendit për këtë stad dhe rezultatet konkrete të arritjeve (analiza e faktorëve të brendshëm), si edhe atyre në lidhje me dinamikën e BE-së dhe qëndrimin ndaj procesit të integritimit të Shqipërisë (analiza e faktorëve të jashtëm). Duhet theksuar, gjithashtu, se Këshilli do të presë përfundimin e zgjedhjeve parlamentare para se të ndërmarë ndonjë veprim në lidhje me aplikimin, pra t’i kërkojë Komisionit të përgatisë *avis*. Deri atëherë, Shqipëria duhet të ofrojë rezultate konkrete në fushat kryesore të reformave, të cilat konsiderohen si thelbësore për procesin e integritimit europian. Për më tepër, kjo rrethanë do t’i lejonte qeverisë shqiptare dhe veçanërisht Ministrisë së Integritimit Europian të zhvillonin strukturat institucionale dhe të finalizonin kuadrin administrativ për *pyetësorin* e Komisionit, dhe më pas, për negociatat e anëtarësimit.

Si u theksua më sipër, progresi në fushat më problematike - si reforma e kodit elektoral, zgjedhje parlamentare në përputhje me standardet ndërkombëtare, reformë konsensuale e gjyqësorit, rezultate në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar - do të përbëjë faktorin kryesor që do të ndikojë qasjen e BE-së dhe vendimin në lidhje me aplikimin për anëtarësim. Në këtë pikë, minimumi i kushteve që duhet të plotësojë Shqipëria për të siguruar procesimin e aplikimit nën presidencën suedeze pa dyshim që do të përfshinte progres në kodin elektoral, zgjedhjet parlamentare, reforma konsensuale e gjyqësorit, masat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ndërkohë që është mjaft e rëndësishme (për vetë aplikimin) të demonstrohen rezultate konkrete në këto fusha brenda vjeshtës së 2009-s, Shqipëria duhet të sigurojë, gjithashtu, edhe një vlerësim pozitiv të progres-raporteve të Komisionit në 2008-n dhe 2009-n.

Në planin e analizës së faktorëve të jashtëm, aplikimi i vendit për anëtarësim në BE duhet, gjithashtu, të marrë në

konsideratë edhe fokusin (axhendën) e presidencës respektive, mundësitë, kapacitetet dhe gatishmërinë e sa për të pronësuar procesin e aplikimit të Shqipërisë. Në këtë kontekst, prioritetet e programit të presidencës çeke<sup>7</sup> shfaqen më mirë të fokusuara te marrëdhëniet e BE-së me Ballkanin perëndimor sesa axhenda franceze<sup>8</sup>, e cila deri tani i është përkushtuar prioritetëve të tjera (ratifikimi i Traktatit të Lisbonës, roli i BE-së në botë, dhe së fundi, kriza financiare globale). Duke pasur parasysh pozitën dhe kapacitetet e presidencës çeke (e cila e merr për herë të parë kryesimin e BE-së) nuk priten zhvillimet të rëndësishme në lidhje me aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim. Megjithatë, dorëzimi i aplikimit nën këtë presidencë në 3-mujorin e parë të 2009-s, jo vetëm që do të mundësojë futjen e çështjes në axhendën e Këshillit, por do të ndihmojë presidencën suedeze të rritet prioritetet e axhendës<sup>9</sup> së vet në lidhje me marrëdhëniet e BE-së me fqinjët juglindorë, çka do të shmangte vonesat në fazën pasuese, të cilat u përmendën më sipër.

Në një situatë kur janë plotësuar të gjitha kushtet (e brendshme dhe të jashtme) për aplikimin nën presidencën çeke, afatet kohore për secilën fazë dhe kuadri kohor i procesit për të cilin vendi duhet të angazhohet, do të përfshinin:

<b>Arritja e një konsensusi të gjerë politik në vend (për aplikimin)</b>	<b>Para fundit të 2008-s</b>
<b>Përgatitja dhe dorëzimi i aplikimit për anëtarësim</b>	<b>mars - prill 2009</b>
<b>Këshilli i kërkon Komisionit të përgatisë <i>avis</i></b>	<b>tetor ose dhjetor 2009</b>
<b>Procesi i përgjigjes ndaj Pyetësorit të Komisionit</b>	<b>2010</b>
<b>Komisioni i dorëzon <i>avis</i> pozitiv Këshillit</b>	<b>Fundi i 2010-s ose fillimi i 2011-s</b>
<b>Vendim i Këshillit që jep statusin e vendit kandidat</b>	<b>Mesi i 2011-s</b>
<b>Hapja e negociatave të anëtarësimit</b>	<b>Fundi i 2011-s ose fillimi i 2012-s</b>

<sup>7</sup> Për më tepër: [http://www.vlada.cz/assets/en/eu/mvez/predsednictvi/cz\\_pres\\_priorities\\_-\\_oct\\_07.pdf](http://www.vlada.cz/assets/en/eu/mvez/predsednictvi/cz_pres_priorities_-_oct_07.pdf).

<sup>8</sup> Për më tepër: [http://www.ue2008.fr/webdav/site/PFUE/shared/ProgrammePFUE/Programme\\_EN.pdf](http://www.ue2008.fr/webdav/site/PFUE/shared/ProgrammePFUE/Programme_EN.pdf).

<sup>9</sup> Për një përshkrim të shkurtër të temave kryesore të Presidencës suedeze shih website-in zyrtar të Qeverisë suedeze: <http://www.regeringen.se/sb/d/10302/a/112407>.

Është e rëndësishme të theksohet se qasja që duhet të aplikojë Shqipëria dhe masat që duhet të ndërmarrë për një proces efikas duhet të udhëhiqen nga një qëllim ambicioz, por gjithashtu realist - hapje e negociatave për anëtarësim brenda vitit 2012. Një pozicion i qartë i aktorëve politikë shqiptarë për datën e hapjes së negociatave do të forconte profilin e vendit si një partner serioz, i cili është i angazhuar thellësisht për të përshpejtuar procesin e integritimit në BE. Për këtë qëllim, dorëzimi i aplikimit nën presidencën çeke vetëm pjesërisht do të ndihmonte në përmbushjen e këtij qëllimi, i cili do të varet kryesisht nga progresi i arritur dhe rezultatet konkrete.

## II. DREJT FAZËS VIJUESE - REKOMANDIME

Në mënyrë që të realizohet skenari i propozuar nga ky dokument politikash, ka një numër masash kyçe, të cilat duhen hartuar dhe zbatuar brenda afateve të qarta kohore. Qëllimi kryesor i vendit në këtë fazë nuk duhet të kufizohet tek aplikimi i tillë. Përkundrazi, caktimi i afateve të qarta kohore për procesin e pasaplikimit dhe angazhimi për të përmbushur detyrimet përkatëse përbëjnë elementin kryesor, i cili duhet të udhëheqë procesin në tërësi.

Pra, për të siguruar hapjen e negociatave të anëtarësimit brenda vitit 2012, vendit i duhet:

### 1. Në fazën e aplikimit për anëtarësim:

- Të sigurojë progres të prekshëm në fushat kryesore të reformës:
  - a. Finalizimi i kodit elektoral;
  - b. Finalizimi i procesit të dokumenteve të identitetit;
  - c. Mbajtja e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme (zgjedhjet parlamentare 2009) në përputhje me standardet ndërkombëtare;
  - d. Finalizimi i reformës konsensuale të gjyqësorit;
  - e. Progres i mëtijshëm në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.



- Të përmirësojë kapacitetet administrative dhe të ngrejë infrastrukturën institucionale për procesimin e Pyetësorit të Komisionit Europian.
- Progres në zbatimin e Marrëveshjes së Ndërmjetme dhe të MSA (pasi të hyjë në fuqi).
- Të zhvillojë një tur diplomatik për të lobuar mbështetësit e aplikimit (si edhe oponentët e tij) midis vendeve anëtare të BE-së dhe për të promovuar Shqipërinë si një shembull pozitiv të Procesit të Stabilizim-Asocimit.

## **2. Në fazën pas aplikimit për anëtarësim:**

- Të sigurojë progres të mëtjshëm në zbatimin e MSA.
- Të tregojë rezultate konkrete në fushat problematike (korrupsioni, krimi i organizuar, menaxhimi i kufijve, emigracioni ilegal, zhvillimi ekonomik etj.).
- Konsolidimi i kapaciteteve administrative si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.
- Të sigurojë ritme pozitive të reformave në fusha të tjera të rëndësishme (pjesë e kriterit politik dhe ekonomik, dhe në standardet europiane).

## **III. ANEKSE**

### ***Aneksi I - Aplikimi për anëtarësim në BE: Procedura dhe praktika***

Nuk ekziston një format standard i veçantë për aplikim. Kërkesa kryesore është një letër zyrtare që deklaron qartë kërkesën e vendit aplikant për t'u anëtarësuar në BE, dëshirën për të përmbushur të gjitha kriteret e anëtarësimit dhe qëllimin e tij për të zbatuar detyrimet përkatëse që rrjedhin nga anëtarësimi në BE. Shembull i një aplikimi të tillë mund të jetë një letër nga kryetari i qeverisë drejtuar kryetarit të Këshillit të Ministrave të BE-së duke shprehur dëshirën e shtetit për t'u bërë Shtet Anëtar i BE-së ose një aplikim që përfshin disa lloje memorandumesh në të. Në këtë rast, letra përshkruan bazat historike, kulturore, politike, ekonomike dhe sfera të

tjera që i përkasin familjes europiane, karakterizon sukseset e vendit në implementimin e reformave gjatë viteve të fundit etj. Zakonisht shtetet më të përgatitura për t'iu bashkuar BE-së dorëzojnë letra të shkurtra ndërkohë që shtetet më pak të përgatitura bashkangjisin memorandume të hollësishëm.

Procedura e aplikimit për anëtarësim në BE është e bazuar mbi legjislacionin dhe ndarjen e kompetencave, si përbrenda shtetit aplikant ashtu edhe BE-së. Përbrenda shtetit aplikant duhet kërkuar miratimi parlamentar për një propozim të bërë nga qeveria për të aplikuar për anëtarësim në Bashkimin European. Aplikimi duhet të dorëzohet nga kryetari i qeverisë së “aplikantit për anëtarësim në BE” (termi “aplikant” duhet të dallohet nga termi “kandidat” derisa të dalë vendimi zyrtar nga Këshilli European) në emër të kryetarit të Këshillit të Ministrave, ministri i Punëve të Jashtme i Vëndit Anëtar, i cili mban Presidencën e BE-së në kohën e aplikimit.

Pasi merret aplikimi, Presidenca e BE-së shtron si çështje në axhendën e Këshillit për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie me Jashtë në një prej takimeve të tij, si dhe në atë të komisionit të lidhur - në rastin e Ballkanit Perëndimor: COWEB. Nuk ka një periudhë kohore të përcaktuar midis dorëzimit të aplikimit dhe konsiderimit të tij nga Këshilli, por për të përjashtuar mundësinë që aplikimi t'i lihet presidencës tjetër, shtetit aplikant i këshillohet që të dorëzojë aplikimin në fillimin e një presidencie të re. Sipas procedurës vendimmarrëse të brendshme, Këshilli pasi konsideron aplikimin duhet t'i kërkojë Komisionit European dhe Parlamentit European të shprehin opinionin e tyre për këtë çështje.

Komisioni European duke pasur një pozicion kyç, përgatit *opinionin* e tij (të njohur me termin francez “avis”) në një periudhë njëvjeçare, duke mbajtur konsultime të ngushta jozyrtare me shtetet e BE-së me influencën më të madhe dhe që tregojnë interes në këtë çështje. Është llogaritur që opinionin e Komisionit, që formalisht është i pavarur nga ai i Vendeve Anëtare, ndjek mbi të gjitha pozicionin franko-gjerman, si dhe atë të Elitave të veçanta politike dhe burokratike të Brukselit.

Parlamenti Europian shpreh aprovimin ose mospranimin e aplikimit në të ashtuquajturën “procedura e miratimit”. Nëse PE nuk aprovon aplikimin, atëherë bllokohet shqyrtimi i tij i mëtejshëm. Duke iu referuar pozicionit zyrtar të të dy institucioneve të BE-së, Këshilli e konsideron përsëri aplikimin dhe miraton vendimin e tij. Zakonisht, një vendim i tillë përpunohet gjatë pragut të një samiti të Këshillit Europian dhe përfshihet në Përfundimet e Presidencës së BE-së të miratuar gjatë samitit.

***Aneksi II - Koha e duhur për aplikim:  
Eksperiencat e dobishme***

Duke paraprirë përgjigjen e mundshme të BE-së për aplikimin e ardhshëm për anëtarësim të Shqipërisë, shembujt më të dobishëm për t’u konsideruar janë si më poshtë:

**Vendet e EQL-së (Europës Qendrore dhe Lindore)** dorëzuan aplikimet e tyre për anëtarësim në BE gjatë periudhës 1994-1996. Kjo ndodhi pasi samiti i Këshillit Europian në Kopenhagen, në 1993, miratoi një vendim themelor që “ato shtete të EQL-së që dëshironin t’i bashkoheshin BE-së mund ta bëjnë” mbi bazat politike, ekonomike dhe kriteret institucionale të përcaktuara gjatë samitit (të ashtuquajturat “kriteret e Kopenhagenit”). Duke dorëzuar aplikimet e tyre, vendet e EQL-së deklaruan zyrtarisht dëshirën e tyre për t’u anëtarësuar në BE dhe i kërkuan BE-së të konsiderojë zyrtarisht kandidaturat e tyre. Polonia, për shembull, nënshkroi Marrëveshjen Europiane në bashkëpunim me BE-në më 16 dhjetor 1991. Marrëveshja Europiane hyri në fuqi më 1 shkurt 1994. Më 5 prill 1994, Republika Polake paraqiti aplikimin e saj për anëtarësim në BE. Këshilli i BE-së i bëri thirrje Komisionit Europian për të shprehur opinionin e tij mbi aplikimin polak më 18 prill 1995. Komisioni Europian shpalli *avis*-in e tij të favorshëm më 15 korrik 1997. Vendimi përfundimtar mbi aplikimet e vendeve të EQL-së u miratua në dhjetor 1997 në Luksemburg, ku Këshilli Europian njohu të 10 vendet e EQL-së, Maltën dhe Qipron si candidate për

anëtarësim dhe rekomandoi të lançonte negociatat e hyrjes me gjashtë prej tyre. Gjashtë të tjerëve iu rekomandua të intensifikonin reformat për të përmbushur kriteret e Kopenhagenit për anëtarësim në BE. Samiti i Këshillit Europian në Helsinki në 1999 miratoi vendimin për të filluar negociatat me vendet e tjera të EQL-së dhe i dha statusin e vendit kandidat Turqisë. Nëse në rastin e Polonisë aplikimi u dorëzua dy muaj pasi hyri në fuqi Marrëveshja Europiane, në rastet e tjera ishte ndryshe. Duhet të theksohet se dorëzimi zyrtar i aplikimit nuk parashikon domosdoshmërisht firmosjen e tij ose hyrjen në fuqi të Marrëveshjeve Europiane ose marrëveshjeve të tjera në bashkëpunim me BE-në. Shembuj të vendeve që kanë marrë anëtarësinë në BE pa ndonjë marrëveshje të tillë (Austria) thjesht konfirmojnë faktin se pranueshmëria e kandidaturave të vendeve është dëshira politike e Shteteve Anëtare të BE-së.

Përvoja e **Kroacisë** është krejtësisht e ndryshme nga grupi i mëparshëm i vendeve, por është mësimdhënëse për Shqipërinë. Si Shqipëria edhe Kroacia ishte e përfshirë në Procesin e Stabilizim-Asocimit (PSA) vetëm si një “kandidat potencial”. Si vendet e tjera të PSA-së, Kroacisë iu ofrua perspektiva e përfundimit të një Marrëveshjeje Stabilizim-Asocimi (MSA), e cila, pasi të ishte ratifikuar plotësisht, do të implementohej - pjesërisht (p.sh. për dispozitat tregtare) - nga një Marrëveshje e Ndërmjetme. Sidoqoftë, autoritetet kroate miratuan një vendim politik për t’u përpjekur për anëtarësim në BE veçmas nga vendet e tjera të PSA-së, në një tentativë për të kapërcyer radhën dhe për të hyrë në valën e zgjerimit bashkë me Bullgarinë dhe Rumaninë. Kroacia shpalli madje dhe vendimin e saj për të dorëzuar aplikimin për anëtarësim dhe për të mos firmosur MSA-në, sepse i duhej dhënë një Marrëveshje Europiane. Reagimi i Komisionit për këtë sugjerim ishte negativ dhe Kroacia u nxit të evitonte veprime të tilla. Edhe zyrtarisht, përfaqësuesit e BE-së paralajmëruan autoritetet kroate se “aplikimi dorëzohet vetëm një herë dhe nëse ju insistoni për ta dorëzuar më herët sesa momenti kur të jeni gati për të, aplikimi mund të refuzohet, duke sjellë pasoja negative për integrimin Europian të Kroacisë”. Përfundimisht,

Kroacia e nënshkroi MSA-në e saj më 29 tetor 2001. MSA-ja hyri në fuqi më 1 shkurt 2005. Pavarësisht qëndrimit negativ të Komisionit Europian dhe të disa prej Shteteve Anëtare, Kroacia e dorëzoi aplikimin e saj për anëtarësim më 21 shkurt 2003, duke lobuar njëkohësisht si në Bruksel, edhe në kryeqytetet e Shteteve Anëtare, në një përpjekje për të marrë një përgjigje pozitive nga Këshilli i Ministrave.

### ***Aneksi III - Procesi i negociatave të anëtarësimit:***

#### ***Rasti i Kroacisë***

Më 14 prill 2003, Këshilli i BE-së mori në konsideratë aplikimin dhe i kërkoi Komisionit Europian të përgatiste *avis-in* e tij. Më 10 korrik 2003, Komisioni dërgoi një **pyetësor** me 4.560 pyetje në Zagreb. Kroacia dorëzoi përgjigjet e saj me mundim pas tre muajsh, më 9 tetor 2003. Komisionit Europian iu deshën gjashtë muaj të tjerë para se të shpallte *avis-in* e tij pozitiv më 20 prill 2004. Gjatë atyre gjashtë muajve, Komisioni kërkoi sqarime mbi shumë pyetje të cilave administrata kroate u kishte dhënë përgjigje të turbullta ose në mënyrë evazive.

Ja vlen për t'u përmendur se në kohën e **opinionit** pozitiv të tij, Komisioni Europian e konsideroi Kroacinë si një vend që nuk përmbushte kriteret politike në përgjithësi. Kroacia u njoh si një demokraci aktive me institucione të qëndrueshme që garantojnë demokracinë dhe pa probleme të rëndësishme në fushën e të drejtave themelore të njeriut. Megjithatë, disa përmirësime të veçanta kërkoheshin ende: kthimi i refugjatëve, reforma gjyqësore konsensuale, lufta kundër korrupsionit, mbrojtja e minoriteteve etnike etj. Ekonomikisht, Kroacia konsiderohej si një ekonomi tregu aktive në gjendje për të funksionuar përbrenda sferës së konkurrencës së BE-së. Përfundimisht, Komisioni Europian ishte i kënaqur që Kroacia kishte kapacitetet për të punuar drejt përmbushjes së obligimeve të kërkuara për anëtarësim në BE.

Në *avis-in* e tij, Komisioni Europian i propozoi Këshillit të Ministrave t'i ofronin **statusin e vendit kandidat** Kroacisë dhe të fillonin negociatat për hyrjen në BE. Njëkohësisht, Komisioni propozoi që Kroacisë t'i ofrohej asistencë e plotë

para aderimit, si financiare dhe teknike (e fundit për **screening** (egzaminimin) e legjislacionit të saj). Më 18 qershor 2004, Këshilli European vendosi të ndiqte *avis*-in pozitiv të Komisionit mbi aplikimin për anëtarësim të Kroacisë dhe dhënien e statusit të vendit kandidat, në këtë mënyrë duke i ofruar asistencë financiare dhe teknike më të madhe.

Në samitin e Brukselit në dhjetor 2004, Këshilli European i kërkoi Këshillit të Ministrave të bjerë dakord për një **kuadër negociatash për aderim** me një pikësynim për të hapur negociatat e aderimit me Kroacinë më 17 mars 2005, në mënyrë të tillë që të shpërbleheshin përgatitjet e vazhdueshme të Kroacisë për anëtarësim në një datë të përcaktuar për të filluar bisedimet e aderimit. Sidoqoftë, kjo mundësi ishte subjekt i një kushti të prerë: bashkëpunim i plotë dhe i qartë me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve në ish-Jugosllavi (ICTY). Kroacisë iu dhanë ekzaktësisht tre muaj kohë për të arrestuar dhe ekstraduar të akuzuarin e kohërave të luftës Gjeneral Ante Gotovina.

Pavarësisht nga lobimi i fortë njëmbëdhjetorësh i bërë nga Kroacia për të parandaluar pasojat e dështimit të saj për të arrestuar dhe ekstraduar Gotovinën, “mungesa e një marrëveshjeje të përbashkët” midis 25 Shteteve Anëtare të BE-së mbi çështjen e bashkëpunimit të plotë me ICTY e detyroi Këshillin në marrjen e një vendimi të paprecedent për të shtyrë fillimin e bisedimeve për anëtarësim. Sidoqoftë, Këshilli u tregua i kujdesshëm për të nënvizuar se hyrja në negociata me Kroacinë mund të hapej sa më shpejt që të kishte prova se Kroacia po bashkëpunonte plotësisht me Gjykatën. Për të provuar pikëpamjen e tij, por pa ofruar një zgjidhje të parakohshme të këtij ngërçi, Këshilli miratoi një mandat negocues për Komisionin dhe krijoi një ekip pune të veçantë për të monitoruar bashkëpunimin e Zagrebit me ICTY.

Disa orë para takimit vendimtar “të zgjerimit” të Këshillit të Ministrave, më 3 tetor 2005, në Luksemburg, ekipi i punës dha opinionin e tij pozitiv pasi ishte informuar nga shefi i Prokurorisë së ICTY-së, pavarësisht nga fakti se Gotovina ishte i lirë, Kroacia po “bashkëpunonte plotësisht” me Gjykatën. Duke i kushtuar vëmendje përkushtimit të kryeministrit kroat

se bashkëpunimi i plotë do të vazhdojë derisa të shkonte në Hagë dhe i akuzuari i fundit, për aq kohë sa nevojitej nga ICTY, Këshilli i Ministrave përfundoi se Kroacia kishte përmbushur kushtin e vonuar për të filluar negociatat e aderimit. Menjëherë pas vendimit politik nga Këshilli i BE-së, u mblodh **Konferenca Ndërqeveritare bilaterale mbi aderimin**. Në këtë mënyrë, negociatat e aderimit u hapën formalisht më 3 tetor 2005, në sesionin e parë të ICG-së midis Shteteve Anëtare të BE-së dhe Republikës Kroate. Në këtë takim të parë, u shkëmbyen Pozicionet e Përgjithshme të Bashkimit European dhe Kroacisë.

Hapja formale e procesit të negociatave u pasua nga një përmbledhje analitike dhe vlerësim i shkallës së harmonizimit të legjislacionit kombëtar me *acquis-in e BE-së, të njohur si "screening"*. Qëllimi kryesor i procesit të *screening* është të përcaktojë diferencat që ekzistojnë midis legjislacionit kombëtar dhe *acquis-it për çdo kapitull me të cilin legjislacionit kombëtar i nevojitet të harmonizohet në datën e aderimit. Mbi bazën e analizave të përcuara, vendit kandidat i nevojitet të deklarojë nëse do të jetë i zoti të harmonizojë plotësisht legjislacionin kombëtar me acquis-in në kapituj individualë ose nëse do t'i nevojiten periudha tranzicioni për të përfunduar harmonizimin dhe implementimin e acquis-it. Screening përcillet individualisht për çdo kapitull. Kohëzgjatja e procesit të screening për kapituj individualë varet nga madhësia dhe sasia e acquis-it për kapitullin respektiv dhe mund të zgjasë nga një ditë në disa javë. Përgjithësisht, procesi i screening zgjat për një vit.*

Pasi të përfundojë *screening*, vendimi mbi hapjen e **negociatave për kapituj individualë**, në varësi të gadishmërisë së vendit kandidat, merret nga Vendet Anëtare përbrenda Këshillit të Ministrave. Me hapjen e negociatave për kapituj individualë, fillon faza e pavarur e negociatave. Gjatë kësaj faze, subjekt i negociatave është një grup kushtesh në bazë të të cilave vendi kandidat do miratojë dhe implementojë *acquis-in e kapitullit respektiv, duke përfshirë këtu periudhat e tranzicionit, të cilat mund t'i ketë kërkuar vendi kandidat.*

Negociatat udhëhiqen në bazën e pozicioneve negocuese të Shteteve Anëtare të BE-së dhe vendit kandidat. Këto

pozicione janë përgatitur për çdo kapitull negocues pas rezultatit të *screening*. Pas rishikimit të procedurave nga Këshilli European në dhjetor 2004, pozicioni negocues i Shteteve Anëtare mund të përmbajë parakushte në hapjen *dhe/ose* mbylljen e kapitujve individualë - të ashtuquajturat *benchmarks* (*etapa*). Ndërkohë që Kroacia është në rrugën e duhur në procesin e negociatave, megjithatë kishte nderin e keq të ishte vendi i parë kandidat që përjetoj sikletin e procedurës së rishikuar për negociatat e adezionit: Sllovenia bllokoi përkohësisht hapjen e negociatave BE-Kroaci mbi kapitullin e ardhshëm të legjislacionit të BE-së duke mos dhënë aprovimin e saj për një raport *screening* të Komisionit European mbi nivelin e përputhjes së legjislacionit kroat për peshkimin me *acquis*. *Sllovenia argumentoi se Kroacia kishte dështuar në implementimin e marrëveshjes kufitare bilaterale mbi bazat e të cilës peshkatarët slloven (që punojnë nga brigjet e Piranit, dalja e vetme e Sllovenisë në det dhe objekt i një mosmarrëveshjeje midis dy shteteve që prej shkëputjes së tyre nga SFRY më 1991) duhet të gëzojnë të drejtat e tyre për kalim përmes ujërave kroate. Bllokimi i Sllovenisë shërbeu si një alarm për të rritur ndërgjegjësimin e anëtarëve të BE-së mbi konfliktet e këtij vendi për kufijtë tokësorë dhe detarë me Kroacinë dhe për të paralajmëruar këtë të fundit për zgjidhjen e çështjes ose të rrezikonin një ndërprerje reale të procesit të negociatave të aderimit.*<sup>10</sup>

Gjatë gjithë procesit të negociatave, Parlamenti European dhe Komisioni Kombëtar për Monitorimin e Negociatave të Aderimit të Republikës së Kroacisë me Bashkimin European

---

<sup>10</sup> Megjithatë, shumë më serioz, ishte vendimi i Këshillit për Çështjet e Përgjithshme dhe Marrëdhëniet me Jashtë në dhjetor 2006 ku “Vendet Anëtare brenda Konferencës Ndërqeveritare nuk do të vendosin për hapjen e kapitullit që mbulon fushat e politikës që kanë të bëjnë me kufizimet kundrejt Turqisë për çështjet e Republikës së Qipros deri sa Komisioni të verifikojë që Turqia ka përmbushur premtimet që kanë të bëjnë me Protokollin e Aderimit”, p.sh. duke hapur portet dhe aeroportet e saj ndaj anijeve dhe avionëve greko-qipriote. Me një lëvizje të paprecedente në historinë e politikave të Zgjerimit, tetë kapituj u pezulluan: lëvizja e lirë e mallrave (Kapitulli 1), e drejta për të ngritur biznese dhe liria për të ofruar shërbime (Kapitulli 3), shërbimet finaciare (Kapitulli 9), bujqësia dhe zhvillimi rural (Kapitulli 11), peshkimi (Kapitulli 13), transporti (Kapitulli 14), shërbimi doganor (Kapitulli 29), dhe marrëdhëniet me jashtë (Kapitulli 30). Këshilli European disa ditë më vonë arriti në përfundimin: “Turqia nuk ka përmbushur obligimet e saj për të implementuar në një mënyrë jodiskriminuese Protokollin e Aderimit të Marrëveshjes së Asocimit”.



u informuan rregullisht mbi rrjedhën e negociatave dhe progresit të bërë.

Pasi arrihet marrëveshja midis BE-së dhe vendit kandidat mbi kapitujt individual të negociatave, dhe pasi përmbushen standardet e fiksuar, kapitulli përkatës konsiderohet *përkohësisht i mbyllur*. Vendimi formal merret nga Konferenca Ndërqeveritare në nivel ministror. Nëse miratohen dispozita të reja për një kapitull specifik të *acquis para se të përfundojë Traktati i Aderimit, ose nëse vendi kandidat dështon në plotësimin e standardeve të përcaktuara ose detyrimet e ndërmarra nën kapitullin respektiv, negociatat për kapitullin në fjalë mund të rihapen. Kur negociatat për të gjithë kapitujt e acquis të jenë mbyllur përkohësisht, Këshilli European, në përfundimet e tij, zakonisht shënon fundin e procesit të negociatave me një vend kandidat. Rezultatet e negociatave përshihen në dispozitat e **draftit të Traktatit të Aderimit**, i cili është hartuar bashkarisht nga përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të BE-së, përfaqësues të institucioneve të BE-së dhe përfaqësues të vendit kandidat.*

Pasi të arrihet një marrëveshje mbi tekstin e Traktatit të Aderimit midis BE-së dhe vendit kandidat, drafti i traktatit i drejtohet institucioneve të BE-së, Vendeve Anëtare të BE-së dhe vendit kandidat, ku u lihet hapësirë procedurave të përshtatshme për ratifikimin e dokumentit.

Para se të **nënshkruajnë Traktatin e Aderimit**, Komisionit European i duhet të paraqesë opinionin e tij përfundimtar për aplikimin për anëtarësim të vendit kandidat mbi bazat e draftit të Traktatit të Aderimit. Gjithashtu, Parlamenti European duhet të japë miratimin e tij, dhe përfundimisht, Këshilli European duhet të arrijë vendim unanim mbi pranimin e vendit të ri kandidat dhe aplikimin e tij për anëtarësim në BE. Nga ky moment e tutje, vendi kandidat konsiderohet si *vend në proces anëtarësimi*.

Traktati nënshkruhet nga zyrtarët më të lartë të Vendeve Anëtare të BE-së dhe të vendit në proces anëtarësimi. Më pas ky dokument i dërgohet nënshkruesve për ratifikim në përputhje me dispozitat kushtetuse vendase.

Pas nënshkrimit të Traktatit të Aderimit, vendi në proces anëtarësimi ka të drejtën të marrë pjesë në punën e Këshillit European dhe të Parlamentit European si një vëzhgues aktiv. Para

se të **ratifikohet Traktati i Aderimit** nga parlamentet kombëtare të Shteteve Anëtare të BE-së, shumica e vendeve në proces anëtarësimi mbajnë një referendum me anë të të cilit ata i lejojnë qytetarëve të tyre të marrin një vendim të fundit mbi hyrjen e vendit në Bashkimin European. Në rast të kundërt, parlamenti i vendit përkatës në proces anëtarësimi mund të ratifikojë Traktatin e Aderimit. Në mënyrë që të hyjë në fuqi, Traktati i Aderimit duhet të ratifikohet nga parlamentet kombëtare të Shteteve Anëtare të BE-së. Ndërkohë që Irlanda mban një referendum të detyrueshëm, shumica e Vendeve Anëtare të BE-së e kufizojnë veten e tyre me një shumicë parlamentare, shpeshherë duke kërkuar një kuorum special. Në Francë, Kushtetuta është ndryshuar kohët e fundit për të përfshirë një dispozitë, e cila udhëzon organizimin e një referendumi për çdo zgjerim të BE 28, pasi Kroacia të jetë anëtarësuar në BE. Vetëm në rast modifikimi ose tërheqje, me siguri aderimi i ardhshëm i Shqipërisë do t'i nënshtrohet një referendumi francez. Supozimi që procesi i ratifikimit të Traktatit të Aderimit me Shqipërinë nuk do të vështirësohet, nuk është një konkluzion i përshpejtuar nëse konsiderojmë përgjigjen e vakët që ka marrë Traktati i Aderimit me Bullgarinë dhe Rumaninë në parlamentet kombëtare të disa Shteteve Anëtare skeptike ndaj zgjerimit.

Vendi në proces anëtarësimi bëhet një anëtar i BE-së me hyrjen në fuqi të Traktatit të Aderimit, përgjithësisht në një datë të paracaktuar, nën kushtin që procesi i ratifikimit të jetë finalizuar.

*Gjergji VURMO, drejtor Programesh pranë IDN-së, ka përfunduar studimet universitare për Drejtësi (Maqedoni) dhe ato pasuniversitare në fushën e studimeve europiane (Universiteti i Bolonjës). Ai ka punuar për disa organizata studimore në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit. Z. Vurmo është autor i një sërë studimesh, raportesh monitorimi dhe analizash në lidhje me politikën e zgjerimit të BE-së, çështjet e brendshme dhe sfidat e rajonit në përfaqësimin me standardet europiane, kriteret e anëtarësimit në BE etj. Gjithashtu, ai ka qenë një nga ekspertët e pavarur të angazhuar nga Qeveria Maqedonase (2004) për të vlerësuar dhe monitoruar procesin e hartimit të përgjigjeve (kriteri politik dhe çështjet e brendshme) ndaj Pjetëtorit të Komisionit European, i cili pasoi aplikimin e këtij vendi për anëtarësim në BE.*

*Dr. Steven Blockmans është studiues i T.M.C. Asser Institute (Hagë) dhe aktualisht punon si ekspert ligjor në kuadër të projektit të financuar nga KE "Mbështetje për Ministrinë e Integritimit European të Shqipërisë".*

Mariola Qesaraku

## SHKOLLA VERORE RAJONALE PËR STUDIME TË SIGURISË

*Iniciativë e përbashkët e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (Tiranë) dhe Institutit të Trajnimeve të Kombeve të Bashkuara UNITAR POCI (United Nations Institute for Training and Research, Programme of Correspondence Instruction in Peacekeeping Operations)*

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN) në bashkëpunim me Institutin për Trajnime dhe Kërkime të Kombeve të Bashkuara (UNITAR POCI) organizoi **Shkollën Verore për Studime të Sigurisë** nga data 8-19 shtator 2008, në Durrës. Kjo iniciativë, e cila u konceptua si një proces i vazhdueshëm trajnimi, kishte si synim avancimin e studimeve në fushën e sigurisë dhe zhvillimin e kapaciteteve jo vetëm kombëtare dhe rajonale, por dhe më gjerë për t'u përballur me sfidat bashkëkohore të sektorit të sigurisë si në aspektet lokale e rajonale të sigurisë, ashtu edhe në një kontekst global.

Ceremonia e hapjes së shkollës verore u mbajt më 9 shtator dhe u zhvillua në sallën e Konferencës në ambientet e Komandës së Forcave të Armatosura. Fjalimet e mirëseardhjes u mbajtën nga drejtori ekzekutiv i IDN-së Z. Sotiraq Hroni, nga eksperti i UNITAR POCI dr. Giovanni Ercolani si dhe komandanti i KFB-së gjeneral brigade Agim Lala.

Kjo Shkollë Verore solli eksperiencën e lektorëve të njohur ndërkombëtarë nga institucione akademike dhe studimore ku mund të përmendim ekspertin e UNITAR POCI dr. Giovanni Ercolani, ekspertin e DCAF (Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura) dr. David Law, ish-presidentin prof. Rexhep Meidani, përfaqësuesin e Delegacionit të Komisionit European në Shqipëri z. Stefano Failla etj. Trajnuesit dhe ekspertët që drejtuan leksionet e

Shkollës Verore përdorën qasje që përfshinë metoda interaktive trajnimi e mësimdhënieje duke lehtësuar absorbimin e lehtë të dijeve dhe praktikimin e tyre nëpërmjet përgatitjes dhe prezantimit analitik të temave të përzgjedhura nga vetë pjesëmarrësit e Shkollës Verore.

Ia vlen për t'u përmendur fakti që pjesëmarrësit e Shkollës Verore ishin studiues, ekspertë, specialistë dhe zyrtarë të lartë nga vendet e Ballkanit dhe Europës. Për të siguruar një nivel sa më të lartë të Shkollës, bordi shkencor i IDN-së në përzgjedhjen e studentëve pati parasysh si kritere përzgjedhjeje që kandidatët të kishin rezultate të larta akademike (shumica e pjesëmarrësve kishin mbaruar Master apo kishin Doktoratura), të kishin interes të veçantë apo eksperiencë për çështjet e sigurisë. Gjithashtu, kriter tjetër ishte përfaqësimi në këtë Shkollë i të gjitha vendeve të Ballkanit dhe më gjerë. Kështu, 11 vende u përfaqësuan në shkollë si Austria, Gjermania, Franca, Italia, Turqia, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Serbia etj. Nga Shqipëria ia vlen për t'u përmendur që kishte edhe tre përfaqësues të Forcave të Armatosura Shqiptare. Një kriter tjetër përzgjedhjeje ishte edhe përfaqësimi sa më i barabartë gjinor në shkollë duke pasur parasysh që siguria është një sektor ku gratë janë më pak aktive në këtë fushë. Stafi i IDN-së arriti të sigurojë një përfaqësim të barabartë pothuajse 50% të të dyja gjinive.

Risia e kësaj Shkollë ishte disegnimi i saj në tri faza, si dhe kombinimi perfekt i strukturës teorike me metoda praktike të përdorimit të njohurive të marra dhe aplikimit të tyre. Faza e parë u kurorëzua me sukses në periudhën 8-19 shtator 2008 në shkollën dyjavore ku pjesëmarrësit në fund të shkollës paraqitën dhe diskutuan temat e një projekti të shkurtër në lidhje me një temë të caktuar në fushën e sigurisë. Në përfundim të kursit dyjavor, IDN u dorëzoi pjesëmarrësve një **“Diplomë për pjesëmarrje”**.

Në kuadër të Shkollës Verore pjesëmarrësve iu ofruan *gjashtë kurse* të veçanta si më poshtë:

- Hyrje në fushën e Studimeve të Sigurisë;
- Analiza dhe kërkimet në fushën e studimeve të sigurisë;

- Siguria në Ballkan;
- Politika e BE-së në fushën e Sigurisë dhe instrumentet e bashkëpunimit rajonal në Ballkan;
- Terrorizmi Global (*diplomë e UNITAR POCI*);
- Paqeruajtja dhe zgjidhja e konflikteve ndërkombëtare (*diplomë e UNITAR POCI*).

Faza e dytë e kësaj iniciative konsiston në projektin që studentët e Shkollës Verore duhet të dorëzojnë nga mesi i nëntorit si dhe të japin provimet përkatëse të kurseve të UNITAR POCI-it që t'u ofrohet diploma e miratuar nga ky Institut (**Certificate of Completion**). Për sa i përket projekteve që studentët duhet të dorëzojnë mund të përmendim disa prej titujve që ata kanë paraqitur, si:

- Rruga drejt Komunitetit të Sigurisë Euroatlantike: Bashkëpunimi BE-NATO në Shqipëri.
- Ballkani Perëndimor: Gjendja e Sigurisë dhe Integrimi Euroatlantik.
- Reforma e Sektorit të Sigurisë në Maqedoni: Një përfaqje (jo)Holistike?
- Probleme të transformimit të sektorit të sigurisë në vendet në tranzicion.
- Krimi i organizuar në Ballkan si një nga kërcënimet më të mëdha për Sigurinë e BE-së.
- Komuniteti Ndërkombëtar në fillimet e viteve '90 drejt Ballkanit Perëndimor: Mungesë dëshire, apo mungesë e një strategjie të saktë?
- Influenca e Ruisë në Sigurinë e Ballkanit Perëndimor.

Faza e tretë e kësaj iniciative do të përfundojë në dhjetor 2008 me anë të një workshopi rajonal në të cilin do të ftohen pjesëmarrësit që kanë dorëzuar projektet më të mira për t'i prezantuar në Tiranë para një audience ekspertësh, profesorësh, kërkuesish dhe specialistësh në fushën e sigurisë. Gjithashtu, këto projekte do të publikohen në një numër të veçantë të Revistës së përtremuajshme të IDN-së "Çështje të Sigurisë".

Gjatë kursit të fundit, pjesëmarrësve të shkollës iu shpërndanë pyetësorë të IDN-së për të shprehur opinionet dhe vlerësimet e tyre për këtë iniciativë të re. Rezultatet e pyetësorëve vunë në dukje nivelin shumë të lartë akademik të shkollës si dhe programin shumë sfidues dhe bashkëkohorë. Si e vlerësuan edhe vetë pjesëmarrësit, Shkolla Verore rajonale 2008 u kurorëzua me sukses dhe ishte një iniciativë e cila iu përgjigj pritshmërive të tyre. Këto vlerësime shumë të larta e nxisin IDN-në që ta kthejë këtë iniciativë në një Shkollë Verore rajonale të përvitshme për studimet e sigurisë.

*Mariola Qesaraku është Senior Researcher në Qendrën për Studime të Sigurisë e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, si dhe Pedagoge e Jashtme në Universitetin e Tiranës. Pasi ka mbaruar studimet për Shkenca Politike, ajo ka vijuar me një Master në Studime Europiane Bashkëkohore. Interesat e saj akademike përfshijnë proceset integruese Euroatlantike dhe fushën e sigurisë. Ajo ka qenë dhe koordinatorja e Shkollës Verore Rajonale për Studime të Sigurisë.*

Mathieu Rousselin

RRUGA DREJT KOMUNITETIT  
EUROATLANTIK:

EFEKTET E MARRËDHËNIEVE BE-NATO  
MBI SIGURINË E SHQIPËRISË

**FALËNDERIME**

Dëshiroj të falënderoj grupin e punës së Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim për iniciativën e tyre për të themeluar Shkollën e parë Verore Rajonale për Studime të Sigurisë në Durrës (Shqipëri). Veçanërisht, dëshiroj t'i shpreh mirënjohjen time Sotiraq HRONIT dhe Mariola QESARAKUT për mbështetjen e tyre dhe disponueshmërinë gjatë dhe pas Shkollës Verore. Së fundi, dua të falënderoj dhe prof. LEHMKUHL nga Universiteti i St. Gallen si dhe kolegun tim Olivier SIEGRIST për këshillat e tyre të vyera. Unë mbaj përgjegjësi të plotë për pikëpamjet e shprehura si dhe për të metat e këtij studimi.

**Hyrje**

Vrojtimi i organizatave aktive në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor habit edhe mbikëqyrësin më të vëmendshëm, deri në atë pikë që të pyesë veten nëse rajoni është përdorur si një laborator nga *një zot* veçanërisht shpikës (apo keqdashës) i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Në rastin e Shqipërisë për shembull, jo më pak se dhjetë organizata ndërkombëtare prezente në tokën shqiptare japin pak a shumë kontributin e tyre në sigurinë kombëtare të vendit:

- Në nivel rajonal (Ballkani Perëndimor), Shqipëria është e përfshirë në një rrjet të lirë organizatash si Procesi i Bashkëpunimit në Europën Juglindore, Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore, Iniciativa për Europën Qendrore, Iniciativa për Bashkëpunim në Europën Juglindore dhe Iniciativa e Adriatikut dhe Jonit.
- Në nivel europian, Shqipëria ose është anëtare, ose aspiron të bëhet anëtare e tri organizatave të tjera: Bashkimi European, Këshilli i Europës dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë.
- Në nivelin më të gjerë rajonal Shqipëria është ftuar së fundmi të përfshihet në negociata aderuese me NATO-n.
- Së fundmi, në nivel global Shqipëria është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe organizmave të tjera që rrjedhin prej saj.

Të gjitha këto organizata kanë karakteristika të përbashkëta dhe ideosikretike - në qëllimet, në sferën e tyre të aktiviteteve, në anëtarësimin, në procedurat vendimmarrëse ose në vlerat ligjore të vendimeve të tyre (nëse marrin ndonjë). Kjo ndërthurje ngre pyetje që kanë të bëjnë me rolin individual të secilës prej këtyre organizatave si dhe në lidhje me impaktin e përfshirjes të shumanshme në shtet, politikat dhe politikën e brendshme (polity, policies and politics).

Megjithatë, të gjithë këto organizata duhet të vihen në një plan të barabartë. “Vlera e shtuar” e secilës prej organizatave, si dhe niveli i kontributit efektiv për të forcuar sigurinë kombëtare të Shqipërisë, ndryshon shumë nga një organizatë tjetra. Përfshirja e Kombeve të Bashkuara (OKB) ka qenë shumë modeste dhe në fakt e limituar në periudhën e krizës së 1997-s. Madje dhe atëherë, ndërhyrja e OKB-së konsisonte thjesht në mbështetjen e qeverisë shqiptare në projekte konkrete, si mbledhja e armëve të vjedhura nëpër depot ushtarake. Në mënyrë të ngjashme, OSBE-ja është kritikuar ashpër për kontributin inekzistent në sigurinë e Shqipërisë: zëra të rëndësishëm kanë akuzuar organizatën për “imperializmin në fushën e sigurisë”, kanë kritikuar mungesën e forcës në realitetin lokal për të mbështetur një largim të



shpejtë nga toka shqiptare dhe kthimin e pushtetit të vendimmarrjes tek institucionet vendore të zgjedhura në mënyrë demokratike<sup>1</sup>. Në nivel rajonal (Ballkanin Perëndimor) organizatat e sipërpërmendura janë më tepër *guaska bosh*, thjesht forume për dialog dhe shkëmbim pikëpamjesh, fakt ky sidoqoftë i rëndësishëm, nëse kemi parasysh historinë e mungesës së besimit midis vendeve të Ballkanit, por kontributi i tyre aktual për sigurinë e përgjithshme të rajonit mbetet i kufizuar në ngritjen dhe forcimin e besimit mes tyre.

Si rrjedhojë, ky artikull fillimisht do të përqendrohet në dy organizata, kontributi i të cilave për sigurinë në Shqipëri është i vërtetuar gjerësisht: Bashkimi Europian (BE) dhe Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Rëndësia e tyre vihet më tepër në dukje dhe nga përpjekjet e tejjgjatura të autoriteteve shqiptare për të aderuar në të dyja këto organizata.

Prandaj ky artikull do të përpiket t'u japë përgjigje dy pyetjeve të mëposhtme:

- *Në nivel makro* - Ka ndonjë parim/metodë organizuese në bazë të të cilave Bashkimi Europian dhe NATO funksionojnë?
- *Në nivel mikro* - Cili është ndikimi në sigurinë kombëtare të Shqipërisë?

Seksioni i parë i këtij artikulli i dedikohet përcaktimit të kuadrit të duhur teorik për të përshkruar tipin e raporteve BE-NATO.

Seksioni i dytë i këtij artikulli merret në mënyrë të veçantë me analizën në nivel mikro, duke u përpjekur të qartësojë bashkëpunimin BE-NATO dhe strategjitë konkurruese në nivel kombëtar si dhe të vlerësojë mundësitë dhe kufizimet e këtyre strategjive në sigurinë e Shqipërisë.

---

<sup>1</sup> S. Hroni, *Ending International Occupation*, janar 2004, i disponueshëm online te: <http://www.project-syndicate.org/commentary/hroni1>

## **1 - Drejt një shpjegimi teorik të marrëdhënieve BE-NATO**

Marrëdhëniet BE-NATO janë bërë një subjekt i modës në fushën e studimeve të sigurisë dhe qëllimi i këtij artikulli do të shkojë përtej rishqyrtimit të literaturës së disponueshme mbi këtë temë. Megjithatë, deri tani është evident fakti që shkollat mbizotëruese të mendimit janë të kufizuara në mundësitë e tyre për të ofruar përshkrime të sakta për sa i përket llojit të raportit midis BE-së dhe NATO-s, dhe për të parashikuar zhvillimet në të ardhmen. Në vazhdim, do të identifikohet kontributi i katër shkollave të mendimit mbizotërues në Marrëdhëniet Ndërkombëtare që mund të ndihmojnë për të përmirësuar kuptimin tonë teorik të faktorëve të ndryshëm influencues në marrëdhënien BE-NATO në sigurinë e Shqipërisë.

### **1.1 - Shkolla e mendimit pragmatik dhe argumenti i ndarjes së punës**

Sipas kësaj shkolle, i vetmi parim organizues që mbizotëron është pragmatizmi i dobishëm i modës së vjetër. Ai mbështetet në premisat që të dyja organizatat kanë vlera dhe aftësi të ndryshme dhe fusha të ndryshme specializimi dhe ekspertize: prandaj, kur ndodh një krizë, vendimmarrësit vendosin se cila organizatë të vihet në lëvizje duke u bazuar në historinë dhe në aftësinë e secilës organizatë për një vlerë të shtuar në terma krahasues.

Kjo është dhe pikëpamja që ndajnë edhe këto dy organizata. Dr. Jamie Shea (Drejtor i Planifikimit të Politikave - NATO) për shembull, ka shtjelluar “metaforën e dy makinave”, përmes së cilës BE dhe NATO janë si dy automjete në pronësi të së njëjtës familje, ku njëra është një makinë e madhe, veçanërisht e favorshme për të transportuar të gjithë familjen në distanca të gjata, ndërsa makina tjetër është më tepër një makinë sportive, ku funksionimi me shpejtësi të madhe është balancuar nga numri i vogël i ndenjësve dhe nga komoditeti disi i pakët. Sipas destinacionit, numrit të pjesëtarëve të familjes për t’u transportuar dhe

orarit të dëshiruar të mbërritjes, familja do të zgjedhë midis njërës makinë ose tjetrës<sup>2</sup>.

*Nga një perspektivë pragmatiste, marrëdhënia midis BE-së dhe NATO-s ndjek logjikën e teorisë së përparësisë së krahasuar. BE-ja dhe NATO janë dy organizata të barabarta, leva neutrale dhe përdorimi i një organizate mbështetet në ekspertizën më të lartë të organizatës për çështjen në fjalë. Kështu që, zgjedhja e aktorëve vendimmarrës për të ngritur një levë apo një tjetër, nuk do të jetë rezultati i një pazarllëku politik, por do të bazohet në një gjykim krejtësisht logjik. Si vazhdim, nuk ka konkurrencë ideologjike, as konflikt interesi, por thjesht një ndarje të shëndetshme të punës, bazuar në vlerat e secilës organizatë dhe në maksimizimin e efikasitetit të produktit.*

## **1.2 - Shkolla realiste e mendimit dhe argumenti i luftës për pushtet**

Realistët mendojnë që Shtetet - duke qenë mbajtësit ekskluzivë të sovranitetit mbi një territor të caktuar dhe meqë konsiderohen si aktorët e vetëm legjitimë në sistemin ndërkombëtar, kërkojnë së pari dhe mbi të gjitha ruajtjen e integritetit territorial, mbrojtjen e popujve të tyre dhe mbrojtjen e interesave kombëtare. Ndonëse koncepti i “interetit kombëtar” qëndron në thelb të teorisë realiste, nuk është përcaktuar asnjëherë në mënyrë të saktë dhe të plotë, gjë që lejon të mbahet hapur lista për çështje të reja dhe në këtë mënyrë të legjitimojë më shumë veprime të shteteve, duke i bërë ata të futen në këtë kategori. Për realistët klasikë si Morgenthau, interesat në thelb duhen kuptuar në terma pushteti (duke e karakterizuar atë si kontroll)<sup>3</sup>. Kërkimi i interesit kombëtar konsiderohet të jetë një sjellje universale, e cila influencohet vetëm në mënyrë të pakët (apo aspak) nga sistemet politike dhe institucionale të shteteve apo nga orientimi ideologjik i tyre.

<sup>2</sup> Metaforë e paraqitur nga dr. Jamie SHEA gjatë një konference në Kolegjin e Europës, Bruges, prill 2008. Në një frymë britanike paanësie, dr. Shea megjithatë refuzoi të qartësojë këtë metaforë për të specifikuar cila nga makinat paraqiste cilin institucion!

<sup>3</sup> H. J. Morgenthau, *Në Mbrojtje të Interesave Kombëtare*, New York Press, 1951.

Nëse konsiderohet pamjaftueshmëria e burimeve, kërkimi i papërkulshëm për pushtet i shteteve, sjell konflikte dhe kundërshti me njëri-tjetrin. Në këtë sistem ndërkombëtar anarkik, mundësitë për bashkëpunim janë të rralla, të kufizuara për sa i përket qëllimeve dhe sigurisht të kufizuara në kohë. Organizatat ndërkombëtare janë përkrahur (në rastin më të mirë) apo janë imponuar (rasti më i shpeshtë) nga pushteti dominues, si një mjet për të përforcuar kontrollin e tij mbi aktorët e tjerë me anë të mjeteve të tjera përveç atyre të diplomacisë tradicionale bilaterale. Themelimi i bashkëpunimit ndërkombëtar nuk sjell ndonjë ndryshim themelor në rolin e marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe me siguri jo fundin e luftës për pushtet. Konkurrenca e egër ende vazhdon të zërë vend përbrenda ngrëhinave të institucioneve dhe organizatave<sup>4</sup>.

*Nga një perspektivë realiste, marrëdhënia BE-NATO* karakterizohet nga një konkurrencë e fortë për pushtet, burime dhe influencë. Deri vonë, kjo ka qenë një konkurrencë për hapësirë politike minimale, ku amerikanët me kokëfortësi kundërshtonin idenë e Europës që zhvillon një politikë të pavarur sigurie dhe mbrojtjeje dhe të disa shteteve europiane (veçanërisht Franca) duke kërkuar haptazi të sfidojë NATO-n duke vështirësuar adaptimin e saj në një ambient të ri të pas Luftës së Ftohtë. Megjithatë, në vitet e fundit, intensiteti i këtij rivaliteti është pakësuar dhe *positive sum games* nuk janë të përjashtuara. Por veçanërisht në terren, BE-ja dhe NATO vazhdojnë të konkurrojnë me njëri tjetrin, duke u përpjekur që secili të tërheqë personelin më të kualifikuar lokal, të sigurojë zyrat qendrore më të mëdha, me vendndodhjen më të mirë dhe të shtrijnë influencën e tyre në vendet partnere.

---

<sup>4</sup> Këtu mund të mendohet për diskutimin e ashpër midis vendeve anëtare të NATO-s për përcaktimin e standardeve dhe normave të përbashkëta, armatimet dhe pajisjet e tjera ushtarake. Duke pasur parasysh kostot e përshtatjes, çdo vend kërkon të influencojë përcaktimin e standardeve të NATO-s në mënyrë që të përshtatet sa më shumë me standartet kombëtare në fuqi. Marrëveshja e arritur ofron një kuadër të besueshëm për balancën e brendshme të fuqisë. E njëjta gjë vihet re madje më tepër në BE (ligjvënësi më i madh në botë).

### 1.3 - Shkolla konstruktiviste e mendimit dhe argumenti i shoqërizimit/socializimit

Modeli konstruktivist vë theksin në normat dhe vlerat e përcaktuara nga strukturat njerëzore si dhe në “logjikën e korrektësisë”<sup>5</sup> të shpalosur nga aktorët e këtyre strukturave. Ashtu si praktikohet në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, shkolla konstruktiviste e mendimit konsideron që institucionet kanë aftësinë që t’i bëjnë aktorët të shoqërizojnë me njëri-tjetrin në mënyrë të tillë që të ripërcaktojnë identitetin, preferencat dhe interesat e tyre. Institucionalizmi sociologjik, një nga teoritë e prejardhura nga shkolla konstruktiviste e mendimit, sugjeron se BE-ja dhe NATO janë komunitete që përmbajnë vlera të demokracisë liberale të tipit perëndimor që anëtarët e rinj kur aderojnë në këto institucione, zotohen që t’i zbatojnë<sup>6</sup>. Më qartë, kjo teori do të thotë që BE-ja është më tepër se *acquis communautaire* dhe NATO më tepër se standarde ushtarake.

Kjo ngre një pyetje shumë të rëndësishme: A janë NATO dhe BE-ja struktura “komunitetesh sigurie” të ndara, apo janë pjesë e një “komuniteti të vetëm euroatlantik të sigurisë”? Edhe pse të dy organizatat ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra, në shumë mënyra (balancat e brendshme, kultura institucionale, procedurat e vendimmarrjes), normat dhe vlerat që mbart anëtarësimi në BE dhe NATO në thelb përkon me: demokracinë, respektin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut, dhe shtetin e së drejtës. Sigurisht, shumë prej këtyre vlerave janë përfshirë edhe në Kartën e Sigurisë së OKB-së, por ka një ndryshim të rëndësishëm midis retorikës dhe zbatimit real, gjë që shpjegon përse detyrimet e komunitetit të OKB-së nuk janë aq solide sa ato të komunitetit të sigurisë euroatlantike. Në mendjet e vendeve partnere që aspirojnë t’i bashkohen dy organizatave, nuk ka asnjë dyshim që anëtarësimi

<sup>5</sup> Për më shumë detaje në këtë logjikë, shiko J. G. March and J. P. Olsen, *The Logic of Appropriateness*, ARENA Working Papers Series 09, May 2004, i disponueshëm online te: [http://www.arena.uio.no/publications/working-papers2004/papers/wp04\\_9.pdf](http://www.arena.uio.no/publications/working-papers2004/papers/wp04_9.pdf)

<sup>6</sup> Shiko J. Checkel (ed.), *International Institutions and Socialization in Europe*, Cambridge University Press, 2007

në BE dhe NATO është i pandashëm dhe që së bashku formojnë një të tërë<sup>7</sup>.

*Nga një perspektivë konstruktiviste, marrëdhënia midis BE-së dhe NATO-s është në radhë të parë e orientuar ndaj përhapjes së më të gjerë të vlerave të demokracisë liberale, drejt shoqërizimit të elitave politike dhe ushtarake në vendet partnere. Ky bashkëpunim i të dy organizatave për të arritur objektiva të përbashkëta theksohet edhe nga paralelizmi i strategjive të aderimit, për shembull midis partneritetit për paqe të NATO-s dhe Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit të BE-së që mund të shihen si “dhoma pritje të shoqërizimit”<sup>8</sup>.*

#### **1.4 - Shkolla e zgjedhjes racionale të mendimit dhe argumenti për vlerën më të mirë të parasë**

Edhe pse shkolla racionale e mendimit ndan shumë ide me teoritë realiste, është më pak ekstremiste në lidhje me mundësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar. Po të marrim shtetin si njësi bazë e analizës (të ashuquajturin individualizmin metodologjik), alternativa e institucionalizmit racional kërkon të shpjegojë sjelljen brenda një organizate duke iu referuar konceptit “*kërkimi i qëllimeve individuale nën kufizime*”<sup>9</sup>: Shtetet bashkëpunojnë në kuadrin e organizatave ndërkombëtare deri sa këto të fundit lejojnë maksimizimin e leverdisë së shtetit me kosto më të vogla duke pasur parasysh kufizimet që shtetet kanë nga burimet e kufizuara (koha, popullsia, të ardhurat, akses të informacionit), nga kuadri institucional i tyre (ligjet ndërkombëtare) dhe nga zgjedhjet e aktorëve të tjerë (si rezultat i ndërveprimit social).

Sipas teorive të zgjedhjes racionale, organizatat përdoren nga Shtetet Anëtare për të ndjekur interesin e tyre kombëtar

<sup>7</sup> Shiko për shembull fjalimin e presidentit Saakashvili në Konferencën e 44<sup>th</sup> në Munihi mbi Politika e Sigurisë, disponibël te: <http://www.securityconference.de/konferenzen/rede.php?sprache=en&id=214&>

<sup>8</sup> Shiko M. Rousselin, “Security Institutions as socialisation arenas; NATO’s Partnership for Peace and the Socialisation of Central and Eastern European Countries”, publikim ne perгатitje.

<sup>9</sup> D. Snidal, “Zgjedhja Racionale dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare”, in W. Carlsnaes, B. Simmons dhe T. Risse (ed.), *Manual i Marrëdhënieve Ndërkombëtare*, Sage, 2002.

(ku përcaktimi i të cilit do të jetë në thelb ai i realistëve). Organizatat mund të kufizojnë *hapësirat e frymëmarrjes* së shteteve por është racionale për shtetet të pranojnë deri diku një nivel institucional të kufizuar në mënyrë që, për shembull, të ulen kostot e shitblerjeve ose të rritet në mënyrë të ndjeshme siguria kombëtare. Vendimi për të aderuar në një organizatë ndërkombëtare merret në radhë të parë nga një analizë kosto/përfitime, sipas logjikës së konsekuencializmit<sup>10</sup>.

*Pra, nga perspektiva e zgjedhjes racionale, marrëshënja midis BE-së dhe NATO-s është kryesisht konkurruese.* Të dy institucionet mund të shihen si furnizues rivalë të sigurisë, duke konkurruar në një tip tregu ndërkombëtar sigurie dhe duke i ofruar klientëve të tyre (shteteve) paketën më të plotë të sigurisë me koston më të ulët të mundshme - me fjalën “kosto” duke mos e kuptuar thjesht në terma monetarë, por në një kuptim më të gjerë “kosto oportuniteti” sepse vendimi për t’u mbështetur në një organizatë apo një tjetër ka pasoja shtimi në buxhet, si kufizimi i aleancave alternative (një vend anëtar i NATO-s ka pak perspektivë për të konkluduar një marrëveshje ushtarake me Rusinë) ose *de facto* zvogëlimi i sovranitetit kombëtar (për shembull nëpërmjet mekanizmave të Nenit 5 të NATO-s) duke pasur parasysh bashkëpunimin më të ngushtë në politikën e jashtme dhe të sigurisë. Shtetet racionale integrojnë të gjithë këto parametra në llogaritë e tyre dhe pastaj vendosin në cilën organizatë të mbështeten bazuar në dy principe të përgjithshme: (1) vlera më e mirë monetare dhe (2) shpërndarja optimale e burimeve të kufizuara.

### 1.5 - Shtojcë

Marrëdhëniet BE-NATO janë të vështira për t’u kuptuar teorikisht, edhe pse shumë studiues përpiqen që të formulojnë një teori të vetme *teorinë e madhe* që lejon të përshkruajë natyrën e raportit dhe të parashikojë zhvillimet e mëtejshme. Mënyra më e mirë për të vazhduar është zgjedhja e një përzierje kuadrosh teorike të ndryshme, secila prej të cilave ndriçon

<sup>10</sup> Për një arsyetim më të qartë për këtë logjikë, shiko, J. G. March and J. P. Olsen, *op. cit.*

aspekte të ndryshme të kësaj marrëdhënieje komplekse dhe në lëvizje:

- Marrëdhëniet BE-NATO bazohen në radhë të parë në elemente pragmatike. Asnjë *teori e madhe* (grand theory) sistematike lejon të shpjegohet plotësisht (e lënë vetëm për të parashikuar) vendimin për të mobilizuar një organizatë në vend të një tjetre.
- Realistët do të theksonin që ekzistenca e dy organizatave aktive në të njëjtën fushë domosdoshmërisht nënkupton një nivel të caktuar konkurrence, gjithashtu si në nivel kombëtar (konkurrencë për influencë, për hapësirë politike) dhe në nivel lokal (konkurrencë për burim, për staf të kualifikuar). Konkurrenca e fortë për influencë zë vend dhe midis vendeve anëtare brenda organizatave.
- Çështja e identitetit. Një rol kyç i BE-së dhe NATO-s është që t'i përcjellë vendeve anëtare një ndjenjë përkatësie në një komunitet euroatlantik bazuar në vlera të përbashkëta. Nga kjo perspektivë konstruktiviste, marrëdhëniet BE-NATO janë në radhë të parë bashkëpunuese, duke u përjekur të përhapin vlerat e demokracisë liberale duke *shoqërizuar* vendet partnere dhe ato candidate.
- Sipas shkollës së mendimit të zgjedhjeve racionale që frymëzohet nga pikëpamjet e tregut, të dyja organizatat në fund të fundit janë thjesht ofruese shërbimesh: nëse vendet anëtare sillen si agjenci racionale, BE-ja dhe NATO konkurrojnë ekonomikisht për të ofruar vlerën më të mirë për para nën kufizime të rrepta buxhetore.

Secila shkollë e mendimit prodhon mundësi dhe kufizime specifike dhe në këtë mënyrë shkakton pasoja specifike për sigurinë e Shqipërisë. Kuptimi i marrëdhënieve BE-NATO dhe mirinformimi për pasojat mbi sigurinë kombëtare do të lejojë autoritetet shqiptare të planifikojnë politika dhe strategji të përshtatshme në marrëveshjet e tyre me BE-në dhe NATO-n.



## 2 - Pasojat në sigurinë e Shqipërisë

Seksioni i dytë i këtij artikulli merret në mënyrë të veçantë me një analizë në nivel mikro. Duke u frymëzuar nga konkluzionet që katër shkollat e mendimit na lejuan të nxjerrim në lidhje me marrëdhëniet midis BE-së dhe NATO-s, do të analizohen mundësitë dhe kufizimet e dala nga anëtarësimi i ardhshëm i Shqipërisë në këto dy organizata sigurie mbivendosëse (që kanë aspekte të përbashkëta).

### 2.1 - Mundësitë që rrjedhin nga marrëdhëniet BE-NATO

Ky seksion ka për qëllim të analizojë se si ekzistenca e dy organizatave gjerësisht mbivendosëse (që kanë karakteristika të përbashkëta) i shërbejnë interesave shqiptare.

Literatura mbi mbivendosjen e institucioneve dhe qeverisjen me shumë nivele shpesh përmend mundësinë për të ashtuquajturën *forum shopping*<sup>11</sup>, e cila i referohet sjelljes së një shteti në një situatë ku disa organizata kanë kompetenca në të njëjtat fusha, duke u lejuar vendeve që të zgjedhin organizatat që ata konsiderojnë më të afërta me interesat e tyre. Megjithatë, duke e zbatuar në rastin tonë, Shqipëria nuk është në gjendje të zhvillojë sjellje *forum shopping* për shumë arsye. Së pari, diferencat janë praktikisht jo ekzistente midis BE-së dhe NATO-s në pjesën më të madhe të çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë e Shqipërisë. Së dyti, si BE-ja edhe NATO janë të ndërgjegjshme për mundësinë e sjelljeve të tilla dhe veprojnë në përputhje me rrethanat në mënyrë që t'i evitojnë ato (konsultime të rregullta, në samitet BE-NATO). Së treti, dhe më e rëndësishmja, Shqipëria nuk ka asnjë fuqi mbi të dyja këto organizata (në të cilat nuk është ende anëtare) dhe aftësia e saj për t'i influencuar ato (për shembull për të zgjedhur një forum) është shumë e kufizuar. Aktorë të tjerë (Shtetet e Bashkuara, Komisioni European, shtetet më të mëdha të BE-së) luajnë një rol vendimtar. Prandaj, mundësia teorike për të

---

<sup>11</sup> Shiko për shembull M. Busch, "Overlapping Institutions, Forum Shopping and Dispute Settlement in International Trade", në: *International Organization*, Cambridge University Press, vol. 61, 2007, pp. 735-761.

zgjedhur praktikisht përjashtohet: Shqipëria është një vend që ka një rol pasiv në marrjen e vendimmarrjes sesa një vend vendimmarrës aktiv në çështjet e sigurisë.

Sidoqoftë, prania e BE-së dhe NATO-s në tokën shqiptare (me delegacionet respektive) sjell të paktën dy efekte pozitive madhore në sigurinë e Shqipërisë, të cilat mund të shpjegohen nga modeli shpjegues i ofruar nga shkolla konstruktiviste e mendimit.

Së pari, meqë Shqipëria është e përfshirë në fazën e pre-aderimit në BE dhe në negociata aderimi në NATO, perspektiva e anëtarësimit shërben si një stimul i fuqishëm për reforma. Ka dy mënyra për ta lexuar këtë: Së pari, ndërsa realistët do të argumentojnë që kjo krijon një marrëdhënie shumë asimetrike në të cilën Shqipëria nuk ka mjete për të kundërshtuar ndikimin e BE-së dhe NATO-s (shiko pjesën 2.2), konstruktivistët do të përgjigjeshin që marrëdhënia e bashkëpunimit midis BE-së dhe NATO-s punon për më të mirën e Shqipërisë, sepse i lejon të dyja organizatat për të bashkuar përpjekjet për të sjellë standardet shqiptare më afër normave dhe rregullave perëndimore. Nga kjo perspektivë, Shqipëria përfiton nga eksperiencia e gjatë e të dy organizatave dhe eksperiencia e vërtetuar në fushën e reformave demokratike, ndërkohë që marrin asistencë financiare, ndihmë e cila mbulon një pjesë të shpenzimeve të lidhura me procesin e reformave. Kjo pikëpamje përforcohet nga fakti që prioritetet e vendosura nga BE-ja dhe NATO për Shqipërinë janë në thelb të mbivendosura<sup>12</sup>, duke vënë në evidencë unitetin e qëllimeve dhe duke ofruar evidencë në mbështetje të argumentit konstruktivist sipas të cilit BE dhe NATO janë themelues të një komuniteti të vetëm të sigurisë mbartës me vlerat e demokracisë liberale.

---

<sup>12</sup> Për shembull, ka një simetri midis prioriteteve të identifikuar nga BE-ja në Raport Progresin e 2007-s dhe 2008-s dhe prioriteteve të Plan Veprimit për anëtarësim të NATO-s (MAP). MAP-i i NATO-s nuk është i kufizuar vetëm me reformat në sektorin e ushtrisë, por ka dhe prioritete në fushën ekonomike (përmirësimin e ekonomisë së tregut, inkurajimin e rritjes ekonomike, vazhdimësinë e procesit të privatizimit) si dhe prioritete të demokracisë liberale (të sigurojë respektime të të drejtave të njeriut duke përfshirë dhe të drejtat e minoriteteve, forcimi i institucioneve demokratike, themelimi i një administrate publike efiçente). Prioritetet e MAP-it janë renditur në faqen e Ministrisë së Mbrotjtjes Shqiptare: <http://www.mod.gov.al/index.php?crd=0,0,0,0,1,Lng2>

Së dyti, prania e zyrtarëve të BE-së dhe NATO-s në terren lejon shoqërizimin/socializimin e nënpunësve të shtetit shqiptar, një tjetër element themelues i botëkuptimit konstruktivist të Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Me anë të takimeve të rregullta, ushtrimeve të përbashkëta dhe shkëmbime pikëpamjesh me BE-në dhe NATO-n, pjesëtare të administratës publike shqiptare njihen gjithmonë e më tepër me procedurat, kulturën e organizimit dhe mënyrën e të menduarit të NATO-s dhe BE-së. Prandaj shoqërizimi i ushtrisë shqiptare dhe i elitës politike e përgatit tanimë vendin për t'u bërë një vend anëtar aktiv i të dy organizatave. Por shoqërizimi është menduar gjithmonë si një proces i dyanshëm, që konsiston në mësim të dyanshëm sesa një imponim pikëpamjesh nga njëra palë mbi tjetrën. Dhe me të vërtetë, këto kontakte midis nëpunësve civilë shqiptarë dhe përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare lejojnë zyrtarët e BE-së dhe NATO-s të përçojnë në Bruksel dhe Uashington pozicionin që Shqipëria ka mbi çështje të një ndjeshmërie kombëtare (si për shembull Kosova).

Nëse marrëdhëniet BE-NATO do të ndjekin modelin e shkollës pragmatike të mendimit, mundësi të tjera krijohen sepse Shqipëria do të përfitojë nga udhëheqja e secilës organizatë në fushat ku ato kanë ekspertizën më të madhe, sipas principit të sipërpërmendur të ndarjes së punës. Për shembull, nëpërmjet veprimeve të kryera në vendet nën kontrollin e dikurshëm sovjetik, NATO ka një eksperiencë njëzetvjeçare reformash që kanë si qëllim themelimin dhe formimin e kontrollit demokratik dhe modernizimit të Forcave të Armatosura. Duke kërkuar mbështetjen e NATO-s dhe BE-së në fushat ku ato mund të kontribuojnë më tepër, Shqipëria mund të maksimizojë efincencën e reformave.

## **2.2 - Kufizimet e lindura nga marrëdhëniet BE-NATO**

Marrëdhëniet BE-NATO ofrojnë mundësi të reja për Shqipërinë, por dhe kufizime. Duke përdorur kryesisht modelin shpjegues të propozuar nga shkolla realiste e mendimit, qëllimi i këtij seksioni është të analizojë se si

ekzistenca e dy organizatave gjerësisht mbivendosëse me njëra-tjetrën ka efekte negative në interesat kombëtare të Shqipërisë.

Kufizimi i parë dhe më i rëndësishëm lidhur me praninë ndërkombëtare në tokën shqiptare ka të bëjë me humbjen e sovranitetit kombëtar. Efekti më i drejtpërdrejtë i këshillave që ofrohen nga delegacionet e BE-së dhe NATO-s në terren është që të kufizojnë qeverinë shqiptare, pra hapësirën e institucioneve të zgjedhura në mënyrë legjitime dhe demokratike. Megjithatë nuk duhet shpejtuar për të akuzuar BE-në dhe NATO-n për imperializëm në fushën e sigurisë: në fund të fundit, të gjitha politikat kyçe të brendshme dhe të jashtme janë vendime që propozohen nga qeveria shqiptare dhe aprovohen nga parlamenti. Gjithashtu, qeveria shqiptare mund të vendosë me ndërgjegje të plotë pasojat për të *tregtuar* sovranitetin kombëtar, për përfitime në fushën e sigurisë dhe influencë në rritje mbi çështjet botërore.

Por humbja e sovranitetit mund të jetë më delikate. Në realitet, BE-ja dhe NATO rrallë detyrojnë apo ndalojnë një vend anëtar për të marrë hapa konkrete politikash, por të dy organizatat kanë përcaktuar një kuadër pricipesh, normash dhe standardesh nga të cilat duhet të derivojë çdo politikë e vendeve anëtare. Këto principe, norma dhe standarde duke qenë të integruara në ligjet kombëtare, kufizojnë efektivisht numrin e opsioneve të politikave për qeveritë. Këto kufizime megjithatë janë të brendshme dhe jo të jashtme, gjë që zëvendëson akuzat e imperializmit (përkundrajt BE-së dhe NATO-s) me atë të vetëkufizimit (nga qeveritë e vendit).

Për të kuptuar kufizimin e dytë, është e rëndësishme të shihet mënyra se si këto principe, norma dhe standarde janë adaptuar në legjislacionin e vendit. Gjatë negociatave të hyrjes, një asimetri themelore u ngrit midis vendeve anëtare (të brendshmit) dhe vendet kandidate (të jashtmit), që i lejon të parët të ushtrojnë pushtet dhe influencë mbi të dytët. Vendeve kandidate u kërkohet të integrojnë legjislacionin pre-ekzistent në legjislacionin e tyre kombëtar në fuqi. Në terren, për të marrë një shembull konkret, pritet që nënpunësit civilë shqiptarë të punojnë me standardet e BE-së dhe NATO-s në stërvitje të përbashkëta apo takime bilaterale (software

kompjuterash, sisteme telekomunikimi, certifikata sigurie, karakteristikë armatimesh etj.). Në rastin e BE-së, kjo paraqet 23.000 pjesë legjislacioni të ndarë në 35 kapituj tematikë. Në kundërshtim me besimin e shkollës konstruktiviste të mësimit reciprok, vendet kandidatë nuk kanë asnjë lloj influence për përmbajtjen e legjislacionit që duhet adoptuar - ata duhet ta "tresin" atë. Ky imponim i njëanëshëm ka çuar në akuzën e "imperializmit të rregullt"<sup>13</sup>. Në të njëjtën mënyrë NATO-ja kërkon të plotësohen disa standardte teknike: edhe këto janë adoptuar pa leverdi, si rezultat i marrëveshjeve ndërshtetërore por nuk kanë asnjë justifikim normativ, ata nuk janë "më mirë" se sa standardet kombëtare ekzistente (dhe funksionale). Edhe pse adoptimi i një standardi teknik apo i një tjetri nuk mund të shihet si një thyerje e madhe e sovranitetit kombëtar, zëvendësimi i standardeve kombëtare me ato të NATO-s dhe BE-së sjell kosto të mëdha, si rrjedhojë e vë në vështirësi buxhetin shqiptar.

Pengesa e tretë është një mësim i drejtpërdrejtë nga shkolla realiste. Duke pasur parasysh asimetrinë e pushtetit dhe influencës së krijuar si nga mundësitë e kufizuara dhe nga pozicioni i brendshëm/i jashtëm, BE-ja dhe NATO mund të vënë theksin në prioritete që nuk janë aspak prioritet e Shqipërisë. Si rrjedhojë, Shqipërisë i duhet të zhvillojë kapacitete dhe ekspertizë në sektorë që nuk janë thelbësore në interesat e sigurisë së tij. Për shembull si BE-ja dhe NATO u kërkojnë vendeve anëtare të dedikojnë kohë, personel, dhe burime finaciare për luftën kundër terrorizmit. Padashur të zhvlersojë aktivitetet terroriste në Shqipëri, shtrohet pyetja nëse këto burime do shpenzoheshin në mënyrë më efektive nëse alokoheshin për luftën kundër korrupsionit, kundër krimit të organizuar dhe reformave në sistemin gjyqësor.

Pengesa e katërt rrjedh nga sociologjia e organizatave dhe është e lidhur direkt me ndonjë nga të katër shkollat e mendimit të sipërpërmendura. Po të reflektojmë në terma idealistë, sociologu gjerman Max Weber e konsideroi -

---

<sup>13</sup> Për një diskutim mbi Imperializmin Eruopian rregullator duke përfshirë dhe *soft dhe hard power* të Europës, shiko Z. Laïdi, *The Unintended Consequences of European Power*, Sciences-Pô / Centre d'Etudes Européennes, Cahier européen n°5/2007.

burokracinë moderne si formën e administratës publike më racionale dhe eficiente, me kusht që ato të respektojnë shtatë principe - vetëm për të vërtetuar faktin që realisht burokracitë nuk punojnë kurrë sipas këtyre principeve<sup>14</sup>. Më vonë, sociologu francez Michel Crozier zhvilloi teorinë e mosfunksionimit burokratik, përmes së cilës burokratët përdorin pozicionet e tyre për të maksimizuar përfitimet e tyre, duke krijuar kështu luftë për pushtet të egër brenda organizatës ku ndodhen. Crozier përmend, gjithashtu, edhe rrezikun e një marrëdhënieje pushteti paralele duke iu referuar një situatë ku segmente më të gjerë burokratikë të organizatës kërkojnë të fitojnë pavarësi nga organizata qendrore<sup>15</sup>. Këta dy sociologë ndajnë pikëpamjen se burokracitë fillimisht ndërtohen si aktorë të paanshëm për të racionalizuar menaxhimin publik dhe për të arritur interesin e përgjithshëm, me kohë ata zhvillojnë interesa personale, ku më evidenti është me siguri një shqetësim i mprehtë për mbijetesën e tyre. Ndoshta kjo karakteristikë theksohet kur disa organizata garojnë me njëra-tjetrën në terren, sepse secila kërkon të legjitimojë jo vetëm veprimet e saj por dhe ekzistencën e saj.

Megjithëse sot ka vetëm disa zëra që ngrenë hapur dyshime mbi legjitimitetin global të BE-së dhe NATO-s, e njëjta vërejtje nuk u adresohet delegacioneve lokale kontributi i të cilave mbi objektivat e përgjithshëm të Unionit dhe Aleancës është më pak i dukshëm. Delegacionet janë akuzuar periodikisht për faktin se ofrojnë punë të mirëpaguara një grushti njerëzish të administratës civile ndërkombëtare. Zyrat qendrore vënë nën presion delegacionet e tyre duke u kërkuar atyre që të justifikojnë investimin e bërë duke i financuar. Prandaj delegacionet duhet të krijojnë legjitimitetin e tyre përkundrejt autoriteteve shqiptare, përkundrejt zyrave të tyre qendrore dhe përkundrejt publikut të gjerë. Për të bërë këtë, ato kanë tendencën të shumëfishojnë aktivitetet (seminare, konferenca, aktivitete trajnuese profesionale) me një kontribut të paqartë për objektivat e përgjithshme të organizatës. Këto veprime nuk janë një pengesë për Shqipërinë me kusht që ato të jenë

---

<sup>14</sup> M. Weber, *Wirtschaft und Gesellschaft*, 1922.

<sup>15</sup> M. Crozier, *Le Phénomène Bureaucratique*, Le Seuil, 1963.

individualizuar për nevojat e administratës shqiptare, përndryshe ato përbëjnë një shpërdorim të fondeve publike.

## KONKLUZION: ADRESIMI I HENDEKUT TË PRITSHMËRIVE

Po të bazohemi në analizën tonë mund të themi se marrëdhënia BE-NATO prodhon si mundësi dhe kufizime, të cilat kanë potencialin të përmirësojnë sigurinë e Shqipërisë nëse adoptohen politika dhe strategji adekuate.

Megjithatë, për të marrë më të mirat e asaj çfarë BE-ja dhe NATO-ja ofrojnë, Shqipëria ka nevojë të qartësojë pritshmëritë e saj për sa i përket anëtarësimit. Autoritetet shqiptare e konsiderojnë si anëtarësimin në BE ashtu dhe atë në NATO të një rëndësie strategjike të njëjtë, si është deklaruar nga Programi Qeverisës 2005-2009, i cili përcakton anëtarësimin në NATO dhe BE si një nga qëllimet kryesore<sup>16</sup>. Në këtë mënyrë, objektivi i anëtarësimit në NATO dhe BE mund të konsiderohen si parimet drejtuese të veprimeve të qeverisë shqiptare<sup>17</sup> dhe të Programit Qeverisës, si një retorikë që shfrytëzohet në radhë të parë për të bindur komunitetin ndërkombëtar për vendosmërinë e qeverisë në këto çështje.

Nga perspektiva e qeverisë, nuk ka konflikt midis objektivave të integritimit në BE dhe NATO; përkundrazi, meqë të dy organizatat kanë kushte të ngjashme për anëtarësim dhe janë bashkuar për të kërkuar progres të prekshëm në të njëjtat fusha, ato shihen si të dy faqet e së njëjtës medalie euroatlantike. Ky këndvështrim përforcohet nga debati politik mbizotërues, që sistematikisht e lidh anëtarësimin në të dyja

<sup>16</sup> Programi Qeverisës 2005-2009, i prezantuar në Parlamentin Shqiptar, Tiranë, më 08.09.2005, disponibël online te: <http://mfa.gov.al/web/pub/programien2100.pdf>

<sup>17</sup> Ky fakt është përsëritur në shumë raste. Shiko për shembull "Të gjitha reformat dhe programet e qeverisë do të **planifikohen dhe implementohen në mënyrë që t'i përshtaten modeleve europiane dhe të arrijnë standardet europiane të Demokracisë, shtetit të së drejtës, ekonominë e tregut dhe të drejtat e minoriteteve dhe individëve, si një kusht paraprak për anëtarësimin e Shqipërisë në BE dhe NATO**". (p. 5) dhe më poshtë "I gjithë programi është **planifikuar dhe do të implementohen me vendosmërinë për të arritur të gjitha standardet e përcaktuara** që do të çojë në anëtarësimin e plotë në Bashkimin Europian dhe NATO në një të ardhme të afërt." (p. 40)

organizatat. Për shembull, në fjalimet e politikës së jashtme, presidenti B. Topi vazhdimisht i referohet “Politikave Euroatlantike”<sup>18</sup> të vendit ose të “orientimit euroatlantik”<sup>19</sup> të tij. Interesant është fakti që ky perceptim nuk kufizohet vetëm tek elita politike dhe ushtarake. Një studim i drejtuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim ka treguar se për shembull, NATO nuk perceptohet thjesht si një aleancë ushtarake, por si një organizatë e cila udhëhiqet nga vlerat<sup>20</sup>. Ky studim tregoi një nivel të lartë sensibilizimi në popullsinë e studiuar rreth lidhjes midis proceseve integruese të BE-së dhe NATO-s<sup>21</sup>.

Por shpesh shpresat mund të jenë çorientuese. Për pjesën më të madhe të elitës dhe popullsisë shqiptare BE-ja dhe NATO duket si një mjet për t’u futur në komunitetin euroatlantik, që perceptohet si një familje e begatë dhe mbrojtëse<sup>22</sup>, një portë drejt prosperitetit ekonomik perëndimor dhe sigurisë politike. Kjo shpjegon pse anëtarësimi në BE dhe NATO është transformuar në një çeshtje principi, një qëllim në vetvete dhe jo më një mjet për të arritur një qëllim të mirëpërcaktuar: dimensionin psikologjik (“kthimi në Europë” ose argumenti i familjes) ka dalë mbi përqsasjen racionale të bazuar në një mendje të ftohtë, analizë jo emocionale e kostove dhe përfitimeve për sa i përket pritshmërive nga anëtarësimi<sup>23</sup>.

<sup>18</sup> Fjalimi i presidentit B. Topi, në Samitin e Bukureshtit, 3 prill 2008, disponibël online te: <http://www.president.al/english/pub/info.asp?id=2215>

<sup>19</sup> Fjalimi i presidentit B. Topi, në takimin e pesëmbëdhjetë të Kryetarëve të Shteteve të Vendeve të Europës Qendrore, 2 maj 2008, disponibël online te: <http://www.president.al/english/pub/info.asp?id=2247>

<sup>20</sup> Shiko Institute for Democracy and Mediation, *Albanian Perceptions on NATO integration*, June 2007, p. 15.

<sup>21</sup> *Ibid*, p. 25.

<sup>22</sup> Presidenti B. Topi përdori shprehjen “Familja Euroatlantik” gjatë fjalës së tij te forumi mbi sigurinë dhe politikën e jashtme, 7 shkurt 2008. Fjalimi është disponibël online te: <http://www.president.al/english/pub/info.asp?id=2125>

<sup>23</sup> Për të qenë plotësisht të drejtë, studime mbi “mendjen e ftohtë” janë bërë por janë të rralla. Shiko për shembull publikimin e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim te *Kostot dhe Përfitimet e Anëtarësimit në NATO* bazuar në gjetjet e konferencës rajonale të mbajtur në Tiranë, më 4-5 maj 2008. “*Debati publik mbi anëtarësimin në Shqipëri por dhe në vende të tjera [Ballkani Perëndimor] të rajonit duket se përqendrohet vetëm tek aspektet pozitive të anëtarësimit Euroatlantik [...] Kjo përqsasje [...] nuk ofron një ide realiste dhe të balancuar në lidhje me anëtarësimin në NATO.*” (p. 7)



Kjo pikëpamje naive nuk është pa rreziqe. Si na kanë treguar zgjerimet e 2004-s dhe 2007-s pritshmëritë irracionale dhe të ekzagjeruara për përfitime të shpejta (sidomos ekonomike) të asocuara me anëtarësimin në BE kanë rezultuar në një zhgënjim të shpejtë dhe në ndjenja euroskepticizmi të vashdueshëm në pjesën më të madhe Europës Qendrore dhe Lindore, sepse shpesh efektet në terma afatshkurtra janë zakonisht jo popullore dhe kanë kosto të larta - ristrukturimi i aktivitetit ekonomik që çon në rritjen e papunësisë, ndryshimin e shpenzimeve publike që sjell dëmtimin e ndihmës sociale, reduktimi dhe modernizimi i forcave të armatosura ose, në rastin e Shqipërisë, vendosja e kontrolleve të rrepta në kufij që do të sillte një ulje në lirinë e lëvizjes së qytetarëve kosovarë në territorin shqiptar.

Për të mbyllur këtë boshllëk pritshmëri, mund të formulohen rekomandimet e mëposhtme:

- 1 - Duhet vlerësuar me kujdes kostot dhe përfitimet e pritshme të anëtarësimit në NATO dhe BE-së si në terma afatshkurtra ashtu dhe në terma afatmesme, bazuar në përjasjen e *Zgjedhjes Racionale*. Kostot dhe Përfitimet duhen kuantifikuar në mënyrë sa më precize dhe të përfshijnë dimensionin politik, ekonomik, social, infrastrukturual dhe kulturor. Ky vlerësim do të përdoret nga qeveria të formulojë politika të përshtashme për të reduktuar efektet negative të anëtarësimit.
- 2 - Të rrisë ndërgjegjësimin e publikut rreth çështjeve të BE-së dhe NATO-s nëpërmjet programeve të ndryshme që përfshijnë shoqërinë civile (fushata informuese, përdorimi i shtypit dhe televizioneve, ndërhyrje në shkolla, kolegje dhe univeristete), duke theksuar kostot dhe përfitimet e anëtarësimit për të lejuar një debat publik të mirinformuar dhe jo vetëm të kufizuar për parlamentin.
- 3 - Përcaktim i qartë i pritshmërive nga BE-ja dhe NATO: ndihmë me asistencë teknike dhe financiare në përpjekjet e përbashkëta të adoptimit të standardeve europiane.

**BIBLIOGRAFI**

- BURCHILL Scott, DEVETAK Richard, LINKLATER Andrew, PATERSON Matthew, REUS-SMIT Christian and TRUE Jacqui, *Theories of International Relations*, Palgrave, 2001
- CHECKEL Jeffrey (ed.), *International Institutions and Socialization in Europe*, Cambridge University Press, 2007
- CROZIER Michel, *Le Phénomène Bureaucratique*, Le Seuil, 1963
- HOWORTH Jolyon, *Security and Defence Policy in the European Union*, Palgrave, 2007
- INSTITUTE FOR DEMOCRACY AND MEDIATION, *Costs and Benefits of NATO Membership, Albanian and Regional Challenges after the Bucharest Summit*, May 2008
- MARCH James and OLSEN Johan, *Rediscovering Institutions*, New York, The Free Press, 1989
- MORGENTHAU Hans Joachim, *In Defense of National Interest*, New York Press, 1951
- RIECKE Henning, *Die Transformation der NATO - die Zukunft der euro-atlantischen Sicherheitskooperation*, NOMOS - Deutsche Gesellschaft für Europäische Politik, 2007
- SMITH Michael E., *Europe's Foreign and Security Policy, the Institutionalization of Cooperation*, Cambridge University Press, 2004
- WEBER Max, *Wirtschaft und Gesellschaft - Grundriß der verstehenden Soziologie*, 1922
- WEBER Cynthia, *International Relations Theory, a critical introduction*, Routledge, 2<sup>nd</sup> edition, 2005

**Artikuj**

- BUSCH Marc, "Overlapping Institutions, Forum Shopping and Dispute Settlement in International Trade", in: *International Organization*, Cambridge University Press, vol. 61, 2007, pp. 735-761

- ELBASANI Arolda, "Democratisation Process in Albania: manipulation or Appropriation of International Norms?", in: *Southeast European Politics*, Vol. 5, No. 1, May 2004, pp. 24-44
- GRASA Rafael and COSTA Oriol, *Where has the old debate gone? Realism, Institutionalism and IR theory*, Institut Barcelona d'Estudis Internacionals, IBEI Working papers, 2007/5
- Hroni Sotiraq, *Ending International Occupation*, January 2004, available online at: <http://www.project-syndicate.org/commentary/hroni1>
- INSTITUTE FOR DEMOCRACY AND MEDIATION, *Albanian Perceptions on NATO Integration*, June 2007
- MARCH James and OLSEN Johan, "The Institutional Dynamics of International Political Orders" in: *International Organisation*, 52(4), 1998, pp. 943-969
- MARCH James and OLSEN Johan, *The Logic of Appropriateness*, University of Oslo-ARENA, ARENA Working Papers Series 09, May 2004
- INTERNATIONAL CRISIS GROUP, *Pan-Albanianism, How Big A Threat To Balkan Stability?*, ICG Europe Report N°153, February 2004
- LAÏDI Zaki, *The Unintended Consequences of European Power*, Sciences-Pô / Centre d'Etudes Européennes, cahier européen n°5/2007
- RAKIPI Albert, *The Weak States and Stability: the case of Albania*, Albanian institute for International Studies, 2004
- SNIDAL Duncan, "Rational Choice and International Relations", in CARLSNAES Walter, SIMMONS Beth and RISSE Thomas (eds.), *Handbook of International Relations*, New York, Sage, 2002, pp. 73-94
- TOWNSEND Jim, *The Moment Has Arrived: NATO Membership for Albania, Croatia and Macedonia*, The Atlantic Council of the United States, Program on International Security, Issue Brief, March 2008

### **Dokumente zyrtare dhe Raporte**

COMMISSION OF THE EUROPEAN COMMUNITIES,  
*Albania 2007 Progress Report*, Commission Staff  
Working Document, COM(2007)663, Brussels,  
06.11.2007

COMMISSION OF THE EUROPEAN COMMUNITIES,  
*Albania 2008 Progress Report*, Commission Staff  
Working Document, COM(2008)674, Brussels,  
05.11.2008

MINISTRY FOR FOREIGN AFFAIRS OF THE  
REPUBLIC OF ALBANIA, *Government Program  
2005-2009*, presented in the Albanian Parliament,  
Tirana on 08.09.2005

WORLD BANK and INTERNATIONAL BANK FOR  
RECONSTRUCTION AND  
DEVELOPMENT, *Doing Business 2009 - Country  
profile for Albania*, 2008

### **Faqe interneti**

Presidenca Shqiptare, <http://www.president.al/>  
Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, <http://www.mfa.gov.al/>  
Ministria Shqiptare e Integritimit, <http://www.mie.gov.al/>  
Ministria Shqiptare e Mbrojtjes, <http://www.mod.gov.al/>  
Parlamenti Shqiptar, <http://www.parlament.al/>

Komisioni European, <http://europa.eu/>  
Delegacioni i Komisionit European në Tiranë,  
<http://www.delalb.ec.europa.eu/>  
NATO, <http://www.nato.int/>  
Banka Botërore, <http://www.worldbank.org/>

Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare,  
<http://www.csis.org/>  
International Crisis Group, [http://www.crisisgroup.org/home/  
index.cfm?](http://www.crisisgroup.org/home/index.cfm?)

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim,  
<http://idmalbania.org/en/>

Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare,  
<http://www.aiis-albania.org/>

*Mathieu Rousselin po ndjek Doktoraturën tek Universiteti i St. Gall në Zvicër dhe është njëkohësisht asistent-pedagog tek i njëjti universitet. Ai ka mbaruar një M.A. tek Institut d'Etudes Politiques, në Paris (Francë) dhe një M.A.S. nga Kolegji i Europës, në Poloni. Ai ka qenë edhe asistent-pedagog ne Kolegjin e Europës, në Bruge, Belgjikë. Fushat e tij të interesit përfshijnë sigurinë dhe çështjet e mbrojtjes, politikat e sfinjesisë së BE si dhe lidhjet midis tregtisë dhe demokratizimit.*

## BRIEF SUMMERY IN ENGLISH

*(This issue was edited by  
Erjon Alikaj and Mariola Qesaraku)*

### **EU-NATO seminar - Opening speech by M. Bernard Kouchner, Minister of Foreign and European Affairs (excerpts) PARIS, 7 JULY 2008**

M. Bernard Kouchner launches once more the French initiative about revitalizing Defense Europe as one of the major projects that his country wishes to tackle head on during its EU presidency.

The revitalization of Defense Europe we're proposing today is more than the simple pursuit of a traditional policy: it results from an in-depth analysis of the current strategic environment and a renewed political vision. It is based on an appraisal of our national defense capability, the European Union, the transatlantic partnership and Atlantic Alliance. (...)

### **SHAPING THE NATO-EU RELATIONSHIP: WHAT THE U.S. MUST DO**

Sally McNamara analyses the new relationship NATO - EU after proposals of Europe for developing its own security and defense identity.

“It is certainly the case that Europe as a whole des-perately needs to increase military capabilities. Yet it is highly unlikely that the EU will see this through. As is already perfectly demonstrable, the EU has been successful in acquiring political and bureau-cratic power, and much less so on defense spending and military manpower.

NATO has many partnership arrangements; in fact, that is one of its strengths. Its Partnership for Peace and Mediterranean Dialogue programs have resulted in several fruitful and collaborative relationships. The rush to elevate its relationship with the EU above all others is a mistake. Since the vast majority of EU members are already NATO members and there are no additional EU-only forces, the concept of holding joint exercises or combining rapid reaction forces is unnecessary. In fact, the overlapping membership negates the military value of the EU's involvement in this area. At a time when NATO needs to be concentrating on learning in-the-ater lessons from Afghanistan, developing a new strategic concept, and addressing transformational issues, its relationship with the EU is an unnecessary distraction.”

### **NATO-EU: A STRATEGIC PARTNERSHIP**

Other than the above analysis and proposals, we propose for our public the official information of NATO on the cooperation and partnership with EU, how it has evolved, how it works in practice and their prospects.

### **THE PUBLIC IN THE WEST HAS TO BUY INTO AFGHANISTAN - AND SOON**

Marco Vincenzino feels that the public in NATO countries are losing their interest in the war in Afghanistan. And he argues that losing their interest - and support - could lead to losing the war.

Ultimately, Afghanistan's future will largely depend on whether its central government can deliver, or at least create the perception of delivering, on the high expectations of ordinary Afghans. If it doesn't deliver, the potential for an irreversible loss of legitimacy of the central government will be one of the greatest long-term threats to 'success' in Afghanistan.

Although the international community can still improve its levels of engagement in most sectors, the best this can do is buy time for Afghanistan. Nonetheless, the Afghan public needs assurances that the commitment of the international community will be long-term, consistent and reliable. Memories of international neglect after the Soviet withdrawal, along with the rise of the Taliban, remain fresh in the minds of many Afghans.

### **GLOBAL TERRORISM - CONCEPTUALISM AND TERMINOLOGY**

This article, aims to slightly come out from the conventional analysis of international terrorism. It is an effort to offer a new conceptual framework for the international terrorism for the Albanian academic environment on international security, and also with respect to the regional academic environment in the field. Many theoretical analysis attempts of the phenomenon of political, ideological and religious violence, exercised by one or more individuals, have involved not only the field of security but even broader, the one of the discipline of international relations. Therefore, this analysis intends to offer responses to basic questions with regards to the terrorism terminology, such as: Why is difficult to define terrorism? Who are the social, political and religious roots of the fondamentalist Islamism? How and why the international terrorism and the Islamic extremism are bound empirically and theoretically? The goal of the author is not to analyse the current american foreign policy and the Bush doctrine (2002 - 2006)- which in any case unavoidably has its own place in whatever analysis of the internaional terrorism- but to understand why it still exists such an endless analitical obfuscation around the international terrorism as a phenomenology and who are the accademic implications that implies the current form of its expression, the islamic radicalism.



## **CONFLICT IN CAUCASUS 2008: ORIGIN, DEVELOPMENTS AND CONSEQUENCES**

August 2008: While the worldwide was concentrated on Pekin's Olympic Games, "temperatures" have reached the maximum also in Caucasus regions of South Ossetia and Abkhazia in Georgia. A fierce conflict blasted between military troops of both regions supported by Russia and Georgia's. Which is the chronology of relations and conflict, who are their actors, causes and consequences? Which was the impact of crisis in NATO - Russia and NATO - Georgia relations? Extracting from analysis and publications of prestigious international Medias and organizations, we try to bring a overview of the recent conflict.

### **Regional Summer School in Security Studies**

Upon its own initiative and as a highlight of its successful activities for 2008, the Center for Security Studies of the Institute for Democracy and Mediation (IDM) in cooperation with United Nations Institute for Training and Research - Programme of Correspondence Instruction in Peacekeeping Operations (UNITAR POCI) has successfully completed the 1<sup>st</sup> Regional Summer School on Security Studies (RSS 2008), which took place in the premises of Joint Force Command, Durrës, Albania during the period of September 8 - 18, 2008. Through this intensive two week programme designed as a continuing learning process ranging from in-classroom modules/lectures to production of case studies, IDM intended to create an academic environment which would provide the target group (researchers and practitioners from the European Continent interested in security issues in the Southeast European region) with an updated perspectives of contemporary security challenges. A particular feature of the Summer School was the perfect combination of the theoretical framework and the case study as social laboratory through which different perspectives were provided.

The intention of RSS 2008 was to develop a training programme that would not only provide summer school participants with a thorough background on security studies but would also encourage them to make full use of the acquired skills and knowledge. The lectures delivered through the summer school represented the most significant important component of programme and consisted of six core topics in the field of security studies and enabled the students to better understand and analyze the contemporary security challenges from a Balkans, European and global security perspective thus preparing them for careers in security affairs involving Western Balkans.

### **PATH TO THE EURO-ATLANTIC COMMUNITY: The Effects of EU-NATO Relations on Albania's Security**

In this academic paper Mathieu Rousselin analysis four different schools of thoughts and more precisely the pragmatic school, the realist school, the constructivist school and the rational choice school of thoughts. Firstly, the paper is dedicated in identifying the contribution of each predominant International Relations school of thought that may help to improve the theoretical understanding of different channels of influence of the EU-NATO relationship on Albania's security. Thus, the analysis put in evidence limitations and opportunities of each school in helping to explain the contribution to the Albanian security of international organisations.

This article will primarily focus on the two organisations whose contributions to Albania's security are most broadly acknowledged: the European Union (EU) and the North Atlantic Treaty Organisation (NATO). Their importance is furthermore emphasized by Albanian authorities' longstanding efforts to join both organisations. Secondly, this article deals specifically with the micro level analysis, trying to unravel EU-NATO cooperation and competition strategies at national level and assessing the opportunities and constraints of these strategies on Albania's security.



INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM  
ÇËSHITJE TË SIGURISË - 9

---

Formati: 15,5x24 cm  
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA  
Tel: (4) 22 40 116  
Tiranë, 2008